



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Raport vjetor **2020**



Zgjerohjmë b

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.



otën tuaj

Shërbimi më i mirë për klientët individë si dhe për ndërmarrjet - kjo është ajo që e udhëheqë TEB SH.A. dhe praktika etike biznesore është thelbësore për atë shërbim dhe për misionin tonë. Kjo është arsyeja përse sot pasuria jonë numër një është marrëdhënia e mirëbesimit që kemi ndërtuar me klientët tanë me kalimin kohës.

Vlerat tona

Të sinqertë dhe të besueshëm

Udhëheqës, pararendës dhe inovativ

Të orientuar nga klienti dhe me fokus
të fuqishëm tek cilësia e lartë

Plot respekt për shoqërinë, të drejtat
njerëzore dhe mjedisin

Transparentë



Table of Contents

- 1. Për TEB SH. A.
- 1.1. Profili i korporatës
- 1.2. Misioni, vizioni dhe strategjia jonë
- 1.3. Vlerat tona themelore
- 1.4. Struktura aksionare

- 2. Pasqyra e vitit 2020 dhe perspektiva e viti 2021
- 2.1. Nga Kryetari
- 2.2. Nga Drejtori Ekzekutiv

- 3. TEB SH. A. në vitin 2020
- 3.1. TEB Sh. A. në shifra
- 3.2. Treguesit financiarë kyç

- 4. Njësitë e biznesit
- 4.1. Bankimi retail
- 4.2. Biznesi i kartelave
- 4.3. Bankimi i NVM-ve
- 4.4. Bankimi komercial dhe i korporatave
- 4.5. Financimi tregtar
- 4.6. Sistemet e pagesave
- 4.7. Thesari dhe MAD-i
- 4.8. Burimet Njerëzore
- 4.9. Teknologjia informative
- 4.10. Siguria e informacionit dhe Mbrojtja e të dhënave

- 5. Menaxhmenti/Qeverisja korporative
- 5.1. TEB Sh. A. Struktura organizative
- 5.2. Bordi i Drejtorëve
- 5.3. Komitetet
- 5.4. Auditimi i brendshëm
- 5.5. Menaxhimi i rrezikut si dhe Rreziku operacional dhe Vazhdimësia e biznesit
- 5.6. Pajtueshmëria
- 5.7. Kontrolli i brendshëm
- 5.8. Ligjorja

- 6. Raporti i auditorit
- 6.1. Raporti i auditorit te pavarur deri më 31 Dhjetor 2020

1.1 Profili i korporatës





Zgjerojmë botën tuaj...

Qëllimi ynë është të përcaktojmë rrugën drejt inovacionit dhe rritjes për vitet që vijnë.

TEB Sh.A. (TEB) operon në Kosovë për 13 vjet, dhe gjatë kësaj kohe është bërë një nga udhëheqësit kryesorë në sektorin bankar, me reputacion të denjë për shërbim të shkëlqyeshëm. Në këtë periudhë, TEB Sh.A. një bankë lidere në Kosovë. E udhëhequr nga qëllimi ynë: "Banka për një botë në ndryshim", ne i ndihmojmë klientët tanë, familjet e tyre dhe komunitetet e tyre të arrijnë sukses përmes një game të gjerë këshillash, produktesh dhe shërbimesh, përfshirë bankat personale dhe komerciale, administrimin e pasurisë dhe bankimin privat, bankimin e korporatave dhe investimeve dhe tregjet e kapitalit.

Pavarësisht nga ndryshimet madhore, dinamike në të gjithë botën, TEB ka siguruar mbështetje të vazhdueshme për klientët dhe punonjësit e vet. Performanca e tillë është bërë e mundur përmes kapacitetit të TEB-it si anëtare e Grupit TEB, i cili u formua përmes një sipërmarrjeje të përbashkët ndërmjet BNP Paribas, një prej institucioneve financiare më të fuqishme në botë, dhe Turk Ekonomi Bankasi, një prej bankave me më së shumti reputacion në Turqi.

Përgjegjësia shoqërore e korporatave (PSK) është një nga shtyllat kryesore që kontribuon në misionin tonë ekonomik. Prandaj, për të përmirësuar më mirë përsosmërinë, inovacionin dhe përgjegjësinë në shërbimet tona ndaj klientëve tanë, ne angazhohemi në projekte të ndryshme që synojnë të përmirësojnë arsimin, kulturën dhe sportet për Kosovën. Fokusi ynë përcakton se kush jemi dhe për çfarë përpiqemi, si punojmë së bashku dhe çfarë duam të arrijmë.



Vlera, Shërbimi, Ekselencia...

Banka jonë përqendrohet në krijimin e një shërbimi cilësor, ndërkohë që klienti vendoset në qendër. Ne i vlerësojmë klientët tanë, kështu që kemi krijuar produkte dhe shërbime të veçanta për ta, për t'i plotësuar nevojat, për shembull, të sipërmarrësve dhe qytetarëve të moshuar, punonjësve dhe studentëve.

Ne besojmë se rritja sistematike nga viti në vite numrit të klientëve tanë, rrjetit tonë të shërbimit, vëllimit të transaksioneve si dhe personelit tonë nga viti në vit është dëshmi e përpjekjeve tona që:

■ Vazhdimisht ta zgjerojmë gamën e produkteve dhe shërbimeve tona bankare jonë-degë dhe t'i shtojmë funksionalitet rrjetit tonë inovativ të shërbimeve bankare me shumë kanale. Ne ofrojmë të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare të fokusuara në cilësi, të cilat njerëzve iu duhen në faza të ndryshme gjatë jetës së tyre - e gjitha përmes rrjetit tonë të zgjeruar dhe me shumë kanale të ofrimit.

■ Ofrojmë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë të bankës bazuar në "shërbim të personalizuar".

■ Performojmë më së miri në industri për sa i përket rritjes në numër të kartelave të kredisë, rritje që shtohet vazhdimisht me produkte dhe shërbime të reja, si dhe me fushatat specifike të kartelave të organizuara me grup tjetër të klientëve, respektivisht anëtarët tanë tregtarë. Përmes segmentimit të biznesit me kartela, ne i identifikojmë grupet specifike, u shërbejmë atyre me produkte si She Card për zonjat, Kartela e kredisë për gratë ndërmarrëse, dhe Business Card për pronarët e NVM-ve.

■ Ruajmë pozitën tonë të fortë në shërbimet me pakicë të menaxhimit të parasë së gatshme.

■ Ofrojmë mbështetje bankare komerciale që është shtytësi kyç në udhërrëfyesin drejt rritjes ekonomike të ardhme në Kosovë. Çdo vit, ne e përforcojmë fokusin tonë tashmë të fuqishëm në mbështetjen e qindra mijërave klientëve komercialë dhe të NVM-ve të TEB-it, sepse ata luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik.

Reale, e mençur, me vlerë...

Si anëtare e dy grupeve të fuqishme ndërkombëtare financiare – TEB A.Ş., institucion financiar udhëheqës dhe me reputacion të lartë në sektorin bankar turk, dhe BNP Paribas, një nga bankat e nivelit më të lartë të eurozonës me rrjet të gjerë dhe ndërkombëtar – TEB përfiton nga përvoja, fortësia dhe diapazoni i Grupit. Kjo na mundëson gjenerimin e rezultateve më të mira për klientët tanë.

Mbi këto baza të shëndosha, TEB-i vazhdon të përparojë duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke zhvilluar produkte të përshtatura me pritjet e klientëve. Në hap me avancimet e shpejta në teknologji, ne në mënyrë sistematike e përmirësojmë rrjetin tonë inovativ dhe me shumë kanale të shërbimeve bankare (si shërbimet bankare në Internet dhe ato Mobile, Qendra e thirrjeve, Shërbimet SMS, Bankomatët, POS-ët) duke iu mundësuar kështu klientëve përdorimin e kanalit më të përshtatshëm të shpërndarjes për transaksionet e tyre bankare - me komoditet, shpejtësi dhe besueshmëri.

Më shumë dedikim për komunitetin ...

Që nga viti 2008, kur u themeluar TEB, ne kemi pasur një pozitë pioniere. Ndërsa duke ofruar shërbime të vlefshme, ne përqendrohemi në përmbushjen e kërkesave të klientëve për shërbime financiare. Gjatë këtyre viteve, kemi arritur t'i shfrytëzojmë në mënyrë efektive kompetencat dhe vizionin tonë të korporatës, duke krijuar vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionarët. Në vitin 2019, ka qenë aspirata jonë ta ruajmë një rritje të ekuilibruar dhe të shëndoshë për ta ngritur pozitën tonë në atë të institucionit financiar udhëheqës. Kështu, duke dhënë një bazë edhe më të fortë për të ardhmen tonë si një fuqi e rëndësishme në Kosovë.

Përgjegjësia sociale e korporatës luan një rol të rëndësishëm; prandaj politika jonë është të kontribuojmë në zhvillimin shoqëror të Kosovës. Kemi krijuar një kornizë për iniciativa afatgjata bazuar në spektrin e projekteve që do të paraqesin përfitime më të mëdha shoqërore. Në lidhje me mbështetjen e biznesit, jemi duke punuar me Programin e mbështetjes së ndërmarrësisë të grave, Akademinë e biznesit dhe Forumin e biznesit and the Business Forum.

Tejkalojmë pritjet tuaja...

Suksesi që TEB e ka arritur është arritur nga njerëzit e tij, të cilët punojnë shumë për ta ruajtur dhe rritur cilësinë e shërbimeve dhe pasurive tona që i përfaqëson emri i brendit tonë. Punonjësit e përkushtuar dhe të zellshëm të TEB-it kanë sjellë në bankë një qasje inovative dhe proaktive e cila u është bartur edhe klientëve tanë. Ne synojmë t'u ndihmojmë individëve dhe bizneseve ta ndërtojnë të ardhmen e tyre, t'i arrijnë ambiciet e tyre dhe t'i menaxhojnë dhe ulin rreziqet e tyre financiare. Qëllimi i TEB-it është të jetë një vend ku klientët ndjehen të mirëpritur dhe komod kur i shqyrtojnë zgjedhjet e tyre financiare.

1.2 Vizioni, misioni dhe strategjia jonë

Vizioni ynë

Vizioni ynë është që të jemi banka që ofron përvojën më të mirë të klientëve në Kosovë.

Misioni ynë

Vazhdimisht të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë.

Strategjia jonë

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë, dhe të ofrojmë përvojë të shkëlqyeshme për klientët në TEB duke e vendosur klientin në qendër. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të siguruar rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Oferta e TEB-it i ka gjithmonë rrënjët në zotimin tonë për të qenë bankë e përgjegjshme. Ky zotim është i mishëruar në të gjitha vlerat tona dhe pasqyrohet në biznesin tonë, përmes mënyrës se si i zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona dhe si i paraqesim qëllimet dhe premtimet tona.

1.3 Vlerat tona themelore

Klienti në qendër

Suksesi ynë është i bazuar në përkushtimin e plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke fituar besimin e tyre dhe besnikërinë e bazës sonë të klientëve. E ruajmë këtë besim, sepse klientët tanë janë në thelb të gjithçkaje që bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtysat tona, me një qasje dhe përgjigje të shpejta dhe proaktive ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson ta krijojmë dhe ta japim vlerën e vërtetë teksa u shërbejmë klientëve tanë me shërbime dhe produkte të reja, përtej pritjeve të tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

Integriteti

Kemi përqafuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe bëjmë dhe gjithashtu jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët, aksionarët dhe punonjësit tanë duke bërë gjithmonë më shumë se thjesht atë që është e duhur. Komunikojnë hapur dhe me sinqeritet, i ftojmë dhe i vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe më të balancuara.

Ne e dimë dhe bëjmë atë që është e drejtë: *ZOTIMI*: Ne vendosim standarde të larta për sjelljen tuaj dhe u përmbahemi atyre edhe në situata të vështira. *GUXIMI*: Ne synojmë atë që besojmë se është e drejtë dhe e mirë. *SINQERITETI*: Ne zgjedhim fjalë dhe veprime

që janë të sinqerta, jo mashtroese. *DISIPLINA*: Ne mbetemi të përkushtuar dhe të vetë-kontrolluar, edhe kur sfidohemi. *FLEKSIBILITETI*: Mësojmë nga gabimet dhe humbjet; shfrytëzojmë rastin për t'u përmirësuar.

Inovacioni

Aspirojmë inovacione me rëndësi. TEB-i e vlerëson entuziazmin dhe kureshtjen intelektuale të personelit tonë, gjersa ata vazhdimisht synojnë të krijojnë produkte që e lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre. Inovacioni është thelbësor për suksesin e një korporate duke dhënë një avantazh konkurrues në depërtimin më shpejt në treg. Duke krijuar një marrëdhënie të dobishme reciprokisht me fillestarrët dhe sipërmarrësit, korporatat mund të sigurojnë një biznes të suksesshëm për kohë të gjatë për brezat e ardhëm.

Efikasiteti në punë

Krijojmë procese dhe produkte miqësore për përdoruesin, të lehta për qasje dhe të projektuar për të shtuar vlerë. Përpiqemi të sigurohemi se shërbimet e ofruara kanë çmime që i përgjigjen drejtë kostos aktuale të ofrimit të tyre. Rritja e efikasitetit operacional fillon me përsosjen e procesit. Proceset janë në thelbin e operacioneve.

Disiplina

Mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës, dhe si pasojë, i mbrojmë burimet e saj dhe përqendrohemi në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale. Jemi krenarë për sukseset e TEB-it dhe vlerën që e kemi krijuar dhe vazhdojmë ta krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 594 punonjësit tanë ndihet përgjegjës për ndonjë dështim të mundshëm në përmbushjen e pritjeve të klientëve dhe të gjithë japim llogari për përmbushjen e premtimeve tona - pa përjashtim. Synojmë të arrijmë përsosmëri operacionale me kryerjen e suksesshme të punës që në përpjekjen e parë.

Burimet kompetente njerëzore

Sa i përket qëllimit tonë për ta forcuar pozitën tonë si punëdhënësi i zgjedhur, ne përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, nxit punën bashkëpunuese e të shkathëta ekipore përmes diversitetit dhe përgjegjësisë, ushqen dhe investon në talentët më të mirë, dhe realizon menaxhimin me bazë në merita dhe mundësi të barabarta. Një udhëheqës i suksesshëm i BNj-ve do të thotë të kuptuarit e plotë të parimeve, praktikave dhe funksioneve që kontribuojnë në menaxhimin efektiv të BNj-ve. Fushat kritike të njohurive përfshijnë rrezikun dhe menaxhimin strategjik të biznesit, planifikimin e fuqisë punëtore dhe teknologjinë e BNj-ve.

Partneriteti

Synojmë për marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme ndërmjet klientëve dhe punonjësve, ku vlera e krijuar ndahet në mënyrë të drejtë. Përveç se jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët me interes dhe rregullatorët, ne gjithashtu i shërbejmë shoqërisë tonë.

Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Kanalet e forta të shpërndarjes janë zinxhiri i bizneseve ose ndërmjetësve përmes të cilave kalojnë mallra ose shërbime derisa të arrijnë te blerësi ose konsumatori i fundit. Kanalet e shpërndarjes mund të përfshijnë tregtarë me shumicë, shitës me pakicë, shpërndarës, madje edhe internetin. Kanalet e shpërndarjes, të njohura edhe si plasime, janë pjesë e strategjisë së marketingut të një kompanie, e cila gjithashtu përfshin produktin, promovimin dhe çmimin.

1.4 Struktura aksionare

Kapitali aksionar i TEB Bankës është 24,000,000 € bazuar në 2,400,000 aksione të emetuara, secila me vlerë nominale prej 10 €.

Numri i aksioneve lidhet me aksionet e zakonshme pa të drejta, preferenca ose kufizime të lidhura me to.

Shareholder as of December 31,	Share Ownership Paid in Capital (C)	Share
TEB HOLDING A.S.*	24,000.000	100%

*50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş.dhe Çolakoğlu Group Joint Venture.

2.1. Fjala e Kryesuesit

Me përkeqësimin e pandemisë COVID-19, viti 2020 ishte një vit mjaft sfidues për TEB SH.A., ashtu siç ishte për shumicën e institucioneve dhe njerëzve në Kosovë.

Që nga fillimi i vitit, ndërsa ekonomia filloi të tkurrej, prioritetet tona ishin të qarta:

Së pari, ne duhej të ofronim siguri dhe mirëqenie për punonjësit dhe klientët tanë dhe stabilitet për integritetin tonë operacional dhe financiar. Kjo është arritur.

Së dyti, TEB SH.A. dëshironte të qëndronte pranë klientëve të saj dhe t'i mbështeste ata që pësuan më shumë gjatë krizës. Ne ndërmorëm veprime thelbësore për të lehtësuar presionin e tyre financiar duke hequr dorë nga disa tarifa, interesa dhe ngarkesa dhe detyrime të zgjatura të pagesave në bashkëpunim të ngushtë me rregullatorin.

E gjithë kjo u bë e mundur falë angazhimit të stafit tonë dhe menaxhmentit të Bankës.

Shumë kolegë u adaptuan jashtëzakonisht për të ndryshuar duke punuar nga shtëpia, ndërsa disa punonjës kyçë ende punonin në degë dhe zyrën qendrore për të ofruar shërbime të pandërprera për klientët tanë duke ruajtur një mjedis të sigurt. Kjo është arritur gjithashtu. Shumë faleminderit të gjithëve.

Përkundër këtij viti të vështirë, ku të ardhurat bruto ishin nën presion, falë një kontrolli efektiv të koston dhe një kosto të ulët të rrezikut, TEB SH.A. demonstroi një qëndrueshmëri të mirë për sa i përket përfitimit dhe bëri një kthim të kapitalit prej 19.3% dhe një tregues të adekuatshmërisë së kapitalit prej 17.1%.

Banka jonë mbetet shumë likuide me një bilanc të fortë të gjendjes; prandaj po përgatitemi për perspektivën e një rikthimi të ardhshëm në Kosovë. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë platformat tona digjitale dhe të përmirësojmë proceset tona për t'iu ofruar klientëve tanë një bazë shërbimi më efikase si dhe produkte të reja.

Në emër të Bordit, unë dua të shpreh falënderimet e mia më të ngrohta për të gjithë të përfshirë - klientët tanë për besnikërinë e tyre, aksionarët tanë për mbështetjen e tyre - dhe jo më pak për menaxhmentin dhe punonjësit tanë për veprimet e tyre pozitive dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm ndaj Bankës.

Jacques Roger Jean Marie Rinino

Kryetar i Bordit të Drejtorëve



2.2. Letër nga Drejtori Ekzekutiv

Viti 2020 ishte vit ndryshe nga të tjerët. E gjithë bota u detyrua të pësojë një transformim dhe mësoi të luftojë me një "normalitet të ri" me bllokime, krizë ekonomike dhe shëndetësore, distancim shoqëror dhe kufizim të lëvizjes.

Ndërsa bota ngeci në vend, duke qenë e vetëdijshme për rëndësinë e ofrimit të pandërprerë të shërbimeve për klientët tanë, menaxhmenti i bankës duhej të lëvizte shpejt për të rregulluar modelin tonë të funksionimit në rrethana të reja dhe për të ruajtur integritetin financiar dhe operacional të bankës. Modeli ynë u bë më i shkathët dhe u përqendrua në menaxhimin e rreziqeve të ndërprerjes. Ne realizuam një sërë analizash skenarësh për të përcaktuar rezultatet e mundshme të pandemisë COVID-19 të cilat na informuan për veprimet e menaxhimit. Në veçanti, ne mbetëm në përputhje me ndryshimin e peizazhit të kërkesave të kujdesshme dhe pritjeve mbikëqyrëse, dhe me qasjet e reja për testimin e stresit.

Në muajin mars, brenda disa ditësh, u krye një transformim i madh i fuqisë punëtore, duke migruar më shumë se gjysmën e punonjësve në punë nga distanca duke adaptuar mjedisin e punës përmes ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për të mbrojtur dhe për të ngadalësuar përhapjen e virusit për stafin e caktuar si punëtorë kyç ose kritikë. Në përputhje me udhëzimet e qeverisë, ne kemi nxitur kthimin gradual në zyrë duke punuar me sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve si prioriteti ynë i parë. Si kompani, ne u jemi thellësisht mirënjohës punonjësve tanë të cilët kanë punuar aq shumë gjatë vitit të fundit për të vazhduar ofrimin e shërbimeve për klientët tanë ose në distancë nga shtëpia ose si staf kyç i caktuar në degët ose Zyrën Qendrore. Unë jam i kënaqur që ne ishim në gjendje të paguanim plotësisht të gjithë punonjësit, por mbi të gjitha ne jemi me fat që asnjë nga kolegët tanë nuk e humbën betejën me virusin. Për ato familje që janë prekur, unë shpreh simpatinë time më të thellë për humbjen e tyre.

Ne duhej të siguroheshim që të qëndronim pas klientëve tanë kur ishte më e nevojshme për të rritur mbështetjen tonë dhe për t'i ndihmuar ata ta kapërcenin këtë periudhë të vështirë. Klientëve tanë që ishin në gjendje të vështirë financiare iu dha mundësia të pauzonin ose të riplanifikonin kreditë e tyre pa asnjë dënim, dhe disa tarifa dhe ngarkesa dhe pagesa interesi u anuluan.

Ndërsa rritja e ekonomisë botërore u shkurtua në gjysmë dhe disa vende u zhytën në recesion në vitin 2020, dhe ekonomia vendore vlerësohet të ketë rënë me 6% në vitin 2020, sektori bankar mbeti i menaxhuar mirë, me kapital të fortë, ruajtje të likuiditetit dhe kredi jo-performuese.

Pavarësisht nga tkurrja ekstreme e ekonomisë dhe e prekur shumë nga ngjarjet e tjera të jashtme të vitit 2020, modeli ynë operativ demonstroi kapacitetin e vet për të dhënë performancë fleksibile, për të ruajtur integritetin tonë financiar dhe për të ruajtur aftësinë paguese dhe fitimin gjatë gjithë vitit. Totali i pasurive arriti në 662.1 milion €, një rritje prej 9.7% nga viti në vit dhe 71.6 milion € mbi parashikimet. Portfolio i kredive bruto u rrit me 4.6% krahasuar me VF 2019 dhe përbën 64% të totalit të pasurive. Depozitat e klientëve në fund të vitit 2020 arritën në 561.4 milion €, një rritje prej 49.1 milion € ose +9.6% në krahasim me fundin e vitit 2019. Ndërsa administrojmë rrezikun tonë në mënyrë të përshtatshme dhe marrim provizione të konsiderueshme për humbjet e mundshme të kredive në të ardhmen, ne kemi rritur provizionet tona për zhvlerësim. Ne kemi dorëzuar një fitim prej 13.4 milion € pas tatimeve.

Ndikimi i COVID-19 në shoqëri ka rritur një numër trendësh ekzistues në preferencat dhe sjelljet e klientëve. Si pasojë e shpenzimeve më të ulëta dhe rritjes së kursimeve paraprahe, janë rritur rezervat e parave të gatshme. Në 9 muajt e fundit, ne kemi qenë dëshmitarë të një zhvendosjeje të mëtejshme të përdorimit të parave të gatshme drejt pagesave me kartela, veçanërisht transaksioneve dhe shërbimeve përmes internetit, pasi klientët përqafuan mjedisin me prekje sa më pakët dhe distancën sociale të nevojshme shkak i pandemisë. Në të njëjtën kohë, ne kemi parë një reduktim të mëtejshëm të klientëve duke përdorur infrastrukturën e degëve tona ndërsa gjithnjë e më shumë klientë kërkojnë mënyra për t'u vetë-shërbyer. Këto tendenca kanë dëshmuar se strategjia jonë për të krijuar mundësi të reja biznesi bazuar në angazhimin digjital dhe gjetjen e efikasiteteve përmes teknologjisë dhe automatizmit është modeli i duhur.

Megjithëse ndikimi shëndetësor dhe ekonomik i COVID-19 vazhdon të ketë implikime të konsiderueshme për shoqërinë e gjerë dhe mënyrën e të jetuarit dhe bashkëveprimit, gjatë gjithë vitit të kaluar, ne kemi pasur mundësinë të mësojmë shumë për fleksibilitetin dhe kapacitetin për t'u përshtatur me këtë kompani. Këto njohuri duhet t'i aplikojmë ndërsa gradualisht kalojmë në modelin e biznesit tonë në post-pandemi, shpresojmë kjo të ndodhë gjatë vitit 2021. Sfidat janë kryesore afatshkurtër është ruajtja e integritetit tonë financiar dhe operacional. Ne mbetemi plotësisht të përkushtuar për t'i ndihmuar klientët tanë të rikthehen dhe për të rigjallëruar ekonominë vendore. Ne duhet t'i rikthehemi përfitimit të fortë dhe të qëndrueshëm dhe duhet të adresojmë bazën tonë të kostove. Konkretisht, ne duhet të rrisim angazhimin tonë me klientët tanë ku aktualisht gjenerojmë vetëm humbje dhe të diversifikojmë më tej bazën tonë të klientëve. Jam i inkurajuar nga progresi që kemi bërë tashmë dhe kam besim se do të vazhdojmë të mbështetemi në progresin e bërë këtë vit, pavarësisht ndikimit të pandemisë COVID-19.

Dëshiroj që veçanërisht të falënderoj punonjësit tanë, performanca jonë gjatë këtij viti të vështirë nuk do të ishte e mundur pa angazhimin dhe përkushtimin e tyre. Më 2021 do të mbetemi të përkushtuar që të investojmë në ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës. Mbetemi të përkushtuar që të ofrojmë programe trajnimi, mundësi dhe ta shpërblejmë performancën e jashtëzakonshme në mënyrë konkurruese. Përkundrazi, ne presim nga kolegët tanë të sfidojnë vetveten për ta përmbushur potencialin dhe talentin e tyre dhe angazhimin e plotë për të ofruar shërbime të shkëlqyera për klientët.

Unë gjithashtu do të doja të shprehja mirënjohjen tonë për të gjithë klientët tanë dhe partnerët afarist për besimin dhe besnikërinë e tyre të vazhdueshme, ndërsa ne shpresojmë ta rrisim marrëdhënien tonë me ta në të ardhmen. Mbi të gjitha, ne u jemi mirënjohës anëtarëve tanë të Bordit dhe aksionarëve tanë për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Orçun Özdemir
Drejtor Menaxhues

3.1. TEB-i në shifra

	2020	2019	Rritje/ (Decrease)	Përqindja
Treguesit e bilancit të gjendjes				
Gjithsej pasuritë	662,118	603,797	58,321	9.7%
Gjithsej kreditë (bruto)	423,358	404,875	18,483	4.6%
Depozitat	561,400	512,263	49,137	9.6%
Kapitali i aksionarëve	85,570	72,191	13,379	18.5%
Kreditë jo-performuese/Gjithsej kreditë	1.54%	1.47%	0.07PP	
Kreditë/Gjithsej pasuritë	63.9%	67.1%	(3.1PP)	
Raporti i mbulimit të kredive jo-performuese	67.1%	57.0%	10.1PP	
Treguesit e pasqyrës së të hyrave				
Të hyrat neto nga interesi	27,751	29,003	(1,252)	(4.3%)
Të hyrat neto jo nga interesi	5,928	4,163	1,765	42.4%
Raporti kosto/të hyra	53.4%	57.3%	(3.9 PP)	
Neto të hyrat bankare	33,679	33,166	513	1.5%
Neto fitimi vjetor	13,377	15,473	(2,096)	(13.5%)
Raportet e profitabilitetit				
Kthimi në kapital	19.3%	23.2%	(4.0 PP)	
Kthimi në pasuri	2.0%	2.6%	(0.5 PP)	
Të hyrat neto nga interesi/ Pasuritë mesatare që krijojnë interes	5.5%	6.1%	(0.6 PP)	
Raportet e likuiditetit				
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	17.1%	14.8%	2.4 PP	
Pasuritë likuide/Gjithsej pasuritë	33.7%	28.1%	5.6 PP	
Pasuritë e peshuara me rrezik	428,104	486,582	(58,478)	(12.0%)
Treguesit e tjerë				
Degët	29	29	0	0.0%
Punonjësit	594	595	(1)	(0.2%)

3.2 Treguesit financiarë kyç

Pavarësisht nga sfidat që solli shpërthimi i Covid-19 për të gjitha bizneset, rezultati i përgjithshëm i portfolios së kujdesshme dhe menaxhimit të rrezikut, strategjisë së rritjes duke pasur parasysh rrezikun dhe përqendrimi tek klientët rezultuan në rritje të qëndrueshme të portfolios kreditore, rritje të konsiderueshme të depozitave, të pasurive totale dhe shifra të qëndrueshme të fitimit.

Në fund të vitit 2020, totali i pasurive të Bankës arriti në 662.1 milion €, duke u rritur me 58.3 milion € ose 9.7% në krahasim me vitin 2019, që përfaqëson vëllim më të lartë sesa është parashikuar për më se 71.6 milion €. Portfolio bruto e kredive u rrit në 423.4 milion €, një rritje me 4.6% ose rritje e vëllimit me 18.5 milion €, në krahasim me vitin 2019. Kreditë bruto tani përbëjnë 64% të totalit të pasurive të Bankës.

Raporti i kredive jo performuese (KJP) (Faza 3) në fund të vitit 2020 ishte 1.54% krahasuar me 1.47% në vitin 2019, që përbën një rritje me 0.07 pikë bazë. Duke marrë parasysh mjedisin e vështirë të shkaktuar nga pandemia, ky raport i ulët është edhe një tregues i praktikave tona të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut. Depozitat e klientëve në fund të vitit 2020 arritën në 561.4 milion €, një rritje prej 49.1 milion € ose 9.6% në krahasim me fundin e vitit 2019.

Margjinat në rënie ishin shkaku kryesor për rënien e lehtë të treguesve të pasqyrës së të ardhurave krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat neto nga interesi për vitin 2020 ishin 27.8 milionë €, një rënie me 1.3 milionë € ose 4.3% në krahasim me vitin 2019. Të ardhurat neto jo nga interesi arritën shumë prej 5.9 milion €, një rritje prej 1.8 milionë € ose 42.4%.

Të hyrat neto nga shërbimet bankare në fund të vitit ishin 33.7 milion € në krahasim me 33.1 milion € të realizuara në vitin 2019 që përbën një rritje prej 0.5 milion € apo 1.5%. Banka arriti të ulë edhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të cilat i mundësuan Bankës të ketë të ardhura më të mira bruto nga bankimi krahasuar me vitin 2019.

Banka e mbylli vitin me 13.4 milion € fitim pas tatimeve. Ulja e fitimit neto rezultoi kryesisht nga kostot më të larta të rrezikut të kredive për shkak të shpërthimit të COVID 19 dhe efektit të saj në ekonomi.

Për sa i përket treguesve të profitabilitetit, në fund të vitit 2020 Banka krijoi Kthim në Kapital (KNK) prej 19.3%, që u zvogëlua nga 23.2% në vitin 2019, ndërsa Kthimi në Pasuri (KNP) ra në 2.0%, krahasuar me 2.6 % në vitin 2019. Raporti i interesit neto mbi pasuritë mesatare që krijojnë interes ishte 5.5%, krahasuar me 6.1% një vit më parë, kryesisht si rezultat i normave më të ulëta të interesit por edhe i një shume më të lartë të plasmaneve në strukturën e pasurive që fitojnë interes. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës (RMK) në fund të vitit ishte 17.1%, duke e tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12%, dhe rritje nga 14.8% në fund të vitit 2019.

Raporti i pasurive likuide ndaj pasurive totale është rritur në 33.7% në fund të vitit 2020 krahasuar me 28.1% në vitin 2019. Arsyeja kryesore për likuiditetin më të lartë vjen për shkak të rritjes së bazës së depozitave. Pasuritë e Peshuara me Rrezik (PPRr) prej 428.1 milion € kanë shënuar rënie prej 486.6 milion € në vitin e kaluar si rezultat i rregullores së re të Bankës Qendrore për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Në fund të vitit 2020, Banka kishte 29 degë që siguronin mbulim të qëndrueshëm me shërbime bankare, ndërsa numri i punonjësve mbeti në nivele të njëjta, 594 sosh në vitin 2020 (595 në vitin 2019).



4.1 Bankimi retail

Bankimi retail është një fushë kryesore e veprimtarisë së Bankës TEB. Segmenti i bankimit retail ofron një gamë gjithëpërfshirëse dhe të larmishme të produkteve me pakicë në depozita, kredi, pagesa dhe kartela dhe është i përkushtuar të sigurojë marrëdhënie të zgjeruara dhe të afatgjata me klientë. Bankimi retail vazhdimisht punon drejt përmbushjes së nevojave bankare të klientëve.

Në vitin 2020, fokusi ynë ishte të nxisnim linjën kryesore duke shfrytëzuar aftësitë tona të njohura për të fituar klientë të rinj dhe për të thelluar marrëdhëniet me klientët tanë ekzistues. Libri ynë i kredive retail vazhdon të rritet fuqishëm së bashku me bazën e depozitave të individëve

Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, viti 2020 ishte një vit i mbarë për bankimin për individë dhe privat. Gjatë kësaj periudhe, ne kemi investuar në shërbimin ndaj klientit dhe rritjen e tyre, gjë që na ndihmoi të fitojmë klientë të rinj, të rrisim depozitat dhe të rrisim huadhënien në tregun tonë, veçanërisht në huadhënien për klientë

Baza e klientëve

Synimet për fitim të klientëve kanë përparuar në përputhje me supozimet strategjike. Në vitin 2020, baza e klientëve të bankimit retail u rrit me 7.8% krahasuar me vitin e kaluar, me 26 mijë klientë të rinj dhe duke tejkaluar 366 mijë klientë. Sa i përket klientëve të rinj aktivë, ne kemi rritur bazën tonë të klientëve aktive me 17 mijë klientë të rinj. Në vitin 2020, Divizioni i Bankimit Retail ka arritur të ruajë bazën e marrësve të pagave, ku kemi arritur të rritemi për 1,662 marrës të rinj të pagave me një rritje neto të bazës ekzistuese me 3% dhe mbajtjen e pjesës së tregut me 20%.

Depozitat

Divizioni Retail arriti të përfitonte nga fondet e klientëve individë që rriteshin në treg. Strategjia efektive e menaxhimit të fondeve dhe përqendrimi në depozitat ishin përbërësit kryesorë për rritjen e bazës së depozitave retail. Shuma e depozitave të klientëve retail, përfshirë fitimin e ri, u rrit me 21 milion dhe pjesa jonë e tregut vazhdon të jetë 14%.

Kreditë

Në fillim të vitit 2020, aktiviteti i huadhënies retail i Bankës kishte një fillim shumë efektiv, por pas marsit 2020 efekti i pandemisë u ndie dhe financimi me kredi individuale kishte një ngecje për një periudhë prej gati 3 muajsh. Pas qershorit të vitit 2020, aktiviteti i huadhënies retail vazhdoi së rrituri i cili u nxit nga një ofrim i produkteve konkurruese dhe promovime tërheqëse të synuara për klientët e rinj dhe segmentet e zgjedhura të tregut. Si rezultat, banka në kredi retail është rritur me 10.7 milion dhe mbajti pjesën e njwjtë të tregut me 18%. Për të rritur më tej gamën e ofertave të huadhënies për klientë individë, ne do të vazhdojmë të zgjerojmë partneritetin tonë me kompanitë e ndërtimit për financimin e hipotekave, tregtarët e autorizuar të automjeteve, tregtarët e teknologjisë dhe institucionet arsimore.

Menaxhimi i KJP-ve

Viti 2020 ishte i një vit i mbushur me sfida në menaxhimin e kredive jo-performuese (KJP). Sidoqoftë, niveli i KJP-ve mbeti i paprekur, në veçanti sa i përket kredive individuale.

Përderisa kemi arritur rritjen e kredive, ne po ashtu kemi arritur të ulim KJP-të me 14%. Me një rrezik të larmishëm të shoqëruar me praktikatat e avancuara të shitjeve ne synojmë të ruajmë këtë trend. Ne parashikojmë siguri në tregun e kredive individuale në periudhën në vazhdim sa i përket Menaxhimit të KJP-ve, e cila ishte një nga pjesët më të rëndësishme të stories të vitit 2020.

Modeli ynë i biznesit është i përqendruar në zhvillimin e mundësive të reja digjitale, zgjerimin e gamës së produkteve, optimizimin e proceseve të brendshme dhe shërbimin më të mirë të klientëve tanë. Bankimi digjital do të vazhdojë të mbetet në qendër të fokusit tonë me shërbime bankare inovative digjitale dhe shumë kanale.

Për të modernizuar praktikatat e reja bankare, ne po bëjmë investime të konsiderueshme në kanale digjitale në mënyrë që të përshpejtojmë standardet tona të reja dhe kost-efektive bankare.

Objektivi ynë kryesor është të rrisim depërtimin në treg duke ofruar shërbime dhe produkte bankare unike dhe në vlerë të shtuar. Potenciali i tregut na shtyn të forcojmë pozicionin tonë në segmentin e klientëve individual ('retail') dhe të rrisim tutje pjesët tona të tregut duke ruajtur cilësinë ekzistuese të kredisë.

Përveç kësaj, sipas strategjisë tonë të shitjes, strategjitë e rritjes së kredive po ashtu do të përfshijnë mundësitë digjitale për të rritur huadhënien, në përdorimin e CRM-ve (Menaxhimi i Rrezikut të Pajtuashmërisë) për të filluar drejtime të reja të shitjeve dhe partneritete me BERZh-in për shërbimet e financimit të gjelbër, kompanitë e ndërtimit për financimin e hipo-tekave, tregtarët e autorizuar të industrisë së makinave dhe institucionet arsimore për të zgjeruar gamën e ofertave të huadhënies për klientët individual.

Viti 2020 ishte një vit tjetër i suksesshëm, duke konfirmuar se strategjia jonë është e përshtatshme për tregun bankar për klientët individual dhe klientët me të cilët ne punojmë. Strategjia jonë është të vazhdojmë investimet tona në zgjidhjet digjitale, por të mirëmbajmë ndërveprimin njerëzor me bankierë personal.

4.2 Biznesi i kartelave

Viti 2020 dëshmoi se ishte vit sfidues, ku u përballëm me masa të mbylljes së plotë dhe ekstreme për shkak të pandemisë.

Këto masa patën një efekt të jashtëzakonshëm në Biznesin e Kartelave dhe POS-ve, veçanërisht muajt kur kishte një mbyllje të plotë në mes të muajit mars deri në prill (në muajin prill kishte një rënie prej 35% të vëllimeve të POS-ave, krahasuar me prillin e vitit 2019).

Në këto kohë të vështira, qëllimi ynë ishte të ndihmonim klientët tanë për të lehtësuar blerjet e tyre, ku kemi zhvendosur të gjitha pagesat e bëra me Starcard për individë me këste për 3 muaj, nga 18 marsi deri më 31 maj.

Kjo iniciativë u tregua shumë e dobishme dhe u pranua mirë nga përdoruesit e Starcard, ku ata kanë treguar vlerësimin e tyre përmes mediave sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit.

Nga kjo fushatë më shumë se 40,000 klientë të Starcard kanë përfutur dhe më shumë se 5 milion euro pa interes janë zhvendosur.

Kishte disa fushata të tjera të organizuara nga Divizioni i Biznesit të Kartelave dhe POS-ave, të tilla si fushata bonusesh ose këste ekstra dhe qëllimi i fushatës ishte thjesht, të lehtësojë blerjet e klientit!

Më shumë se 350,000 € bonus iu dhanë klientëve tanë me kartelë Starcard në vitin 2020.

Një nga fushatat tona të ndërgjegjësimit ishte të njoftonim klientët tanë se mënyra më e sigurt për të bërë blerje përmes POS-it janë pagesat pa kontakt. Për t'i ndihmuar klientët tanë edhe më shumë, limiti i pagesave pa kontakt u rrit nga 15€ në 40€ përkatësisht 50€.

Duke pasur flotën më të madhe të POS-ave me karakteristika pa kontakt dhe kartelat pa kontakt në treg, kjo fushatë u tregua shumë e suksesshme pasi kemi rritje të vëllimit me 438% në 2020 krahasuar me vitin 2019!

Pavarësisht mbylljeve shkaku i pandemisë, ne arritëm të kemi rezultate të mira në qarkullimin e POS-ave, duke pasur muajin më të mirë ndonjëherë me 18.5 milion euro vëllim në dhjetor dhe vetëm 2% rënie nga qarkullimi total i vitit 2019, ndërsa vazhdojmë të jemi banka lidere në fitimin e bizneseve me 42% të pjesës totale të tregut.

Një kanal pagese shumë i rëndësishëm gjatë vitit 2020 ishte TEB Payment Gateway (e-tregtia) gjithashtu.

Pandemia i dha një hov të madh blerjeve përmes e-tregtisë, vetëm me Gateway tonë kemi parë një rritje prej 200% të vëllimit krahasuar me vitin 2019, duke e bërë TEB-in blerësin më të madh përmes Payment Gateway në vend, pavarësisht nga fakti që TEB e paraqiti zgjidhjen më të fundit të Payment Gateway në vend, por duke qenë lëshuesi më i madh i kartelave në vend dhe e vetmja bankë që ofron portë pagesash me këste, na bëri partneri më i dëshirueshëm për tregtarët tanë.

Kartelat e debitit

Kartela e debitit në anën e blerjes kishte një rritje të vëllimit me 10% në krahasim me rritjen nga viti në vit. Ndërsa në anën e lëshimit me 12%.

Të kesh të gjithë portfolion e kartelave me karakteristikën pa kontakt (Visa dhe MasterCard) që u mundëson klientëve tanë të përdorin këtë funksion në rrjetin e POS-ave ose në të gjithë botën kudo që nuk pranohet Visa ose MasterCard.

Për herë të parë klientët tanë kanë fituar më shumë se 100,000€ bonus në kartelat e tyre të debitit gjatë vitit 2020, për blerjet e tyre në rrjetin e terminaleve POS të TEB-it.

Kartelë e kreditit - Starcard

Starcard është kartela e kreditit më e dëshirueshme në treg për 12 vjet me radhë!

Starcard ka dëshmuar se kur vijnë kohë të vështira, klientët tanë mund të mbështeten në produktin tonë.

Me një ekip të përkushtuar në terren dhe zyra, dhe qasjen me klientin në qendër, ne vazhdimisht po ndërmarrim veprime bazuar në nevojat e klientit, për të sjellë më të mirën e biznesit të kartelave në treg!

Gjatë mbylljes shkaku i pandemisë, përmes fushatës së zhvendosjes së interes të kësteve, klientët tanë patën ndihmë të konsiderueshme për të kapërcyer krizën e tyre financiare.

TEB Sh.A. u zgjodh "Fushata më e mirë promovuese në vitin 2020" nga Visa

Me më shumë se 100 fushata dhe promovime me tregtarët tanë, duke ofruar disa nga fushatat më kreative dhe të dëshirueshme për klientët tanë.

Më shumë se 350,000 € bonus iu dhanë klientëve tanë me kartelë Starcard në vitin 2020.

Për ta sjellë përvojën më të mirë për klientët tanë, ne po ofrojmë 3 lloje të ndryshme të kartelave të kreditit për individë: Classic Starcard, Premium Starcard dhe She Card.

Premium Starcard u ofrohet klientëve që kanë limit të kredit kartelës prej 1.500 EUR ose më lart. Me Premium Starcard, klientët tanë mund të fitojnë deri në 20% pikë bonus në tregtarët tanë premium. Tregtarët premium zgjidhen me kujdes nga secili sektor dhe vetëm më të mirët nga më të mirët mund të futen në këtë listë. Ka më shumë se 40 tregtarë premium në të gjithë vendin që ofrojnë nga 5% deri në 20% pikë Bonus.

SheCard është krijuar për t'i tërhequr gratë, duke i pajisur ato me kredit kartelë që jep deri në 20% pikë Bonus në 27 tregtarët e SheCard. Tregtarët janë zgjedhur pasi janë analizuar sjelljet e grave në blerje, që të mund t'i stimulojmë pikët e bonusit për tregtarët që vizitohen më shumë nga ky grup i synuar.

POS

Për të mbështetur portfolion tonë të kartelave, ne kemi rrjetin më të madh të tregtarëve në vend!

Ne kemi investuar në modele krejt të reja POS Ingenico Tetra Move 3500, duke azhurnuar flotën tonë të POS-ve në mënyrë që klientët dhe tregtarët tanë të mund të marrin kartelat e tyre më të mira, përmes pajisjeve tona.

Për herë të parë në tregun tonë, TEB SH.A. instaloi një POS vetë-shërbyes në tregtarin e karburanteve në vend. Një promovim dhe fushatë e veçantë u organizua për të promovuar këtë metodë të re pagese, duke ofruar 5 cent ulje për të gjithë klientët.

Pas një lansimi të suksesshëm, ka shumë kompani që kanë treguar interes për POS vetë-shërbyes, të tilla si kompani ndërkombëtare të ushqimit të

shpejtë (drive through dhe në kiosk dyqanesh), parkingje publike, kuti postare, etj.

Prioritetet e vitit 2021 për biznesin e kartelave dhe POS-ave

Ndërsa ekonomia e vendit tonë po rimëkëmbet nga pandemia, ne po presim të kemi një nga vitet më të mira deri më tani.

Për herë të parë në tregun tonë, ne po prezantojmë modelin vertikal për kartelën tonë të debitit të quajtur edhe si "Starcash".

Starcash do të vijë me 2 dizajne të mira, të cilat do të segmentohen në dy grupe të synuara.

Grupi i parë i synuar do të jenë klientët nga 18 deri në 25 vjeç dhe grupi i dytë do të jetë 25 vjeç e lart. Me karakteristika të tilla, bonus me kthim parash për çdo blerje (në rrjetin e terminalit POS të TEB-it), pa kontakt, 3D Secure për pagesa në internet, Starcash do të bëhet kartela e debitit më e gjithanshme në treg!

Për të ndihmuar klientët tanë nevojtar me kartelë të kreditit, ne po ofrojmë programin e mbajtjes për klientët me kartela të kreditit që mund të paguajnë borxhin e kartelës së tyre me këste. Me rritjen e shpejtë të pagesave pa kontakt, ne do të rrisim praninë tonë në treg dhe do të zëvendësojmë pajisjet POS e vjetra me modele krejt të reja, në mënyrë që t'u ofrojmë klientëve tanë përvojë më të mirë.

Portfolio i bazës së klientëve tanë po e rrit edhe përdorimin e bankomatëve tanë. Ne jemi duke analizuar vazhdimisht vendet e reja për vendosjen e bankomatëve, për të ndihmuar klientët tanë me shërbime të parave të gatshme.

planet janë që të rritet flota e bankomatëve me 30%, me modele krejt të reja riciklimi të parave të gatshme dhe ekran me prekje.

Një nga projektet më të mëdha në vitin 2021 për biznesin e kartelave dhe POS-ave do të jetë bashkëpunimi me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASI). Ky partneritet do të sjellë digjitalizimin potencialisht e të gjitha pagesave dhe kolektorëve të qeverisë përmes Payment Gateway.

Klientët tanë si dhe klientët e tjerë, vendorë dhe ndërkombëtarë, do të jenë në gjendje të paguajnë faturat e tyre përmes kësaj platforme duke përdorur kartelat MasterCard dhe Visa Cards.

4.3 Bankimi i NVM-ve

Segmenti i bankimit të NVM-ve gjatë vitit 2020 ka dëshmuar edhe një herë se është një pretendent kryesor në industri edhe kur përballet me sfida, siç është pandemia globale COVID19. Gjatë vitit 2020, Departamenti i NVM-ve vazhdoi të mbështeste klientët në aktivitetet e tyre të përditshme të biznesit dhe i ndihmoi ata të kapërcenin këto pengesa të reja. Masat e marra nga banka ndryshonin në varësi të asaj që i duhej klientit, të tilla si pauzat e ripagimit të kredisë, moratoriumet për klientët ekzistues dhe vazhduan të siguronin financim për klientët premtues.

Portfolio i huadhënies për NVM-të gjatë vitit 2020 ka shënuar rritje stabile prej 5.03 milion € ose 3.8%. Paralelisht me këtë, një trend pozitiv i depozitave vazhdoi gjatë gjithë vitit, me një rritje prej 13.2 milion € ose 14.4%. Pavarësisht sfidave të tregut dhe pandemisë globale, bankimi i NVM-ve arriti ta ruajë pjesën e saj të tregut, ndërsa edhe duke e fokusuar vëmendjen e tyre në cilësinë e portfolios që rezultoi me KJP prej 2.97%.

Modeli dhe strategjia e biznesit të segmentit të bankimit të NVM-ve përqipet për kënaqshmërinë e lartë të klientëve, me fokus të veçantë në komunikimin e klientit dhe nxitjen e marrëdhënieve të ngushta me ta. Përmes bashkëpunimeve strategjike me palë të treta, banka vazhdon të ofrojë produkte dhe shërbime që i plotësojnë nevojat financiare dhe jo financiare të klientëve. Partneritetet me fondet e garancive të tilla si Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) kanë lehtësuar qasjen në kapital për klientët e NVM-ve dhe si rrjedhojë kanë kontribuar në rritjen e niveleve të punësimit dhe konkurrencën e tregut.

Aktivitetet në departamentin Agro ishin në vend të qëllimeve të bankës dhe vëmendje e veçantë iu dha fermerëve me sfidat që u shfaqën gjatë vitit. Përkundër këtyre sfidave, TEB Sh.A. arriti të ruajë pjesën e tregut në këtë segment dhe ofroi produkte të përshtatura për të adresuar çdo çështje me të cilën u përballën klientët Agro. Besimi dhe qëndrueshmëria e dhënë nga banka në lidhje me

klientët e saj ishin përcaktuese për adresimin e sfidave të tregut dhe situatës së përgjithshme të krijuar në vitin 2020.

Banka ka qenë në gjendje të ruajë këtë pozitë në treg dhe marrëdhëniet me klientët për shkak të procedurave dhe sistemeve efikase të brendshme. Si i tillë, një qëllim tjetër për këtë departament është të zhvillojë më tej proceset brenda dhe të minimizojë numrin e inputeve manuale. Ndërsa proceset e brendshme vazhdojnë të përmirësohen, kështu rritet edhe lehtësia në të cilën aktivitetet e biznesit të tilla si blerjet dhe shitjet e klientëve kryhen nga stafi. Këto përmirësime zbatohen shpejt dhe vazhdimisht dhe kënaqshmëria e klientëve vazhdon të rritet ndërsa produktet bëhen më të lehta për t'u përdorur dhe proceset bëhen më të shkurtra.

Ndërsa banka kalon në një kanal më digjital të produkteve dhe shërbimeve, bankimi elektronik vazhdon të jetë prioritet për departamentin. Rrethanat e krijuara nga pandemia konfirmuan domosdoshmërinë për shërbime të tilla dhe ishin ideale në rritjen e përdorimit të përgjithshëm të kanaleve alternative të shpërndarjes. Klientët ishin të etur të kalonin në platforma të tilla si TEB Mobile Business dhe E-Banking pasi ato ofruan përdorim të lehtë dhe kosto më të ulët.

Objektivat e Bankës për vitin 2021 janë më ambicioze pasi po përshtatemi me organizimin e ri të jetës, bashkëjetesën me pandeminë, stabilitetin dhe pozitën e bankave në treg, përvojën e stafit dhe angazhimin për sukses. Banka do të ofrojë zgjidhje dhe kanale financiare të dizajnuara më mirë me qëllim që të mbështesë klientët së bashku me zhvillimin e biznesit dhe idetë e reja për treg.

Shërbimet më të mira dhe cilësore, fleksibiliteti dhe bankimi të bazuara në nevojat e klientëve janë forcat kryesore shtytëse për bankën dhe Departamentin e NVM-ve. Projektet e vazhdueshme dhe të reja të efikasitetit janë shtylla e kësaj rruge. Këto forca dhe strategji janë ato që na dallojnë në këtë mjedis dinamik. TEB Sh.A. vazhdon të konfirmojë aftësitë e veta, vetëdijen e tregut dhe më e rëndësishmja, angazhimin e stafit drejt këtyre objektivave.

4.4 Bankimi komercial dhe i korporatave

Segmenti tregtar dhe korporativ në TEB Sh.A. ka zhvilluar një qasje të përshtatur ndaj nevojave të klientit të saj. Qasja jonë na ka mundësuar që të nxisim marrëdhënie produktive me të gjithë klientët tanë, si dhe ka forcuar pozitën tonë në treg në segmentin tregtar dhe korporativ. Megjithëse segmenti është i ndërlikuar, strategjia e departamentit tonë përqendrohet në ofrimin e zgjidhjeve të personalizuar dhe shërbimeve të përparuara të menaxhimit të parave të gatshme që sigurojnë vlerë shtesë si për klientët ashtu edhe për Bankën.

Në vitin 2020, ne u përqendruan në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe fitimit të gjithëmbarshtëm. Edhe kur sfidohet nga kushtet e tregut siç janë rënia e normave të interesit, departamenti arriti të ruajë një qasje dhe angazhim proaktiv ndaj objektivave të Bankës.

Të qenit i lidhur me një grup bankar ndërkombëtar ka lehtësuar procesin e pranimit të një numri të konsiderueshëm të kompanive të huaja shumëkombëshe që operojnë në Kosovë. Portfolio ynë i larmishëm i klientëve vazhdon të rritet qëndrueshëm ndërsa mbulon një numër industrish. Vëmendje e veçantë iu kushtua projekteve në sektorët e prodhimit dhe eksportit pasi ato konsiderohen me potencial të lartë për rritjen e korporatave si dhe të dobishëm për ekonominë në përgjithësi.

Në një farë mase, klientët tanë u prekën gjithashtu nga ndryshimet e tregut të shkaktuara nga pandemia globale. Gjatë kësaj kohe, ne ishim në kontakt të ngushtë me klientët tanë dhe i ndihmuam të lundrojnë në ofertat të tilla si pauzioni i kësteve të kredive dhe moratoriumi. Pavarësisht nga luhajtjet globale, ne ishim në gjendje të rrisim portfolion tonë me 4.83 milion €, ose një rritje prej 7%. Departamenti arriti një rritje prej 21 milion € në transfere ndërkombëtare dalëse, ose një rritje prej 10% në krahasim me një vit më parë. Depozitat tona gjithashtu u rritën me 14.83 milion €, 23% rritje. Rezultatet pozitive u arritën edhe në KJP-të, ku rënia gjatë fundvitit ishte nga 1.21% në 0.78%.

Zgjerimi i kanaleve alternative të ofrimit të shërbimeve dhe rritja e zgjidhjeve të menaxhimit të parave është një qasje e rëndësishme strategjike për vitet e ardhshme, sepse tregu i biznesit po kërkon zgjidhje më të shpejtë dhe më efikase në bankimin e tyre të përditshëm. Gjatë vitit 2020, ne kemi vazhduar të përmirësojmë shërbime të tilla si kutia e depozitave/arkëtimi i parave të gatshme, rrjeti i POS-ave dhe kartelat e debitit dhe të kreditit të dallueshme lidhura me biznesin. Për një numër të zgjedhur klientësh, ne gjithashtu ofruam shërbime të tilla CIT/para në tranzit për arkëtimet ditore të pareve të gatshme.

Një fokus tjetër i rëndësishëm i Bankës për këtë vit ishte kryerja e operacioneve të brendshme të shpejta dhe efikase. Kjo iniciativë u tregua mjaft e suksesshme pasi shumë klientë iu përshtatën e-banking dhe TEB Mobile Business për aktivitetet e tyre të përditshme të biznesit. Kohë dhe përpjekje e konsiderueshme u investua në promovimin e gamës së gjerë të përfitimeve të opsioneve që kanalet alternative të shpërndarjes mund të sigurojnë një biznes. Si rezultat, 90% e totalit të transaksioneve janë kryer duke përdorur e-banking. Ky ndryshim në sjelljen e klientëve përbën një arritje të rëndësishme për departamentin, sepse zvogëlon ngarkesën e punës në degë dhe i mundëson ekipeve të degës të kalojnë më shumë kohë në role këshillimi dhe përkrahjeje për klientët. Kjo tregon se fusha e bashkëpunimit me klientët korporata është e kufizuar vetëm nga kreativiteti dhe imagjinata, pasi mundësitë janë të pafundme.

Ne jemi të përkushtuar të forcojmë bashkëpunimin tonë me segmentin korporativ dhe të pozicionohemi si lojtarë të fortë të tregut. Strategjia jonë për vitin 2021 mbetet e përqendruar në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe përfitimin, si dhe zhvillimin e produkteve që përshtaten më mirë me nevojat e klientëve tanë.

4.5 Financimi tregtar

Kemi vazhduar të përkrahim klientët tanë, duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave tregtare për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera, dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Përkrahur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne vazhdimisht zgjerojmë mbulimin tonë gjeografik dhe gamën e produkteve tona.

E kuptojmë se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është sfidë - suksesi kërkon njohuri të gjera profesionale dhe rrjet efektiv, dhe TEB i ka të dyja këto.

Produktet e financave tregtare për operacionet e biznesit dokumentar përfshijnë letër kreditë e importit dhe eksportit, skontimin në letër kredi, garancitë vendore dhe ndërkombëtare, letër kreditë në pritje (stand-by) dhe arkëtimet. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2011 me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të mirë dhe më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letërkreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, gjithashtu kemi zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

TEB Sh.A. ka mbajtur përkrahjen e vazhdueshme për klientët dhe synon të jetë gjithmonë partneri më i besueshëm dhe i preferuar i biznesit në Kosovë, duke vazhduar ta ndajë profesionalizmin dhe ekspertizën në produktet e financave tregtare me klientët tanë duke ofruar edhe zgjidhje inovative.

Në vitin 2020 do të vazhdojmë t'i mbështesim klientët tanë, duke ofruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jenë udhëzuesit tanë, sepse i shohim këto si elemente që të bëjnë të dallueshëm në një botë që lëviz me shpejtësi.

4.6 Sistemet e pagesave

TEB-i ka qenë e para që ka futur në funksion Sistemin e debitimit direkt (SDD), produkt unik në tregun e Kosovës që është e dizajnuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B (biznes me biznes). Funksioni i saj kryesor është përmirësimi i likuiditetit financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia dhe ndërfaqet më të fundit që lehtësojnë procesimin e plotë dhe automatik të pagesës së faturave. Kjo i mundëson klientëve që të na autorizojnë për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Kërkohet vetëm një formular i autorizimit (i nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet në mënyrë automatike. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD-së që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin e SDD-së, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga arkëtimi i hershëm i të arkëtueshmeve. Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje 24/7 në shërbime bankare të sigurt, të përshtatshme dhe të shpejta. Klientët tanë mund t'i transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procesojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e shërbimeve komunale dhe debi të tjera të rregullta, (si rryma, uji dhe telefoni). Për më tepër, klientët mund t'i kryejnë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) në mënyrë automatike duke përdorur e-banking. Projekti i PBKR - Sistemit të Pagesës Bruto në Kohë Reale ka përfunduar me sukses në korrik të vitit 2016 dhe të gjitha pagesat vendore duke përfshirë pagesat në vlera të larta tani procesohen në kohë reale.

Në ditët e sotme, transferet e shpejta dhe të sigurt ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie përtej shtetërore. Kjo është arsyeja pse ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë pagesa ndërkombëtare. Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë me mbi 40 marrëdhënie të huaja korrespondente dhe 10 banka për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it, rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë që jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

TEB Sh.A. u bë anëtare e SWIFT GPI (Inovacioni i Pagesave Globale) që nga dhjetori 2020. Të jesh pjesë e GPI-së do të thotë që institucioni financiar mund të dërgojë dhe marrë fonde shpejt dhe në mënyrë të sigurt kudo në botë me transparencë të plotë.

Si standard i ri në pagesat globale SWIFT GPI mundëson monitorim dhe gjurmim të të gjitha pagesave ndërkufitare nga njëra anë në tjetrën në kohë reale. Databaza Tracker jep vizibilitet fund e krye mbi statusin e një transaksioni pagese nga kur dërgohet dhe derisa të konfirmohet. Kjo do t'u mundësojë të gjitha bankave GPI të ndjekin të gjitha udhëzimet e pagesave ndërkufitare në çdo kohë, duke përfshirë të gjithë aktivitetin e pagesave të tyre.

4.7 Thesari dhe MPD

(Menaxhimi i Pasurive dhe Detyrimeve)

Pandemia globale e çoi ekonominë botërore në një ngërç, përgjysmoi rritjen ekonomike globale dhe disa vende u zhytën në recesion në vitin 2020.

Kosova është goditur rëndë nga pandemia. Aktiviteti ekonomik vlerësohet të bjerë me 6% në vitin 2020 dhe parashikohet të rimëkëmbet me 4.5% në vitin 2021.

Përkundër kushteve të pafavorshme, sektori bankar mbeti i fortë dhe i menaxhuar mirë me kapital të fortë, ruajtje të likuiditetit dhe kredi të ulët jo-performuese (mesatarisht 2.7%).

Në TEB Sh.A, ne jemi më se të vetëdijshëm se një Departament i fortë dhe gjithëpërfshirës i MPD-Th në gjendje të kryejë menaxhim të kujdesshëm të pasurive dhe detyrimeve është thelbësor për ofrimin e shërbimeve financiare të qëndrueshme dhe të sigurta ndaj klientëve. Ne duhet të jemi të sigurt se financimi ynë është i fortë dhe të gjithë treguesit janë në përputhje me kërkesat e menaxhimit të rrezikut.

MPD-Th është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut operacional dhe strukturor të likuiditetit të Bankës, rrezikut të këmbimeve valutore dhe rreziqeve të normës së interesit në bilancin e gjendjes dhe mbrojtjen e reputacionit të bankës.

Qëllimi ynë kryesor është të sigurojmë që banka të ketë nivelin e kërkuar të likuiditetit në të gjitha valutat aktive në mënyrë që të përmbushë të gjitha detyrimet tona në kohë me koston minimale të mundshme dhe për të maksimizuar kthimet e përshtatura me rrezikun për një kohë më të gjatë. Kjo po bëhet me rrjedhën efektive afatshkurtër të parasë së gatshme dhe menaxhimin afatgjatë të likuiditetit, duke krijuar strategji investimi dhe financimi bazuar në kushtet mbizotëruese të tregut, normat e interesit dhe trendet e vëllimit të zërave të bilancit dhe parametrave të rrezikut.

MPD-Thesari ka njohuri shumë të mirë për rrezikun në kryerjen e afarizmit të vet që është në përputhje me qasjen e kujdesshme të TEB Sh. A., Vendimet merren duke analizuar vazhdimisht rreziqet e mundshme dhe mundësitë e tregut brenda kornizës së rregullave të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës dhe në përputhje me parimet e zvogëlimit dhe zbutjes së rrezikut të vendosura nga brenda dhe nga jashtë

Departamenti gëzon mbështetjen e fortë të kompanive të tij amë franceze dhe turke dhe qasjen ekskluzive në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare të kapitalit dhe parave në kontrollimin e rreziqeve të tij dhe kryerjen e detyrave të tij.

Ç'ka më tutje?

Viti 2020 ishte një vit i suksesshëm sa i përket performancës së përgjithshme të bankës, ndërsa pasuritë arritën mbi 662.1 milion EUR që nga fundviti. Kreditë bruto dhe portofoli i depozitave u rritën ndjeshëm krahasuar me vitin 2019 dhe klientët retail mbetën si burimi kryesor i qëndrueshëm i financimit në vitin 2020.

Viti 2021 nuk do të jetë aspak një vit i lehtë, likuiditeti i lartë, normat negative të interesit në tregjet ndërkombëtare, rritja e konkurrencës do të ndikojnë dhe do të ushtrojnë presion mbi çmimet.

Pasiguria në ekonominë globale do të mbetet e lartë për shkak të vazhdimin të pandemisë dhe programet efektive të vaksinimit do të jenë përcaktuese për perspektivat e ardhshme.

Situata komplekse politike krijon pasiguri shtesë. Një vazhdimësi e qeverive jetëshkurtra gjatë viteve 2019-20 kanë vonuar miratimin e legjislacioneve kryesore.

Pavarësisht nga kushtet, MPD-Th do të sigurojë që banka do të mbetet likuide dhe fitimprurëse me vetëdijesimin më të lartë për rrezikun.

4.8 Burimet Njerëzore

Të gjithë kishim një vit biznesi unik dhe sfidues pas nesh. Pandemia COVID-19 ka ndikuar tek të gjithë ne dhe ka bërë thirrje për veprime të shpejta dhe megjithatë të konsideruara mirë, veçanërisht në fushën e BNj-ve. Shëndeti i punonjësve tanë është prioriteti ynë më i lartë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, vazhdimësia e biznesit duhet të sigurohet. Ne ishim në gjendje të ndërtonim mbi masa fleksibile të cilat do të jemi në gjendje t'i adaptojmë në disa kontekste që shfaqen në kontekstin e "Normales së Re".

BNj-të luajtën një rol parësor në krijimin e një politike të përkohshme në pandemi për të mbuluar çështjet dhe pyetjet e parashikuara që rezultojnë nga ndryshimet e mëdha në vendin e punës të bëra të nevojshme nga pandemia.

Përveç vazhdimit të këshillimeve shëndetësore shtetërore dhe lokale, BNj-të vazhdojnë të koordinojnë dhe ndihmojnë të gjitha departamentet dhe degët. Gjatë vitit 2020, ekipi i BNj-ve luajti rol jetik në sigurimin që banka jonë të arrijë objektivat e saj të rritjes dhe përfitimit dhe se ne jemi në gjendje të kalojmë përmes një larmie fazash dhe sfidash të ndryshme ekonomike. Ne gjithashtu e shohim si përgjegjësinë tonë të kontribuojmë në zotërimin e sfidave themelore me të cilat përballet shoqëria sot.

Punonjësit tanë janë çelësi i suksesit. Forcimi i një përvoje pozitive të punonjësve dhe arritja e një shkalle të lartë të angazhimit do të thotë edhe zhvillim dhe ruajtje e vazhdueshme e marrëdhënieve të mira me punonjësit dhe menaxherët tanë. Një nivel i lartë entuziazmi, energjie dhe motivimi janë thelbësorë në arritjen e performancës më të madhe të punës, krijimtarisë, produktivitetit dhe inovacionit. Arritja e këtij qëllimi është objektivi ynë kryesor dhe ne përpiqemi ta realizojmë atë.



Zhvillimi i karrierës

Në fund të vitit 2020, ekipi i plotë i TEB-it kishte 594 punonjës. Gjatë këtij viti u rekrutuan gjithsej 64 profesionistë të shërbimeve bankare dhe financiare. Në përputhje me objektivat dhe parimin transparent të komunikimit të TEB-it, vendet e lira të punës u publikuan për të gjithë punonjësit në tërë bankën, përfshirë praktikantët, gjë që u dha atyre mundësi të barabarta për të aplikuar dhe rritur brenda. Si rezultat, 18 praktikantëve iu dha shansi të marrin sfidat dhe të bëhen pjesë e bankës sonë, ndërsa 17 punonjës u ngritën në pozita.

Megjithëse kemi vërejtur që stafi ynë vazhdon të rritet profesionalisht edhe përballë vështirësive, ne nuk ishim në gjendje të ofronim trajnimet që kishim planifikuar në fillim të vitit. Ne filluam së organizuar programin e qendrës së vlerësimit për performues të lartë dhe kandidatë të mundshëm për pozita menaxheriale dhe programin e trajnimit të trajnerëve, për trajnerët tanë të brendshëm. Edhe pse nuk mund të organizonim trajnime ballë për ballë, ne kemi ofruar trajnime online përmes platformës My Development, Coursera dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Ndryshimi i menaxhimit

Për çdo projekt me një ndryshim specifik të menaxhimit, procesi është miratuar dhe përshtatur për të siguruar lehtësinë e tranzicionit, si dhe përqaftimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë nga të gjithë punonjësit në tërë organizatën. Në vitin 2020, u ekzekutuan aktivitetet e menaxhimit të ndryshimit, duke synuar të ndryshojnë mendësinë e menaxherëve tanë dhe ne i kemi bërë ata llogaridhënës për projektet e shkathëta përmes:

- Development of Performance Management System
- Përcaktimit të treguesve të saktë kryesorë të performancës (TKP)
- Lidhjes së masave të performancës me sistemin e shpërblimit dhe vazhdimësisë
- Komunikimit transparent dhe konsistent



Aktivitetet shoqërore

Ne kujdesemi për lumturinë e punonjësve tanë dhe motivimin e tyre. Përveç sinergjisë së punës, ne kujdesemi që ata të kenë aktivitete sociale për t'i përmirësuar marrëdhëniet e tyre dhe për të menduar se si ta riorganizojnë mjedisin e tyre të punës për të qenë më miqësor.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të organizojmë ndonjë aktivitet shoqëror gjatë vitit 2020, ne kemi gjetur një mënyrë për të festuar ditë të veçanta si festat fetare, Ditët e Vlerësimit të Punëtorit dhe Viti i Ri. Janë prezantuar dhurata të ndryshme dhe mesazhe festive janë shpërndarë për të gjithë punonjësit.

Ç'ka më tutje?

Ekipi i Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të:

- Ofrojë mbështetje të plotë për të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin në rekrutimin dhe mbajtjen e performuesve më të mirë. Ai do të fokusohet më tej në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, si dhe t'u ofrojë atyre rrugë të reja të karrierës dhe mundësi për lëvizje të brendshme.
- Organizojë dhe ndjekë vazhdimisht trajnime elektronike brenda/jashtë zyrës, për t'u siguruar se zhvillimi i punonjësve tanë është në përputhje me kërkesat dhe standardet e grupit.
- Organizojë programe të ndryshme të praktikës për të krijuar një grup të mundshëm kandidatësh për rekrutim përmes bashkëpunimit të afërt me Universitetet, i cili do të synojë dhe angazhojë studentët më të mirë që janë në procesin e përfundimit të studimeve të tyre.
- Vazhdojë organizimin e aktiviteteve/ngjarjeve për punonjësit për të kontribuar në motivimin e tyre.

Departamenti i BNj-ve mbetet i përqendruar në ndërtimin e marrëdhënieve me punonjësit dhe do të vazhdojë të rrisë kënaqëshmërinë e punonjësve, gjë që do të kontribuojë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të përgjithshme të Bankës.

4.9 Teknologjia informative

Transformimi i vizionit tonë në teknologji gjithmonë ka qenë sfidë, sidomos për t'u përshtatur me sjelljen unike njerëzore për ta formësuar cilësinë e rrugës së klientit dhe efektivitetin e zgjidhjeve teknologjike. Si departament i TI-së, qasja jonë është të iniciohet ndryshimi përmes thjeshtësisë, që është gjithmonë mënyrë e mirë për t'i udhëzuar klientët.

TI është sektor në rritje të shpejtë dhe i ndryshueshëm në sektorin bankar, punon shumë për t'i përkrahur klientët, dhe për të parë përmes syve të tyre; ana jonë e fortë është dhënia e përparësisë perspektivës së klientit, duke ndryshuar gjërat për t'u përshtatur ashtu siç e kuptojnë ata.

Ofrimi i shërbimeve dhe produkteve për sigurinë e klientëve tanë është një nga detyrat tona më të rëndësishme. Vëllimi dhe llojet e sulmeve kibernetike po rriten në sektor dita - ditës, TEB Sh.A. punon shumë për të zbatuar teknologji të fundit të sigurisë për t'i mbajtur sistemet e saj të informacionit të sigurta dhe nën kontroll.

Infrastruktura e TI-së

Pavarësisht sfidave të reja, pandemia përshpejtoi procesin e ndryshimit të punëve dhe proceseve të vjetra, duke kërkuar nga ekipi që të bëhen ndryshime të shpejta për zgjidhje sa më të përshtatshme. Për një kohë të shkurtër, ne ndryshuam modalitetin e punës dhe krijuam një sistem të punës nga shtëpia.

TEB Sh.A. implementoi zgjidhje në fireëall të gjeneratës së ardhshme duke siguruar më shumë mbrojtje, shikueshmëri dhe kontroll mbi aplikacionet, përdoruesit dhe përmbajtjen brenda fireëall-it duke përdorur një arkitekturë shumë të optimizuar të harduerit dhe softuerit.

TEB Sh.A. ka projekte të vazhdueshme me BNPP për të mbrojtur shërbimet e saj me zgjidhjen DDOS për grup dhe aktivisht duke punuar në standardet NIST për t'u harmonizuar me grupin duke përfshirë vazhdimësinë e TI-së.

Ajo ka forcuar sigurinë e kompanisë me projektin Advance Threat Prevention, zbatimin e shërbimeve të azhurnuara të lidhjes së sigurt nga distanca dhe shumë përmirësime të tjera.

Harmonizimi me rregulloren e TI-së e bankës qendrore gjithashtu ka qenë brenda projekteve të rëndësishme.

Ç'ka më tutje?

TEB Sh.A. do të ripërtërijë sasinë e dukshme të pajisjeve të TI-së në qendrën e saj të të dhënave dhe lokacionet e pikës fundore. Kjo do të sigurojë shkallëzim, disponueshmëri dhe performancë për rritjen e kërkesave të biznesit dhe TI-së për vitet e ardhshme.

Pajisjet e rrjetit: Është bërë investim i madh për pajisjet e rrjetit të ripërtëritjes për një siguri më të mirë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, ndryshimin e komutatorëve (switches) të vjetër të degëve me komutatorë më të përparuar, ndryshimin e routerëve të bankomatëve me lloje alternative të lidhjes, routerëve për degët që është një projekt i cili do të zgjasë një vit.

Zëvendësimi i ndërprerësit kryesor është një tjetër ndryshim i madh për organizatën, duke siguruar rritjen e kapacitetit dhe qarkullimit për së paku pesë vitet e ardhshme. Mbështetja e automatizmit dhe rrjetit të përcaktuar nga softueri.

Serverët bankar bazë: Serverët bazë të aplikacioneve do të zëvendësohen me modelin më të ri të makinave IBM, duke fuqizuar shërbimet bazë të organizatës dhe duke siguruar performancë më të lartë deri në 70%, karakteristika të reja si disponueshmëria e lartë e energjisë që mbulojnë gjithashtu pesë vitet e ardhshme të nevojave të biznesit.

Serverët Blade: TEB Sh.A. ka 97% të serverëve të saj që operojnë në platforma virtuale. Zëvendësimi i shasisë Blade do të fillojë nga mesi i vitit për shkak të vjetërsimit të pajisjeve të vjetra.

Përmirësimi i sistemeve rezervë: Planifikimi afatgjatë është bërë për të përmirësuar performancën e sistemeve rezervë, duke ulur kohën e rezervimit dhe rivedosjes, duke arritur RTO dhe RPO të procesit të TI-së dhe vazhdimësisë së biznesit, të kenë vizion, siguri dhe integritet më të mirë me platformat e tjera.

Përmirësimi i procesit është aktiviteti me vlerën më të shtuar në ciklin e jetëgjatësisë së menaxhimit të procesit të biznesit. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e teknologjive digjitale, nevoja e kompanisë është e mbarsur me perspektivën e trajtimit edhe si projekte të digjitalizimit, si rezultat i një projekti në vijim, ne do të vazhdojmë me projekte që përmirësojnë eficiencën e proceseve si Platforma për Menaxhim të Dokumenteve dhe të tjera.

4.10 Siguria e informacionit dhe Mbrojtja e të dhënave

Siguria e informatave

Ne vazhdimisht dhe nga afër monitorojmë të gjitha dobësitë e sigurisë, duke marrë masa për ta mbrojtur bankën dhe klientët tanë në përputhje me rrethanat. Përmirësimet në sistemet tona kanë përfunduar për të siguruar një infrastrukturë të sigurt. Qëllimi ynë është të sigurojmë shërbimet më të sigurta për klientët tanë duke mbajtur shërbimet më të mira dhe kanalet alternative.

Gjatë vitit 2020, për shkak të situatës pandemike, ne kemi aplikuar një sistem të sigurt për lidhjet në distancë, në mënyrë që stafi i Bankës të kryejë me sukses punën e vet.

Banka është pjesë e Programit të Sigurisë Kibernetike të Grupit që bazohet në NIST (Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë), me ambicien për të avancuar aftësitë e BNPP për të luftuar rreziqet kibernetike. Një model është krijuar bazuar në referencën NIST që mbulon të gjitha temat e Sigurisë Kibernetike dhe është përshtatur me Strategjinë e TEB dhe të Grupit për siguri kibernetike. Për ta ngritur vetëdijen për sigurinë e informacionit dhe për të rritur kulturën kibernetike, të gjithë punonjësit kanë kryer programe të mësimit elektronik dhe trajnimit në vend të punës përfshirë ata të sapoardhurit. Këto programe trajnimi janë përkrahur me email, si dhe fushata phishing.

Banka po kryen teste të rregullta depërtimi nga një kompani e palës së tretë. Kjo është një metodë e pavarur e vlerësimit të sigurisë së sistemeve bankare.



Mbrojtja e të dhënave

Mbrojtja e të dhënave është një e drejtë themelore, e mbrojtur me ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave (RrPMDh). Për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë, përpunimi i të dhënave personale i nënshtrohet kontrollit nga një autoritet i pavarur, në këtë rast Agjencia për Informim dhe Privatësi e cila është autoritet i pavarur për mbrojtjen e të dhënave, e ngarkuar me detyrën që të sigurojë që institucionet dhe organet respektojnë ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Ne i kryejmë funksionet tona në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin për mbrojtjen e të dhënave dhe synimi ynë është që të jemi sa më transparentë në punën tonë, duke u shërbyer interesave të klientëve tanë.

Ne u shërbejmë interesave të klientëve tanë dhe institucionit duke siguruar që institucioni i respekton parimet e mbrojtjes së të dhënave në praktikë. Ne kontribuojmë në politikën më të gjerë për atë që ajo ndikon në mbrojtjen e të dhënave. Duke përdorur ekspertizën, autoritetin dhe kompetencat tona formale, ne synojmë ta zhvillojmë vetëdijen për mbrojtjen e të dhënave si një e drejtë themelore dhe si pjesë jetike e institucionit,


Ne e përqendrojmë vëmendjen dhe përpjekjet tona në fushat e politikave ose administratës që paraqesin rrezikun më të lartë të mos-pajtueshmërisë ose ndikimin më të madh në privatësi. Ne veprojmë në mënyrë selektive dhe proporcionale. Gjatë vitit 2020, njësia e mbrojtjes së të dhënave me përkrahjen e menaxhmentit, iu qas mbrojtjes së të dhënave në një mënyrë të re duke i përmirësuar masat teknike dhe organizative kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm të të dhënave dhe kundër humbjes aksidentale, shkatërrimit ose dëmtimit të të dhënave, duke zbatuar mjete të ndryshme të PHDh (Parandalimi i humbjes së të dhënave) dhe të klasifikimit të të dhënave.

Gjithashtu, banka ka treguar kujdes të duhur për transferimin e të dhënave personale në vendet brenda dhe jashtë Zonës Ekonomike Evropiane, duke vlerësuar të gjitha marrëveshjet kontraktuale për transferimin e të dhënave personale.

Duke marrë parasysh të drejtat e subjekteve të të dhënave bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe RrPMDh, institucioni ka ndërmarrë masat e nevojshme duke publikuar procedurën e duhur, me informacionin e nevojshëm dhe një qasje ndaj procesit.


5.1 TEB Sh.A. Struktura Organizative

DREJTORI



* Raporton Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve

** Raporton Komitetit për Menaxhim të Rrezikut dhe Bordit të Drejtorëve



5.2.Bordi i Drejtorëve i TEB Sh. A.

Bordi i Drejtorëve i TEB Sh. A.

Kryetar: Jacques Roger Jean Marie Rinino
Zëvendës Kryetar: Dr. İsmail Yanık / deri më 9 mars 2020
Zëvendës Kryetar: Alp Yılmaz
Zëvendës Kryetar: Ayşe Aşardağ
Anëtar: Birol Deper
Anëtar: Esra Peri Aydoğan
Anëtar: Osman Durmuş
Anëtar: Sabri Davaz / deri më 9 mars 2020
Anëtar: Dr. Nilsen Altıntaş
Anëtar: Luc Delvaux / fillojnë nga 9 mars 2020
Anëtar: Ayse Meral Cimenbicer / fillojnë nga 9 mars 2020
Drejtor Menaxhues dhe Anëtar: Orçun Özdemir

Trupi drejtues

TEB Sh.A ka një bord të drejtorëve që aktualisht përbëhet nga dhjetë anëtarë me përvojë të gjerë në punën bankare. Bordi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me kërkesat e përcaktuara në statutin e Bankës dhe në përputhje me gjithë legjislacionin përkatës dhe kërkesat e përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi mbledhet të paktën çdo tre muaj.

Roli i Bordit të Drejtorëve

Edhe pse detajet janë përcaktuar në nenet 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, detyra kryesore e Bordit është t'i mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe afariste të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë, strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikës afariste të saj duke përfshirë njësitet operative dhe administrative, nën-njësitet dhe funksionet e tyre, pozitat mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë. Bordi i Drejtorëve përcakton dhe krijon strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit të bankës, rishikon dhe miraton rregullimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë për aktivitetet e biznesit në bazë të bilancit gjashtëmuor të gjendjes, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë shumicën e votave nga anëtarët të cilët ose janë të pranishëm ose votojnë me ndërmjetës.

5.3 Komitetet

Komitetet e Bordit të TEB Sh. A.

Në përputhje me Statutin e TEB Sh.A., rregulloret dhe kërkesat e Bankës, Bordi ynë emëron rregullisht, të gjithë të përbërë nga anëtarët e Bordit me përvojë përkatëse dhe ekspertë të jashtëm. Bordi gjithashtu mund të krijojë komisione ad hoc dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, aty ku duhet dhe është e përshtatshme. Sipas nenit 22 të Statutit të TEB Sh.A. të datës 24 qershor 2013. Komitetet mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve, drejtorëve dhe punonjësve të Bankës, si dhe nga radhët e personave të tjerë jashtë bankës, duke iu nënshtruar kufizimeve në Statut. Komitetet nuk duhet të marrin vendime në vend të Bordit, por do të veprojnë si këshilltarë tij, sipas rekomandimeve për aprovimin e artikujve nën kompetencat e tyre.

Komiteti i Auditimit

Kryetar: Luc Delvaux / fillojnë nga 9 mars 2020

Kryetar: Sabri Davaz / deri më 9 mars 2020

Anëtar: Ayşe Aşardağ

Anëtar: Birol Deper

Anëtar: Esra Peri Aydoğan

Anëtar (external expert): Bashkim Uka

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komiteti i Auditimit shërben si komitet i pavarur dhe objektiv për ta monitoruar integritetin e procesit të raportimit financiar të bankës. Komiteti i Auditimit e ndihmon Bordin e Drejtorëve në përmbushjen e përgjegjësiave të mbikëqyrjes përmes shqyrtimit raporteve financiare dhe informacioneve të tjera financiare të bankës, qeverisja, menaxhimi dhe kontrolli i rreziqeve, konfigurimi ("GRC"). Më tej, i mbikëqyrë dhe monitoron funksionet e auditimit të brendshëm, kontrollin e brendshëm dhe pajtueshmërinë rregullative të bankës duke siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, politikat dhe procedurat e bankës.

Komiteti i auditimit takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i lartë për kredi (CRECOM)

Kryetar: Osman Durmuş
Zëvendës Kryetar: Haluk Kırçalı
Anëtar: Alp Yılmaz
Anëtar: Alp Özateşler

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Ky komitet është i fuqizuar nga Bordi për të marrë vendime për kredi për shumat në mes të 750,000€ dhe 3.5 milion €.

Komiteti i menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve (KPD)

Kryetar: Alp Yılmaz/ fillojnë nga 9 mars 2020
Kryetar: Dr İsmail Yanık / deri më 9 mars 2020
Zëvendës Kryetar: Orçun Özdemir
Anëtar: Serhan Özarslan
Anëtar: Tolga Gürdem

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimi i tregjeve financiare, duke kontrolluar situatën, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrjen e vendimeve, të gjitha këto në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të MPD-Th-së në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Komisionit për MPD;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve nga ana e Departamentit të MPD-Th-së për sa i përket kriterëve të mëposhtme;
- Sigurimi i respektimit të raporteve të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KPD-i;
- Monitorimi i rezervave të domosdoshme minimale të përcaktuara nga BQK-ja.

Komiteti për pasuri dhe detyrime takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut (KMRr)

Kryetar: Osman Durmuş
Zëvendës Kryetar: Alp Yılmaz
Anëtar: Jacques Roger Jean Marie Rinino
Anëtar: Luc Delvaux / fillojnë nga 9 mars 2020

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Qëllimi i Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut (KMRr) është të mbikëqyrë profilin e rrezikut, të aprovojë dhe të monitorojë kornizën e administrimit të rrezikut të Bankës në kontekstin e strategjisë së shpërblimit të rrezikut të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve. Si i tillë, Komiteti për menaxhimin e rrezikut është përgjegjës për monitorimin e të gjithë komponentëve të lidhur me rrezikun dhe funksionet që rrjedhin nga kreditë, tregu, likuiditeti, çështjet operacionale, të reputacionit, dhe rreziqet tjera rregullative.

Komiteti për menaxhimin e rrezikut takohet në baza mujore.

Komiteti i provizionimit (KP)

Kryetar: Osman Durmuş
Zëvendës Kryetar: Esra Peri Aydoğan
Anëtar: Orçun Özdemir

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Përgjegjësia kryesore e Komitetit të provizionimit është vlerësimi i procesit të përgjithshëm të zhvlerësimit të kredisë, në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme të bankës, me kërkesat e BQK-së si dhe me standardet e Grupit dhe të SNRF-së. Për më tepër, komiteti është përgjegjës të verifikojë dispozitat përkatëse për çështjet ligjore ndaj bankës dhe dispozitat në lidhje me incidentet e rrezikut operacional. Komiteti ka autoritetin për të kryer ose autorizuar shqyrtime të çdo çështjeje brenda fushës së tij të përgjegjësisë. Komiteti i provizionimit takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i kompensimit (KK)

Kryetar: Alp Yılmaz
Anëtar: Jacques Roger Jean Marie Rinino
Anëtar: Dr. Nilsen Altıntaş
Anëtar: Orçun Özdemir

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Komiteti i pagesës është themeluar nga Bordi i Drejtorëve i TEB Sh.A., dhe është përgjegjës për përcaktimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikës së pagesave.

Komiteti i kompensimit takohet së paku dy herë në vit.

5.4 Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm

Bordi i Drejtorëve i TEB Sh.A. ka themeluar Departamentin e auditimit të brendshëm si një nga komponentët kryesorë në strukturën drejtuese të Bankës. Departamenti i auditimit të brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i auditimit të brendshëm ka funksion të sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për t'i përmbushur objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, duke përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të brendshëm që të vlerësojë nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të rrjedhin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën e cila mundëson një nivel të pranueshëm të uljes së rrezikut. Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës.

Secili plan i auditimit vërtetohet nga Komiteti i auditimit i Bankës dhe më pas miratohet nga Bordi. Plani përditësohet sa herë që është e nevojshme për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja të biznesit.

Puna e Departamentit të auditimit të brendshëm kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në të gjithë botën, si dhe në përputhje me praktikatat e auditimit të Grupit.

5.5 Menaxhimi i rrezikut

TEB Sh.A. u ekspozohet rreziqeve të kredisë, tregut, likuiditetit dhe rrezikut operacional, të cilat identifikohen dhe monitorohen në përputhje me standardet e grupit. TEB Sh.A. mat dhe monitoron rrezikun në mënyrë të kujdesshme dhe konservatore. Menaxhimit të rrezikut është kontrolli I nivelit të dytë dhe ai organizohet brenda rregulloreve përkatëse.

Procesi i menaxhimit të rrezikut përbëhet nga identifikimi, analiza, matja dhe monitorimi i rrezikut përmes politikave dhe procedurave të shëndosha të cilat kuptohen në të gjitha nivelet.

Menaxhimi i Rrezikut I TEB SH.A. punon në bashkëpunim me Menaxhimin Ekzekutiv për të siguruar që niveli i rreziqeve është në përputhje me politikat e grupit dhe në përputhje me apetitin për rrezik.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut mban në mënyrë të pavarur funksionet e përditshme pasi ata raportojnë drejtpërdrejt në Bordin e Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Riskut (KMR).

Rreziku kreditor

Rreziku i kredisë është rreziku më i zakonshëm ndaj të cilit banka është e ekspozuar duke marrë parasysh kushtet e tregut lokal.

Sipas përkufizimit të përgjithshëm, rreziku kreditor është humbja që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e veta siç është përcaktuar në marrëveshjen e kredisë. TEB Sh.A. është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor nëpërmjet kreditimit të saj, financave tregtare dhe aktiviteteve të thesarit, mirëpo rreziku kreditor mund të lindë edhe në rrethana të tjera. Menaxhimi i rrezikut kreditor kryhet përmes analizës së rregullt të aftësisë kreditore të debitorëve ndërsa të gjitha ekspozimet kreditore rishikohen të paktën në bazë vjetore, ndërsa ekspozimet e mëdha monitorohen rregullisht nga departamenti i monitorimit.

Procesi i monitorimit shqyrton rrjedhën e parase së gatshme dhe performancën e shitjes, marrëveshjet e kredisë, sjelljen e pagesave, profitabilitetin, likuiditetin, aftësinë paguese dhe raportin e borxhit.

Bordi i Drejtorëve është autoriteti përfundimtar në shpërndarjen e lehtësirave të kredisë dhe miratimin e politikave kreditore.

Komiteti i lartë i kredive dhe Drejtori Ekzekutiv janë të autorizuar në kushte dhe me kufizime të caktuara. Ushtrimi i këtyre fuqive të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht nga kontrolli i brendshëm, menaxhimi i rrezikut dhe auditimi i brendshëm, si pjesë e vijës së dytë dhe të tretë të mbrojtjes.

Nga ana tjetër, Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut raporton në baza mujore tek Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut për zhvillimin e kredive në nivelin e portfolios, duke përfshirë përmbledhjen e IKR-ve, limitet rregullative dhe të BD, delikuencën e kredive, ekspozimin sipas segmenteve dhe industrisë, trendin e KJP-ve, aktivitetet e arkëtimit etj.

Divizioni i Alokimit dhe Monitorimit të Kredive synon të menaxhojë cilësinë e portfolios së kredisë nga ekipet e ekspertëve në përputhje me rregulloret dhe politikat e kredisë të përcaktuara nga Banka. Ekipet janë përgjegjëse për kryerjen e gjithë ciklit të huadhënies, në aplikimet për kredi, vlerësimin e kredive, monitorimin dhe procedurat ligjore.

Aktivitetet e alokimit dhe monitorimit të kredive kryhen nga Zyra Qendrore në bashkëpunim të ngushtë me linjat e biznesit dhe menaxhmentin. Parimi në katër sy zbatohet. Vendimet e Komiteteve të Kredisë duhet të merren unanimisht. Anëtarët e Alokimit të Kredive janë të specializuar në fushat e tyre përkatëse për të vlerësuar propozimet e kredisë bazuar në autorizimet. Procesi i vendimit të kredisë është i centralizuar dhe nuk ka autorizim në nivel të degës.

Propozimet për kredi biznesi procesohen në bashkëpunim me segmentin përkatës (Korporata, Komerciale, NVM). Për të mbështetur proceset e vlerësimit të kredisë, është zhvilluar modeli i vlerësimit të brendshëm.

Politikat dhe strategjitë e kredive për klientë individual ('retail') përcaktohen në përputhje me metodat e drejtuara në mënyrë analitike dhe racionale. Proceset e vlerësimit të kredive dhe të inteligjencës janë krijuar në një mënyrë shumë të automatizuar për të siguruar menaxhim më të mirë të rrezikut. Në mënyrë që të ruhet cilësia, kryhet menaxhim efikas i portfolios duke përdorur 'scorecard'-a (kartela realizuese) me aftësi të gjera filtrimi.

Strategjia kryesore e kolektimit është kolektimi nga delikuentët sa më shumë që të jetë e mundur dhe marrja e masave parandaluese për të mbajtur nën kontroll KJP-të (kreditë jo-performuese) dhe vonesat në këste. Proceset e kolektimit menaxhohen në mënyrë efektive me burime të ndryshme (firma juridike të brendshme dhe të jashtme) për segmente të ndryshme.

Departamenti i Kolektimit po ashtu koordinon kolektimin e kredive të transferuara në prokurori. Performanca e kolektimit monitorohet dhe raportohet rregullisht në Bord dhe komitetet e ndërlidhura të Bordit.

Testimi i stresit të kredisë është një komponent tjetër i rëndësishëm për të kuptuar ngjarjet ose ndryshimet e mundshme në treg që mund të ndikojnë në bilancin e Bankës duke simuluar skenarë të ndryshëm të paracaktuar në portfolion ekzistuese të bankës.

Banka zbaton parimet SNRF 9 për vlerësimin dhe llogaritjen e humbjeve të pritshme nga kreditë dhe llogaritjen e rënies në vlerë për asetet e saj financiare.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që një bankë mund të pësojë si rezultat i ekspozimit të llogarive të bilancit dhe jashtë të saj ndaj rrezikut të normës së interesit ose rrezikut të kursit të këmbimit, që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare.

Menaxhimi i rrezikut të tregut TEB Sh.A. është krijuar për të menaxhuar dhe kontrolluar ekspozimin ndaj rrezikut të tregut në mënyrë që të optimizohen kthimet duke ruajtur profilin konvencional të rrezikut të Bankës.

Rreziku i normës së interesit

Si pjesë e rrezikut të tregut, rreziku i normës së interesit shkaktohet nga rreziku që një aset do të humbë në vlerë për shkak të ndryshimit në normat e interesit.

Rreziku i normës së interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë bilancit duke siguruar simulime të bazës 100/200 pikë +/- simulime shoku mbi të ardhurat neto bankare në bazë mujore. Norma e brendshme e kthimit (IRR) monitorohet nga afër përmes analizave të hendekut dhe kohëzgjatjes. Efektet e mundshme negative të luhatjeve të normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhjen e parave të gatshme minimizohen me anë të vendimeve të shpejta.

Gjatë përcaktimit të strategjive të çmimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata, Komiteti i Aseteve dhe Detyrimeve TEB SH.A. menaxhon maturitetin e pozicioneve të bilancit dhe miraton parimin e punës me marzhet pozitive të bilancit si politikë e saj e caktimit të çmimit.

Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit përcaktohet si një humbje e mundshme që një bankë mund të pësojë me të gjitha asetet dhe detyrimet e saj të valutës në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Limitet e pozicionit të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore si ndryshime të mundshme në pozicionet monetare të Bankës si rezultat i transaksioneve rutinë të valutave të huaja që mund të ndodhin.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodhë kur nuk ka para të mjaftueshme ose flukse hyrëse parash për të përmbushur kërkesat e financimit neto kur është e nevojshme. Rreziku i likuiditetit po ashtu mund të ndodhë kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen kur është e nevojshme.

Politika e Bankës është që të ketë një strukturë të aseteve që janë mjaft likuide për të përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur është e nevojshme. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton raportet e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë në çdo kohë. TEB Sh.A. ka vendosur një sistem efektiv për raportimin në kohë të pozicionit të likuiditetit në Bordin e Drejtorëve, menaxhmentin e lartë dhe të gjitha departamentet përkatëse. Për më tepër, testet e stresit të likuiditetit janë një mjet tjetër i rëndësishëm për të matur likuiditetin e Bankës në supozime të ndryshme të biznesit.

Mjaftueshmëria e kapitalit

Qëllimi i Bankës është të sigurojë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet e biznesit. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut monitoron dhe raporton raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit tek menaxhmenti ekzekutiv dhe tek Bordi i Drejtorëve përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut.

Rreziku Operacional dhe Vazhdimësia e Biznesit

Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjes, i cili mund të rezultojë nga procese, njerëz dhe sisteme të brendshme joadekuate ose të dështuara ose nga ngjarje të caktuara të jashtme.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Njësia e Rrezikut Operacional është përgjegjëse për monitorimin e ngjarjeve të rrezikut operacional siç përcaktohet nga Komiteti i Bazelit. Banka ka vendosur një sistem të përshtatshëm për natyrën dhe kompleksitetin e biznesit të Bankës në mënyrë që të identifikojë në mënyrë efektive treguesit kryesorë të rrezikut dhe të vlerësojë, monitorojë dhe kontrollojë ngjarjet e rrezikut operacional. Njësia e Rrezikut Operacional zbaton metoda për të ndihmuar departamentet e tjera në identifikimin, monitorimin, kontrollimin dhe zbutjen e incidenteve të mundshme operationale. Njësia e Rrezikut Operacional siguron trajnime të rrezikut operacional për të gjithë stafin, veçanërisht ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve në Njësinë e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit dhe, vlerësimin e të gjitha proceseve në drejtim të rrezikut operacional dhe identifikimin e proceseve të rrezikshme.

Vazhdimësia e Biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja e saj, përbëhet tërësisht nga plane që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike të biznesit të Bankës në rast të ndonjë ndërprerje biznesi që shkaktohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Njësia e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit janë vazhdimisht të angazhuara në përcaktimin, matjen dhe raportimin e rrezikut tek Zyrtari Kryesor i Rrezikut. Rezultatet e aktiviteteve të Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit rishikohen dhe vlerësohen në baza mujore në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut në Nivelin e Bordit dhe në baza tre-mujore në Bordin e Drejtorëve (BD).

Lidhur me pandeminë Covid-19, Njësia e Rrezikut Operacional është përfshirë në ndërlidhjen me Menaxhmentin e Lartë për të marrë masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojë një mjedis të qëndrueshëm për vazhdimin e operationeve bankare pa asnjë ndërprerje.

RCSA (Vetë-vlerësimi i Kontrollit të Rrezikut) zbatohet për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet operationale dhe kontrollet shoqëruese. Ai shton vlerë duke rritur përfshirjen e një njësie operative në dizajnimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kontrollit dhe rrezikut, identifikimin e ekspozimeve të rrezikut dhe përcaktimin e veprimit korrigjues. Qëllimi i RCSA-së është të integrojë praktikën dhe kulturën e menaxhimit të rrezikut në mënyrën se si stafi ndërmerr punët e tyre dhe si njësia e biznesit arrijnë objektivat e tyre.

5.6 Pajtueshmëria

Pandemia Covid-19 ka çuar në sfida të pashembullta globale të cilat ofrojnë një mjedis të favorshëm për rreziqet e sigurisë financiare. Autoritetet në të gjithë botën si Task Forca e Veprimit Financiar, Banka për Pagesat Ndërkombëtare, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet janë përgjigjur me deklarata dhe duke ofruar udhëzime për institucionet financiare për të menaxhuar rreziqet e pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT). Në të gjitha deklaratat e tilla, u theksua se ekziston nevoja për një vigjilencë të veçantë për rreziqet e reja të identifikuara, bashkëpunimin e ngushtë dhe shkëmbimin e informacionit midis aktorëve kryesorë. Në krizën pandemike Covid-19 kërcënime dhe dobësi të reja gjenerojnë rreziqe të shfaqura të PP dhe FT-së.

Sipas Interpolit ka një rritje të kërcënimeve kibernetike të lidhura me domenet qëllimkeqe, malëare dhe ransomëare. Për më tepër, sipas vlerësimit të TFVF-së është një rritje e rrezeqeve të PP dhe FT që vijnë nga krimi i lidhur me Covid-19, i cili mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- a) rritje të keqpërdorimit të shërbimeve financiare online dhe pasurive virtuale për të lëvizur dhe fshehur fonde të paligjshme dhe
- b) potencial për korrupsion në lidhje me fondet qeveritare si dhe ndihmën financiare ndërkombëtare.

Në nivel vendi deklarata të ndryshme nga agjencitë e zbatimit të ligjit kërkojnë t'i kushtojnë vëmendje të veçantë aktiviteteve kriminale kibernetike të drejtuara në shfrytëzimin e dobësive në sisteme dhe mjete të largëta.

Viti 2020 ishte një vit sfidues për shkak të Covid-19, megjithatë banka jonë rriti kornizën e kontrollit të KPP/KFT në përgjigje të kërcënimeve dhe dobësive të reja. Janë marrë disa veprime për të përmbushur këtë qëllim; përmirësimi i cilësisë së analizës së alarmit të PPP-së dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i kornizës kundër ryshfetit dhe korrupsionit. Për më tepër, struktura aktuale e kornizës së menaxhimit të rrezikut të transaksioneve në para të gatshme është forcuar më tej në mënyrë që të zbuten rreziqet në para të gatshme. Viti 2020 ishte një vit sfidues për shkak të Covid-19, megjithatë banka jonë rriti kornizën e kontrollit të KPP/KFT në përgjigje të kërcënimeve dhe dobësive të reja. Janë marrë disa veprime për të përmbushur këtë qëllim; përmirësimi i cilësisë së analizës së alarmit të PPP-së dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i kornizës kundër ryshfetit dhe korrupsionit. Për më tepër, struktura aktuale e kornizës së menaxhimit të rrezikut të transaksioneve në para të gatshme është forcuar më tej në mënyrë që të zbuten rreziqet në para të gatshme.

Kodi i sjelljes i bankës përfshin dispozita etike të biznesit që synojnë menaxhimin e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe sanksioneve të tjera financiare ndërkombëtare si dhe ryshfetit dhe korrupsionit.

Banka jonë zbaton parimet më të mira mbi 'Njih Klientin Tuaj' (NjKT), ricertifikimin, kujdesin e duhur ndaj klientit, kujdesin e duhur të rritur ndaj klientit si dhe parimet e qasjes së bazuar në rrezik. Për më tepër, ne kemi rizbatuar konfigurimin tonë aktual për të qenë në përputhje me Rregulloren e re të BQK-së për KPP/KFT për azhurnimin e të dhënave të klientëve në mënyrë që të zbuten rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Duke marrë parasysh rëndësinë e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sanksionet dhe embargot ndërkombëtare, të gjithë punonjësit e bankës marrin trajnim rregullisht.

Në vitin 2021 objektivat kryesorë janë, por nuk kufizohen në:

- përqendrimi në zbutjen e kërcënimeve dhe dobësive të reja të identifikuara gjatë Covid-19,
- automatizimi dhe përmirësimi i sistemeve të vigjilencës në internet,
- ribalancimi i përgjegjësisë ndërmjet nivelit të parë të mbrojtjes dhe nivelit të dytë të mbrojtjes,
- implementimi i projekteve në mënyrë që të përforcojmë infrastrukturën tonë të TI-së për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit,
- azhurnimi i sistemit të TI-së për harmonizimin me proceset e reja globale të NjKT-së,
- forcimi i kulturës së rrezikut të KPP-së brenda bankës.

Divizioni ynë i Pajtueshmërisë udhëhiqet nga Menaxheri i Lartë dhe është i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera të bankës. Ai/ajo raporton çdo ditë te Drejtori Menaxhues dhe në mënyrë periodike te Bordi i Drejtorëve.



5.7 Kontrolli i brendshëm

Departamenti i kontrollit të brendshëm synon të forcojë, mbështesë dhe ruajë kontrollet e brendshme dhe të përmirësojë kulturën e kontrollit në çdo nivel të TEB Sh.A. Ai merret me koordinimin e domosdoshëm dhe siguron që aktivitetet përkatëse kryhen rregullisht, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje me strategjitë dhe politikat e menaxhmentit të Bankës, si dhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Në TEB, funksionet e Kontrollit të brendshëm dhe Rrezikut operacional janë të strukturuar ndaras. Departamenti i kontrollit të brendshëm pozicionohet si pjesë përbërëse e nivelit të dytë të mbrojtjes dhe ekzekuton detyrat e tij në përputhje me rrethanat.

Kontrollet e aktiviteteve në degë dhe departamentet e zyrës qendrore kryhen nga Njësia e kontrollit të degës, Njësia e kontrollit qendror dhe Njësia e kontrollit të kredive. Shqyrtimet e procesit gjithashtu janë përfshirë në kontrollet e rregullta të Departamentit. Për më tepër, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm kryen edhe shumicën e kontrolleve të grupit BNP Paribas në Bankë, që mbulojnë fusha të ndryshme.

Kontrollet janë dizajnuar për:

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe përputhjen e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore si dhe pajtueshmërinë me to;
- Kontribuimin në ruajtjen e pasurive;
- Vlerësimin e mjaftueshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontribuimin në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me aktivitetet af ariste aktuale dhe të propozuara të ardhme të organizatës, duke përfshirë produktet e reja.

Departamenti i kontrollit të brendshëm i raporton çdo tre muaj drejtpërdrejt Bordit të Drejtoreve nëpërmjet Komitetit të auditimit.

5.8 Ligjorja

Departamenti Ligjor është përgjegjës për të menaxhuar të gjitha rreziqet ligjore të bankës. Departamenti e bën këtë përmes disa mënyrave që përfshijnë përcaktimin e politikës ligjore të bankës për të siguruar qëndrueshmëri, duke ofruar këshilla ligjore, duke menaxhuar hartimin dhe amandamentin e të gjitha kontratave që janë në përdorim nga banka, përmes procesit të vëzhgimit rregullativ, duke përfaqësuar bankën në gjykata dhe institucione të tjera, dhe çdo aktivitet tjetër ku inputi ligjor është i nevojshëm. Departamenti Ligjor gjithashtu është pjesë e grupit LEGAL BNP Paribas qëllimi i të cilit është të sigurojë një shërbim të qëndrueshëm për tërë Grupin.

Viti 2020 ishte një vit sfidues për këtë sektor dhe kjo ndikoi edhe në punën e Departamentit Ligjor. Menaxhimi i pasojave ligjore të shkaktuara nga COVID-19 të sektorit financiar nuk ishte një detyrë e lehtë. Departamenti ynë ishte vazhdimisht i përfshirë në ndërlidhjen me rregullatorët për t'iu mundësuar klientëve të bankës që të mund të kishin më shumë shërbime elektronike, duke siguruar që marrëveshjet të ndryshohen sipas ndryshimeve rregullative, me një staf të reduktuar të departamentit në zyrë dhe të tjerët që punojnë nga shtëpia.

Departamenti gjithashtu ishte i përfshirë në menaxhimin e zbatimit të regjistrimit elektronik të hipotekave që kërkohej nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ekipi i LIGJORES ishte pjesë e një grupi të brendshëm punues në një detyrë komplekse e cila përfshinte shumë aspekte ligjore, për të siguruar që marrëveshjet e huadhënies të jenë të siguruara siç duhet me hipoteka.

Vitin e kaluar departamenti ishte përfshirë në zbatimin e disa kërkesave të Grupit BNPP në lidhje me raportimin dhe menaxhimin e rrezikut ligjor. Departamenti ynë rregulloi raportimin e të gjitha rreziqeve ligjore në një mjet të Grupit BNPP të quajtur SARA, i cili paraqet të gjitha rreziqet e rëndësishme ligjore për çdo entitet të ekipi i rrezikut ligjor të Grupit. Departamenti gjithashtu zbatoi planin e përhershëm të kontrollit ligjor, i cili përfshin kontrollimet në pikat më të rëndësishme të kontrollit të funksionit ligjor të bankës.

Ç'ka më tutje?

Ne vazhdojmë punën tonë në projektin e digjitalizimit, për të modernizuar ndërveprimet që banka ka me klientët e vet. Qëllimi përfundimtar është të zbusim sa më shumë rreziqe ligjore në ofrimin e shërbimeve tona, ndërsa në të njëjtën kohë të ofrojmë komoditetin që ofrojnë mjetet tona ditore teknologjike.

Departamenti gjithashtu do të vazhdojë të zbatojë politikat e Grupit në lidhje me menaxhimin e rrezikut ligjor, dhe gjithashtu të zbatojë ndryshimet legislative që qeveria e Kosovës mund të miratojë në lidhje me sektorin financiar.

6. Raporti i Auditorit

TEB SH.A.

Pasqyrat financiare të përgatitura në
pajtueshmëri me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit
Financiar (SNRF)më dhe për vitin që
përfundon më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

Raporti i auditorit të pavarur	i
--------------------------------------	---

Pasqyrat financiare

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e rrjedhës së parasë	4

Shënimet në pasqyrat financiare:

1. Hyrje	5
2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël	5
3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël	18
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose rishikuara	21
5. Standardet dhe interpretimet jo efektive në periudhën aktuale	22
6. Mjetet monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat.	23
7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat.	24
8. Investimet në letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	25
9. Kredi dhe paradhënie për klientët	27
10. Pasuria e investuar.....	36
11. Pasuritë tjera financiare	37
12. Pasuritë tjera	38
13. Ndërtesat dhe pajisjet.....	38
14. Pasuritë me të drejtë të përdorimit dhe detyrimet e qirasë.....	39
15. Pasuritë e patrupëzuara	40
16. Detyrime ndaj klientëve	40
17. Huamarrjet	41
18. Detyrimet e tjera financiare	41
19. Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat e tjera.....	41
20. Detyrimet tjera	42
21. Kapitali aksionar	42
22. Të ardhurat nga interesi	42
23. Shpenzimet e interesit.....	42
24. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet.....	43
25. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	43
26. Provizionet dhe rëniet tjera në vlerë.....	43
27. Shpenzimet e personelit.....	44
28. Shpenzimet administrative	44
29. Tatimi në të ardhura	45
30. Shpalosjet e palëve të lidhura	48
31. Zotimet dhe kontigjencat.....	49
32. Menaxhimi i kapitalit	51
33. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	53
34. Shpalosjet e vlerës së drejtë.....	65
35. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes	67
36. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit.....	68

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Menaxhmentin e TEB SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **TEB Sh.A.** ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020, dhe shënime të tjera shpjeguese për pasqyrat financiare, duke përfshirë edhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga banka në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës të Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 27 mars 2020.

Informatat e tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat e tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të bankës në përputhje me kërkesat e ligjit numër 04/L-093. Raporti vjetor i bankës pritet të jetë në dispozicionin tonë pas datës së raportit të auditimit. Opinioni jonë mbi pasqyrat financiare nuk i mbulon informatat e tjera dhe ne nuk do të shprehim ndonjë siguri mbi të.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera të identifikuar më lart kur ato të jenë në dispozicion dhe duke bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informatat tjera janë jo konsistente me pasqyrat financiare, ose me njohuritë tona të fituara gjatë auditimit ose nuk janë të deklaruara në mënyrë të drejtë. Kur ne lexojmë raportin vjetor të bankës, nëse vijmë në përfundim se ka gabime materiale, nga ne kërkohet të komunikojmë këtë çështje tek personat e ngarkuar më qeverisje.



Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës që të vazhdojë aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet e lidhura me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë bankën ose të ndërprejë operacionet, ose nuk ka alternative tjetër reale përpos ta veprojë në këtë mënyrë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të bankës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale, nëse ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet të ndikojnë tek përdoruesit në vendimet ekonomike të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreze, dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa ai që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël, dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të dëshmive të auditimit të siguruara, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë së Bankës. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në dëshmitë e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditorit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmën mund të shkaktojnë ndërprerjen e parimit të vijimësisë së Bankës.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisje, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës, nr. 177,
Prishtinë, Republika e Kosovës
Numri unik identifikues: 810468373
10 mars 2021



Partnere e angazhimit:
Arta Limani

TEB SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
PASURITË			
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	6	131,194	111,585
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	7	74,682	65,258
Investimet në letrat me vlerë	8	25,928	14,167
Kredi dhe paradhënie për klientët	9	414,694	397,311
Pasuria e investuar	10	1,649	1,590
Pasuritë tjera financiare	11	3,203	3,242
Pasuritë tjera	12	1,373	818
Ndërtesat dhe pajisjet	13	3,528	3,505
Pasuritë me të drejtë të përdorimit	14	3,388	3,951
Pasuritë e patrupëzuara	15	2,331	2,158
Pasuritë e shtyra tatimore	29	-	212
Parapagimet e tatimit në të ardhura të korporatës		148	-
GJITHSEJ PASURITË		662,118	603,797
DETYRIMET			
Detyrime ndaj klientëve	16	561,400	512,263
Detyrimet tjera	20	448	443
Detyrimet e qirasë	14	3,471	4,065
Huamarrjet	17	5,145	8,981
Detyrimet tjera financiare	18	4,509	4,268
Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat tjera	19	1,531	1,004
Detyrimet e tatimit në të ardhura të korporatës	29	44	582
GJITHSEJ DETYRIMET		576,548	531,606
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali aksionar	21	24,000	24,000
Fitimet e mbajtura		61,156	47,779
Rezervat e tjera		414	412
GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR		85,570	72,191
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI AKSIONAR		662,118	603,797

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Menaxhmenti Ekzekutiv i Bankës më 10 mars 2021 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


 Z. Orçun Ozdemir
 Drejtor Menaxhues


 Z. Rezak Fetai
 Zyrtar Kryesor Financiar

TEB SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)*

	Shënime	2020	2019
Të ardhurat nga interesi	22	29,097	30,650
Shpenzimet e interesit	23	(1,346)	(1,647)
Të ardhurat neto nga interesi		27,751	29,003
Neto rënia në vlerë (humbja)/ lirimi i rënies në vlerë për kreditë dhe paradhëniet për klientët	9	(948)	3,744
Të ardhurat neto nga interesi dhe të ardhura të ngjashme pas lejimit për humbjet e pritshme nga kreditë		26,803	32,747
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	24	11,160	11,138
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet	25	(4,358)	(4,277)
Fitimet minus humbjet nga derivativët financiarë		-	(27)
Fitimet minus humbjet nga rivlerësimi i valutave të huaja		228	178
Fitimet minus humbjet nga rivlerësimi pasurisë së investuar		59	-
Neto (rëniet në vlerë)/lirimi i rënies në vlerë për zotimet kreditore		26	(121)
Të ardhurat tjera operative		515	422
Shpenzimet tjera operative		(1,301)	(1,159)
Provizionet dhe rëniet tjera në vlerë	26	(520)	(2,151)
Shpenzimet e personelit	27	(7,719)	(8,511)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14,15	(4,734)	(4,468)
Shpenzimet administrative	28	(5,531)	(6,010)
FITIMI PARA TATIMIT		14,628	17,761
Shpenzimet e tatimit në të ardhurat	29	(1,251)	(2,288)
FITIMI I VITIT		13,377	15,473
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që mund të riklasifikohen më vonë në fitim ose humbje:</i>			
Letrat me vlerë të borxhit në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:			
Fitimet minus humbjet që krijohen gjatë vitit, neto nga tatimet	29	2	55
<i>Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje:</i>			
Rivlerësimi i pasurisë së investuar	10,29	-	351
Gjithsej të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse/(humbjet) të vitit		2	406
GJITHSEJ TË ARDHURAT			
GJITHËPËRFSHIRËSE TË VITIT		13,379	15,879

Shënimet në faqet 5 deri në 68 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	24,000	62,306	6	86,312
Fitimi i vitit	-	15,473	-	15,473
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	406	406
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	15,473	406	15,879
Pagesa e dividendës	-	(30,000)	-	(30,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	24,000	47,779	412	72,191
Gjendja më 1 janar 2020	24,000	47,779	412	72,191
Fitimi i vitit	-	13,377	-	13,377
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-	2	2
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	13,377	2	13,379
Pagesa e dividendës	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	24,000	61,156	414	85,570

Shënimet në faqet 5 deri në 68 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	2020	2019
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		14,628	17,761
<i>Rregullimet për:</i>			
Zhvlerësimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve	13	1,776	1,528
Zhvlerësimi i pasurive me të drejtë të përdorimit	14	1,238	1,242
Amortizimi i pasurive të patrupëzuara	15	1,720	1,698
Fitimet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve		2	15
Fitimi nga shitja e pasurive të riposeduara		(228)	(207)
Fitimi nga vlera e drejtë e pasurisë së investuar		(59)	-
Fitimet në investimet në letrat me vlerë të borxhit		(8)	(1)
Fitimet nga instrumentet financiare derivative		-	27
Humbjet e pritura kreditore	9	2,530	(1,982)
Humbjet e pritura kreditore të pasurive tjera financiare	26	145	39
Provizionet tjera	26	375	2,112
Rënia në vlerë/(lirimi) i rënies në vlerë për zotimet kreditore		(26)	121
Të ardhurat nga interesi	22	(29,097)	(30,650)
Shpenzimet e interesit	23	1,346	1,647
		(5,658)	(6,650)
<i>Rritja (zvogëlimi) neto në:</i>			
Gjendjet me Bankën Qëndrore të Kosovës		(5,703)	(6,515)
Kredi dhe paradhënie për klientët		(19,684)	(12,047)
Pasuritë tjera financiare		39	(143)
Pasuritë tjera		(632)	(699)
<i>Rritja/(zvogëlimi) neto në:</i>			
Detyrime ndaj klientëve		49,158	56,897
Detyrimet e tjera financiare		241	754
Provizionet për detyrimet dhe shpenzimet tjera		527	94
Detyrimet e tjera		5	54
		23,951	38,395
Interesi i arkëtuar		28,762	30,620
Interesi i paguar		(1,374)	(1,729)
Tatimi i paguar në të ardhurat e korporatave		(1,726)	(1,310)
Flukset neto montare nga aktivitetet operative		43,955	59,326
Flukset monetare nga aktivitetet e investimit			
Blerja e letrave me vlerë të borxhit në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		(23,070)	(10,262)
Arkëtimet nga shitja/maturimi i investimeve në letrat me vlerë të borxhit		11,348	12,416
Arkëtim nga shitja e objekteve dhe pajisjeve		11	1
Arkëtim i fitimit nga shitja e pasurive të riposeduara		211	222
Arkëtim i fitimit nga shitja e letrave me vlerë		8	-
Blerja e objekteve dhe pajisjeve	13	(1,817)	(834)
Blerja e pasurive të patrupëzuara	15	(1,897)	(1,765)
Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetet e investimit		(15,206)	(222)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Pagesa e dividendës		-	(30,000)
Të ardhurat nga huamarrjet afatgjata		-	2,000
Kthimi i huamarrjeve		(3,857)	(2,285)
Pagesa e kryegjësë së detyrimeve të qirasë		(1,420)	(1,170)
Flukset neto monetare të përdorura në aktivitete financuese		(5,277)	(31,455)
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të parasë		23,472	27,649
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		133,141	105,492
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	6	156,613	133,141

Shënimet në faqet 5 deri në 68 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Hyrje

Teb Sh.A. ("Banka") është themeluar në Republikën e Kosovës më 19 dhjetor 2007, kur edhe iu dha licenca për veprimtari bankare nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). Banka filloi veprimtarinë në janar 2008.

Banka kontrollohet nga TEB Holding AS, që është shoqëri e themeluar në Turqi ("Kompania amë"), e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. Aksionarët e TEB Holding AS janë BNP Paribas dhe Grupi Çolakoğlu, ku secili prej tyre ka në pronësi 50% të aksioneve. BNP Paribas është pala e fundit kontrolluese e kompanisë amë dhe e Bankës.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit: Zyra qendrore e regjistruar e Bankës gjendet në Preoc p.n. KM7, magjistratja Prishtinë-Ferizaj, Graçanicë 10500, Republika e Kosovës.

Aktiviteti kryesor: Banka vepron si bankë me të drejta të plota, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe ofron shërbime për të gjitha kategoritë e klientëve në Republikën e Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 29 degësh (2019: 29) që gjenden në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Më 31 dhjetor 2020, Bordi i Drejtorëve të Bankës përbëhet nga:

- Jacques Roger Jean Marie Rinino (Kryetar);
- Alp Yılmaz (Zëvendës kryetar);
- Ayşe Aşardağ (Zëvendës kryetare);
- Birol Deper (Anëtar);
- Esra Peri Aydoğan (Anëtare);
- Osman Durmuş (Anëtar);
- Nilsen Altıntaş (Anëtare);
- Luc Delvaux (Anëtar);
- Ayse Meral Cimenbicer (Anëtare);
- Orçun Özdemir (Anëtar dhe Drejtor Menaxhues)

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), sipas parimit të kostos historike, të modifikuara me njohjen fillestare të instrumenteve financiare në bazë të vlerës së drejtë, me rivlerësimin e pasurisë së investuar dhe instrumenteve financiare të kategorizuara me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes ("VDPFH") dhe me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"). Politikat kryesore kontabël të zbatuara gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Valuta funksionale dhe e prezantimit. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, e cila është valuta funksionale e Bankës. Valuta funksionale është valuta primare e mjedisit ekonomik në të cilin Banka e ushtron veprimtarinë e saj, që është Republika e Kosovës.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**Shkurtesa**

Lista e shkurtesave të përdorura në këto pasqyra financiare është si më poshtë:

Shkurtesa	Emri i plotë
BQK	Banka Qëndrore e Kosovës
KA	Kostoja e amortizuar
ENM	Ekspozimi në mospagesë
HPK	Humbjet e pritura kreditore
HPKJ	Humbjet e pritura kreditore përgjatë jetëgjatësisë së pasurisë
NEI	Norma efektive e interesit
VDPATGJ	Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirë
VDPFTH	Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes
FX	Këmbimi valutor
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
HRM	Humbja në rast të mospagesës
PM	Probabiliteti i mospagimit
Pasuritë POCI	Pasuritë financiare që kanë rënie në vlerë që në blerje ose në krijim
Pasuritë ROU	Pasuritë me të drejtë përdorimi
RRKRrK	Rritje e konsiderueshme në rrezikun kreditor
VPKI	Vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit
Testi VPKI	Vlerësim nëse flukset e parave të instrumenteve financiare paraqesin vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit

Instrumentet financiare – Kushtet kryesore të matjes

Varësisht nga klasifikimi i tyre, instrumentet financiare mbahen me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, siç përshkruhet më poshtë.

Matja e vlerës së drejtë Vlera e drejtë është çmimi me të cilin mund të shitet një pasuri ose të paguhet për të transferuar një detyrim përmes një transaksioni të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve në tregun kryesor në datën e matjes, ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Treg aktiv është ai ku transaksionet për pasurinë apo detyrimin ndodhin me shpeshtësi dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion në lidhje me çmimet në mënyrë të vazhdueshme.

Kur mundet, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg cilësohet aktiv nëse transaksionet për pasurinë apo detyrimin ndodhin me shpeshtësi dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion në lidhje me çmimet në mënyrë të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e faktorëve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e faktorëve jo të vëzhgueshëm. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë përcaktimit të çmimit të një transaksioni.

Teknikat e vlerësimit, siç janë modelet e skontimit të flukseve monetare ose modelet e bazuara në transaksionet e kohëve të fundit sipas kushteve të tregut ose në marrjen në konsideratë të të dhënave financiare të palëve ku është investuar, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të caktuara për të cilët informacioni për çmimet e tregut të jashtëm nuk është në dispozicion. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit ku të gjitha të dhënat materiale për pasurinë ose detyrimin janë të vëzhgueshme ose drejtpërdrejtë (si p.sh. çmimet) ose tërthorazi (që buron nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk janë të bazuara vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (do të thotë matja kërkon burime të konsiderueshme që nuk mund të vëzhgohen). Transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë vlerësohet se kanë ndodhur në fund të periudhës së raportimit.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Kostot e transaksionit janë kosto progresive të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, emetimin ose heqjen nga përdorimi të një instrumenti financiar. Një kosto progresive është ajo kosto e cila nuk do të kishte ndodhur nëse as transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (duke përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarëve, ndërmjetësve dhe tregtarëve, taksat nga agjencitë rregullative dhe bursat e letrave me vlerë si dhe taksat dhe detyrimet e transferimit. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar është vlera me të cilën instrumenti financiar njihet fillimisht, minus pagesat e kryegjësë, plus interesi i përlllogaritur, dhe për pasuritë financiare, minus humbjet e pritura kreditore. Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e koston së shtyrë të transaksionit në njohjen fillestare dhe çdo prim ose zbritje në shumën e maturimit, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e interesit të përlllogaritur dhe shpenzimet e interesit të përlllogaritur, duke përfshirë edhe kuponin e përlllogaritur edhe zbritjen ose primin e amortizuar (duke përfshirë tarifat e shtyra fillestare, nëse ka) nuk paraqiten të ndara dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit). Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbret pagesat e ardhshme të parave ose pranimit përgjatë jetëgjatësisë së pritur të instrumentit financiar.

- Për pasuritë financiare përveç pasurive financiare që kanë rënie në vlerë në blerje ose në krijim (d.m.th. pasuritë që janë me rënie në vlerë kreditore në njohjen fillestare), norma efektive e interesit është norma që i skanton pranimit e ardhshme të parasë së gatshme duke përjashtuar humbjet e pritura kreditore, përgjatë jetës së pritshme të instrumentit të borxhit, ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër, ndaj vlerës bartëse bruto të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare.
- Për pasuritë financiare për të cilat një humbje kreditore ka ndodhur (pasuri me humbje kreditore në fazën 3), norma efektive aplikohet në koston e amortizuar të instrumentit dhe jo në vlerën bartëse bruto.
- Për detyrimet financiare norma efektive e interesit është norma që zbret pagesat e parashikuara të parave deri në koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit dhe tarifat apo pagesat e paguara ose të pranura që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të pasurisë ose detyrimit financiar.

Norma efektive e interesit zbret flukset e pagesave të ardhshme të parave të instrumenteve me normë të ndryshueshme të interesit deri në datën tjetër të rishikimit të çmimit, me përjashtim të primit ose zbritjes që pasqyron shpërndarjen e kredisë në normën e ndryshueshme të interesit të specifikuar në instrument, ose variabla të tjera që nuk rishikohen për çmim me normat e tregut. Primet ose zbritjet e tilla amortizohen përgjatë jetëgjatësisë së pritur të instrumentit.

Instrumentet financiare - njohja fillestare.

Instrumentet financiare me VDPFH fillimisht regjistrohen në vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka e regjistron atë instrument në atë datë si më poshtë:

- Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka diferencë ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të dëshmohet nga transaksionet e tjera të vëzhgueshme aktuale të tregut për të njëjtin instrument ose përmes një teknike vlerësimi, inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhënat nga tregjet e vëzhgueshme.
- Në të gjitha rastet e tjera, matja e vlerës së drejtë rregullohet për të shtyrë diferencën. Pas njohjes fillestare, Banka e njeh atë diferencë të shtyrë si fitim ose humbje vetëm për aq sa rezultojnë nga ndryshimi në ndonjë faktor (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimeve të pasurive ose detyrimeve.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Pas njohjes fillestare, një lejim për HPK-në njihet për një pasuri financiar të matur me KA dhe investimet në instrumente të borxhit të matura me VDPATGJ, duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e pasurive financiare që kërkojnë dorëzim brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë të tregut (blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka zotohet për ta dhënë një pasuri financiare. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes.

Banka i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDPFH, VDPATGj dhe KA. Klasifikimi dhe matja mëpasshme e e pasurive financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i Bankës për menaxhimin e portofolit të pasurive përkatëse dhe (ii) karakteristikat e rrjedhës së parave të pasurisë.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - modeli i biznesit.

Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Banka i menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojnë rrjedha të parave - nëse objektivi i Bankës është: (i) vetëm për të mbledhur rrjedhat e kontraktuara të parave nga pasuritë ("të mbajtura për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave") ose (ii) për të mbledhur edhe rrjedha kontraktuale të parave edhe rrjedhat e parave që vijnë nga shitja e pasurive ("të mbajtura për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave dhe për shitje") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk zbatohet, pasuritë financiare klasifikohen si pjesë e modelit "tjetër" të biznesit dhe maten në VDPFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për një grup të pasurive (në nivel të portfolios) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse në lidhje me aktivitetet që Banka i merr përsipër ta arrijë objektivin e përcaktuar për portfolion në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që i merr në konsiderim Banka në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë qëllimin dhe përbërjen e portfolios, përvojën e kaluar për mënyrën se si janë arkëtuar rrjedhat e parave për pasuritë përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e pasurive dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që i ka zbatuar Banka në përcaktimin e modeleve të biznesit për pasuritë e saj financiare.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - karakteristikat e rrjedhës së parasë.

Kur modeli i biznesit kërkon që pasuritë të mbahen për të mbledhur rrjedhat e kontraktuara të parave ose për të mbledhur këto rrjedha si edhe për shitje, Banka vlerëson nëse rrjedhat e parave përfaqësojnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit ("VPKI"). Pasuritë financiare me derivativë të përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse rrjedhat e tyre të parasë janë në përputhje me tiparin e VPKI. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Banka shqyrton nëse rrjedhat kontraktuale të parave janë në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, përkatësisht nëse interesi përfshin vetëm shpërblim për rrezikun kreditor, vlerën kohore të parasë, rreziqet e tjera bazike të kredidhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose luhatshmëri që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, pasuria financiare klasifikohet dhe matet me VDPFH. Vlerësimi i VPKI kryhet në njohjen fillestare të një pasurie dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që i ka zbatuar Banka në kryerjen e testit VPKI për pasuritë e saj financiare.

Pasuritë financiare - riklasifikimi.

Pasuritë financiare riklasifikohen vetëm kur ndryshon modeli i biznesit për menaxhimin e portfolios në tërësi. Riklasifikimi ka efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Banka nuk e ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Rënia në vlerë e pasurive financiare – rezerva për humbjet e pritura kreditore.

Banka i vlerëson HPK për instrumentet e borxhit të matura me KA dhe VDPATGJ dhe për ekspozimet që rrjedhin nga zotimet kreditore dhe kontratat e garancive financiare. Banka i mat HPK dhe i njeh rezervat për humbjet kreditore në çdo datë raportimi. Matja e HPK pasqyron: (i) një shumë të paanshme dhe të ponderuar në bazë të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionet e arsyeshme dhe që mund të mbështeten me dëshmi që janë në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Instrumentet e borxhit të matur në KA janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar neto nga rezerva e HPK. Për zotimet kreditore dhe garancitë financiare, një provizion i veçantë për HPK njihet si detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar. Për instrumentet e borxhit sipas VDPATGJ, ndryshimet në koston e amortizuar, neto nga rezerva për HPK, njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në ATGJ si fitime minus humbjet në instrumentet e borxhit me VDPATGJ.

Banka përdor një model prej tre fazash për rënien në vlerë, bazuar në ndryshimet në cilësinë kreditore që nga njohja fillestare. Një pasuri financiare që nuk ka rënie në vlerë në njohjen fillestare klasifikohet në Fazën 1. Pasuritë financiare në Fazën 1 e kanë HPK të matur në shumë të barabartë me pjesën e HPK së jetëgjatësisë së tyre që rezulton nga ndodhjet e mospagesës së mundshme brenda 12 muajve të ardhshëm ose deri në maturimin e kontratës, nëse kjo e fundit është periudhë më e shkurtër ("HPK 12 mujore"). Nëse Banka identifikon një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor ("RRKRrK") që nga njohja fillestare, pasuria transferohet në Fazën 2 dhe HPK e saj matet bazuar në HPK përgjatë jetëgjatësisë, do të thotë deri në maturimin kontraktual por duke marrë parasysh parapagimet e pritura, nëse ka ("HPK e tërë jetëgjatësisë").

Referojuni paragrafit të *Rritjes së konsiderueshme në rrezikun kreditor "RRKRrK"* për shpjegimin se si Banka e përcakton kur ka ndodhur një RRKRrK. Nëse Banka përcakton që një pasuri financiare i ka rënë vlera, pasuria transferohet në Fazën 3 dhe HPK e saj matet si HPK e tërë jetëgjatësisë. Përkufizimi i Bankës për pasuritë që ju ka rënë vlera dhe përkufizimi i dështimit për të paguar shpjegohen në paragrafin e *Rënies në vlerë e pasurive financiare*. Për pasuritë financiare që kanë rënie në vlerë që në blerje ose në krijim ("pasuritë POCl"), HPK matet gjithmonë si HPK e tërë jetëgjatësisë së pasurisë. Përfshimisht, për instrumente të caktuara financiare, të tilla si kartelat e kreditit, që mund të përfshijnë edhe kredi edhe një komponent të zotimit të pashfrytëzuar, Banka i mat humbjet e pritura kreditore gjatë periudhës kur Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, përkatësisht deri kur humbjet kreditore të pritura do të ulen për shkak të veprimeve të menaxhimit të rrezikut kreditor, edhe nëse kjo periudhë zgjat përtej periudhës maksimale kontraktuale. Kjo për shkak se aftësia kontraktuale për ta kërkuar pagimin dhe anulimin e zotimit të pashfrytëzuar nuk e kufizon ekspozimin ndaj humbjeve kreditore për atë periudhë kontraktuale.

Pasuritë financiare - shlyerja

Pasuritë financiare shlyhen tërësisht ose pjesërisht sipas mosaftësisë së pagesës dhe mbulesës së kolateralit, siç rregullohet me rregulloret vendore. Nga ana tjetër, nëse Banka i ka harxhuar të gjitha përpjekjet për të arkëtuar borxhin dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shpresa të arsyeshme për të arkëtuar borxhin, ajo mund të vendosë ta shlyejë një pasuri para datës së caktuar sipas kërkesave të rregulloreve vendore.

Pasuritë financiare – ç'regjistrimi.

Banka i ç'regjistron pasuritë financiare kur (a) pasuritë janë rikthyer ose të drejtat për rrjedhat e parave nga pasuritë kanë skaduar ose (b) Banka i ka transferuar të drejtat e rrjedhave të parave nga pasuritë financiare ose ka hyrë në një marrëveshje kalimtare përderisa (i) gjithashtu i ka transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurive ose (ii) as nuk i transferon as nuk i mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk mban kontroll. Kontrolli mbahet në qoftë se pala tjetër nuk e ka aftësinë praktike për ta shitur pasurinë në tërësi tek një palë e tretë pa pasur nevojë të vendosë kufizime për shitjen.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**Pasuritë financiare - modifikimi.**

Banka ndonjëherë ri-negocion ose i modifikon kushtet kontraktuale të pasurive financiare. Banka vlerëson nëse modifikimi i rrjedhve të parave kontraktuale është i konsiderueshëm duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: ndonjë kusht të ri kontraktual që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në profilin e rrezikut të pasurisë, ndryshim të konsiderueshëm të normës së interesit, kolateral i ri ose përmirësim kreditor që ndikon ndjeshëm në rrezikun kreditor që lidhet me pasurinë ose zgjatjen e konsiderueshme të një kredie kur huamarrësi nuk është në vështirësi financiare. Nëse kushtet e modifikuara janë në thelb të ndryshme, të drejtat për rrjedhat e parave nga pasuria fillestare skadojnë dhe Banka e ç'regjistron pasurinë financiare fillestare dhe e njeh një pasuri të re me vlerën e vet të drejtë. Data e rinegociimit konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllimet e llogaritjes së rënies në vlerë pasuese, duke përfshirë përcaktimin nëse ka ndodhur një RRKRrK. Banka gjithashtu vlerëson nëse kredia e re ose instrumenti i borxhit e plotëson kriterin e VPKI. Çdo ndryshim ndërmjet vlerës kontabël të pasurisë fillestare të ç'regjistruar dhe vlerës së drejtë të pasurisë së re të modifikuar thelbësisht, njihet në fitim ose humbje, përveç nëse substanca e diferencës i atribuohet një transaksioni të kapitalit me pronarët.

Në një situatë kur rinegociimi është shkaktuar nga vështirësitë financiare të palës tjetër dhe pamundësia për t'i bërë pagesat e dakorduara fillimisht, Banka vlerëson nëse modifikimi i kushtëve është thelbësor apo jo. Nëse rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë, pasuria e modifikuar nuk është thelbësisht ndryshe nga pasuria fillestare dhe modifikimi nuk ka si rezultat ç'regjistrimin. Banka rillogarit vlerën kontabël bruto duke zbritur rrjedhat e parave kontraktuale të modifikuara për normën fillestare efektive të interesit (ose normën efektive të interesit të korrigjuar për pasuritë financiare POCI) dhe njeh një modifikim për fitimin ose humbjen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Detyrimet financiare - kategoritë e matjes.

Detyrimet financiare pas njohjes fillestare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar përveç (i) detyrimeve financiare me VDPFH: ky klasifikim zbatohet për instrumentet derivative, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), vlerat kontingjente të njohura nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancive financiare dhe zotimeve kreditore.

Detyrimet financiare – ç'regjistrimi.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur ato shuhet (kur detyrimi i specifikuar në kontratë përfundon, anulohet ose skadon). Një shkëmbim i instrumenteve të borxhit, ndërmjet Bankës dhe huadhënësve të saj, me kushte thelbësisht të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të afateve dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, trajtohet si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e rrjedhve të parave sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe e skontuar duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e rrjedhve të parave të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i kushteve llogaritet si shuarje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje.

Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shuarje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar rregullon vlerën kontabël të detyrimit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative të ndryshimeve, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në vlerat bartëse i atribuohet një transaksioni kapitali me pronarët.

Paraja dhe ekuivalentët e saj.

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë pasuri që janë lehtësisht të konvertueshme në shuma të njohura të parave dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të papërfillshëm të ndryshimeve në vlerë. Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë të gjitha paratë e gatshme, plasmanet ndërbankare dhe depozitat e detyrueshme të rezervave me BQK-në, me maturime origjinale më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë origjinale të maturimit më të gjatë se tre muaj janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e saj.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Paraja dhe ekuivalentët e saj barten me kosto të amortizuar sepse: (i) ato mbahen për grumbullimin e rrjedhave të parave kontraktuale dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe (ii) nuk janë përcaktuar të mbahen me VDPFH. Karakteristikat e kërkuara vetëm nga legjislacioni, siç është legjislacioni për shpëtimin e institucioneve financiare në shtete të caktuara, nuk kanë ndikim në testin e VPKI, përveç nëse ato janë të përfshira në kushtet kontraktuale në mënyrë që karakteristikat të zbatohen edhe nëse legjislacioni më vonë ndryshohet.

Pagesat ose pranimet e paraqitura në pasqyrën e rrjedhës së parasë përfaqësojnë transferet e parave dhe ekuivalentëve të saj nga Banka, duke përfshirë shumat e ngarkuara ose të kredituara në llogaritë rrjedhëse të palëve të Bankës që mbahen në Bankë, të tilla si të ardhurat nga interesi i kredisë ose kryegjësja e arkëtuar duke e ngarkuar llogarinë rrjedhëse të klientit, ose pagesat e interesit ose disbursimi i kredive të kredituara në llogarinë rrjedhëse të klientit, që përfaqësojnë paratë ose ekuivalentët e parasë së gatshme nga perspektiva e klientit.

Gjendjet e detyrueshme të parave në BQK.

Gjendjet e detyrueshme të parasë së gatshme në BQK barten me kosto të amortizuar dhe përfaqësojnë depozita rezervë të detyrueshme të cilat nuk gjenerojnë interes dhe të cilat nuk janë në dispozicion për t'i financuar operacionet e përditshme të Bankës dhe kështu nuk konsiderohen si pjesë e parave dhe ekuivalentëve të saj për qëllimet e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Detyrimet nga bankat e tjera (kredi dhe paradhënie për bankat).

Shumat e detyrimeve nga bankat e tjera regjistrohen kur Banka jep paradhënie për bankat tjera, pa pasur qëllim për ta tregtuar të arkëtueshmen përkatëse të pakutuuar jo-derivative, që arkëtohet në data fikse ose të përcaktueshme të maturimit. Shumat e detyrimeve nga bankat e tjera barten me KA kur: (i) ato mbahen për qëllim të mbledhjes së rrjedhave të parave kontraktuale dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe (ii) nuk janë përcaktuar të mbahen me VDPFH.

Investimet në letrat me vlerë të borxhit.

Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë, Banka i klasifikon investimet në letrat me vlerë të borxhit si të bartura me KA, VDATGJ ose VDPFH. Letrat me vlerë të borxhit barten me KA nëse ato mbahen për mbledhjen e rrjedhës së parave kontraktuale dhe kur ato rrjedha parash përfaqësojnë VPKI, dhe nëse nuk janë përcaktuar vullnetarisht të mbahen me VDPFH në mënyrë që të zvogëlohet ndjeshëm mospërputhja kontabël.

Letrat me vlerë të borxhit barten me VDATGJ nëse ato mbahen për mbledhjen e rrjedhave të parave kontraktuale dhe për shitje, ku ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe kur nuk janë përcaktuar të maten me VDPFH. Të ardhurat e interesit nga këto pasuri llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitim ose humbje.

Një rezervë për rënien në vlerë e matur duke përdorur modelin e humbjeve të pritura kreditore njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin. Të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën bartëse njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ). Kur investimet në letra me vlerë ç' regjistrohen, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGJ riklasifikohet nga ATGJ në fitim ose humbje.

Investimet në letrat me vlerë të borxhit barten me VDPFH nëse ato nuk i plotësojnë kriteret për t'u mbajtur me KA ose me VDATGJ. Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme që investimet në letrat me vlerë të borxhit të mbahen me VDPFH në njohjen fillestare nëse zbatimi i këtij opsioni e zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël ndërmjet pasurive dhe detyrimeve financiare që njihen ose maten në baza të ndryshme të kontabilitetit.

Kreditë dhe paradhëniet për klientë.

Kreditë dhe paradhëniet për klientët regjistrohen kur Banka jep para për të blerë ose për të krijuar një kredi që i takon klientit. Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e rrjedhave të parave, Banka klasifikon kreditë dhe paradhëniet për klientët në njërin nga kategoritë e mëposhtme të matjes: (i) KA: Kreditë që mbahen për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parave dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe kreditë që nuk janë përcaktuar vullnetarisht të maten me VDPFH dhe (ii) VDPFH: kreditë që nuk e përmbushin testin VPKI ose kriteret e tjera për KA ose VDATGJ atëherë maten në VDPFH.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)**Kolaterali i riposeduar**

Kolaterali i riposeduar përfaqëson pasuritë jofinanciare të përfituara nga Banka si pagesë e kredive të paguara. Pasuritë fillimisht njihen në vlerën e drejtë kur të blihen dhe përfshihen në objekte dhe pajisje, pasuri të tjera financiare, pasuri të investuar ose stoqe brenda pasurive të tjera varësisht nga natyra e tyre dhe qëllimi i Bankës për sa i përket rikuperimit të këtyre pasurive, dhe më pastaj ri-maten dhe regjistrohen në pajtueshmëri me politikat kontabël për ato kategori të pasurive. Aktualisht, të gjitha kolaterale të riposeduara përfshihen në stoqe brenda pasurive të tjera. Më pas, Banka mat kolateralin e riposeduar në vlerën më të ulët ndërmjet kostos (shuma e njohur fillimisht) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Kolaterali i riposeduar shlyhet në rast se nuk rishitet nga Banka brenda 5 viteve nga riposedimi. Pasuria e luajtshme nuk njihet si pasuri kur riposedohet. Humbjet që rrjedhin nga ri-matja e mësipërme regjistrohen në fitim ose humbje dhe mund të kthehen prapa në të ardhmen. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

Garancionet financiare.

Garancionet financiare kërkojnë që Banka të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që lind sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet origjinale ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Garancionet financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancionet maten në shumën më të lartë ndërmjet (i) shumës së rënies në vlerë për humbjen kreditore për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e humbjeve të pritshme dhe (ii) bilanci i mbetur i paamortizuar i shumës në njohjen fillestare. Përveç kësaj, rezerva për HPK njihet për tarifat e arkëtueshme që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si pasuri.

Zotimet kreditore.

Banka lëshon garanci financiare dhe zotime për të dhënë kredi. Këto zotime fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, gjë që normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së zotimit, me përjashtim të zotimeve për të lëshuar kredi, nëse është e mundshme që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike kreditimi dhe nuk pret të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas lëshimit; tarifat për zotimet e tilla shtyhen dhe përfshihen në vlerën kontabël të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhë raportuese, zotimet maten në (i) bilancin e mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare, plus (ii) shumën e rënies në vlerë të kredive të përcaktuara në bazë të modelit të humbjeve të pritshme kreditore, përveç nëse zotimi është për të siguruar një kredi me një normë interesi më të ulët se norma e tregut, me ç'rast matja bëhet në shumën më të lartë mes këtyre dy shumave. Vlera kontabël e zotimeve kreditore përfaqëson një detyrim. Për kontratat që përfshijnë edhe kredi edhe një zotim të pashfrytëzuar dhe kur Banka nuk mund ta dallojë ndaras HPK në komponentin e pjesës së pashfrytëzuar nga komponenti i kredisë, HPK për zotimin e pashfrytëzuar njihet së bashku me rezervën për humbje kreditore. Për atë sa HPK-të e kombinuara e tejkalojnë vlerën kontabël bruto të kredisë, ato njihen si detyrim.

Pasuria e investuar

Pasuria e investuar është pronë e mbajtur nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rritjen në vlerë të kapitalit, ose të dyja dhe, e cila nuk është në përdorim nga Banka. Pasuria e investuar përfshin pasuritë në ndërtim e sipër për përdorim në të ardhmen si pasuri e investuar.

Pasuria e investuar fillimisht njihet me kosto, përfshirë edhe kostot e transaksionit, dhe më pas ri-matet me vlerën e drejtë të përditësuar për të pasqyruar kushtet e tregut në fund të periudhës së raportimit.

Vlera e drejtë e pasurisë së investuar është çmimi që do të merrej nga shitja e pasurisë në një transaksion të rregullt, pa zbritur asnjë kosto të transaksionit.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë jepet nga çmimet aktuale në një treg aktiv për prona të ngjashme në të njëjtin lokacion dhe në të njëjtën gjendje. Çdo rritje që rezulton në vlerën kontabël të pronës njihet në fitim ose humbje, përveç nëse ka të bëjë me transfer nga prona e zotëruar nga pronari në pasuri të investuar, në të cilin rast rritja njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Çdo ulje që rezulton në vlerën kontabël të pronës fillimisht ngarkohet ndaj çdo teprice rivlerësimi të njohur më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, nëse ka, pas kësaj çdo ulje e mbetur ngarkohet në fitimin ose humbjen për vitin. Në mungesë të çmimeve aktuale në një treg aktiv, Banka merr parasysh informatat nga burime të ndryshme, duke përfshirë:

- (a) çmimet aktuale në një treg aktiv për prona të natyrave apo kushteve të ndryshme apo lokacion tjetër, të rregulluara për të pasqyruar ato ndryshime; dhe
- (b) çmimet e fundit të pronave të ngjashme në tregjet më pak aktive, me rregullime për të reflektuar çdo ndryshim në kushtet ekonomike që nga data e transaksioneve që kanë ndodhur me ato çmime.
- (c) parashikimet e rrjedhës së parave të zbritura bazuar në vlerësime të besueshme të flukseve të ardhshme të parave përmes dëshmive të jashtme, siç janë normat aktuale të tregut për prona të ngjashme në të njëjtin lokacion dhe njejtat kushte, dhe duke përdorur normat e zbritjes që pasqyrojnë vlerësimet aktuale të pasigurisë së tregut lidhur me sasinë dhe kohën e rrjedhës së parave.

Vlera e drejtë e pasurisë së investuar të Bankës përcaktohet në bazë të raportit të vlerësuesve të pavarur, të cilët kanë kualifikim përkatës profesional të njohur dhe që kanë përvojën më të fundit në vlerësimin e pasurive me lokacion dhe kategori të ngjashme.

Objektet dhe pajisjet

Pronat dhe pajisjet paraqiten në kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe rënia në vlerë e akumuluar, nëse kërkohet. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së zërave të pronës dhe pajisjeve.

Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e zërit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha kostot tjera për riparime dhe për mirëmbajtje i ngarkohen shpenzimeve tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka tregues se pasuritë mund të kenë rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e vlerësuar është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë të pasurisë minus kostot e shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shuma e rikuperueshme e vlerësuar e saj, ajo ulet në shumën e saj të rikuperueshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e pronës dhe pajisjeve përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël dhe merren parasysh gjatë përcaktimit të rezultatit operativ të periudhës.

Toka dhe ndërtimet në proces e sipër nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës dhe pajisjes regjistrohet në fitim apo humbje duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara siç paraqitet më poshtë:

Kategoria e pasurive

Përmirësimet e hapësirave të marra me qira

Mobile, instalime dhe pajisje

Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse

Automjetet motorike

Normat e përdorura të zhvlerësimit

Koha më e shkurtër ndërmjet jetëgjatësisë dhe kohëzgjatjes së qirasë përkatëse

3–5 vite

3–5 vite

5 vite

Pasuritë e patrupëzuara

Pasuritë e patrupëzuara njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e patrupëzuara fillimisht maten me kosto. Vlerat kontabël të pasurive të patrupëzuara rishikohen për rënie në vlerë, kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Pasuritë e patrupëzuara përbëhen tërësisht nga programet kompjuterike dhe licencat, që amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar që mund të arrijë deri në pesë vite. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programet kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja, njihen si shpenzime kur ndodhin.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Pasuritë me të drejtë përdorimi

Banka merr me qira zyra të ndryshme për degët, bankomatët dhe zyrën e saj qendrore. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-të qirasë. Banka i ndan pagesat e kontratës komponentëve të qirasë dhe atyre jo të qirasë bazuar në çmimet e tyre të pavarura relative. Sidoqoftë, për qiramarrjen e pasurive të patundshme për të cilat Banka është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos i ndajë komponentët e qirasë dhe jo të qirasë dhe në vend të kësaj i llogarit ato si një komponent i vetëm i qirasë.

Pasuritë me të drejtë përdorimi maten në kosto që përfshin të mëposhtmet:

shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,

çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, minus çdo stimulim financiar të pranuar për qiratë, çdo kosto fillestare direkte, dhe

kostot për kthimin e pasurisë në gjendje të caktuar në fund të kontratës, sipas kërkesave të marrëveshjeve të qirasë.

Pasuritë me të drejtë përdorimi në përgjithësi zhvlerësohen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose afatit të qirasë, cilado që është më e shkurtër, në bazë lineare. Nëse Banka në mënyrë të arsyeshme është e sigurtë që do të shfrytëzojë opcionin e blerjes së pasurisë me të drejtë përdorimi, pasuria me të drejtën e përdorimit zhvlerësohet përgjatë jetës së dobishme të pasurive përkatëse. Zhvlerësimi lidhur me zërat e pasurive me të drejtë e përdorimit llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Një humbje nga rënia në vlerë regjistrohet atëherë kur vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera e tanishme e rrjedhave të vlerësuar të parashë në të ardhmen të pritura nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga shitja e saj.

Detyrimet ndaj bankave të tjera dhe llogaritë e klientëve

Detyrimet ndaj bankave të tjera. Detyrimet ndaj bankave të tjera regjistrohen kur para ose pasuri tjera i janë dhënë Bankës nga bankat e tjera. Detyrimi jo-derivativ mbahet me kosto të amortizuar. Nëse Banka blen borxhin e vet, atëherë detyrimi hiqet nga pasqyrat e pozicionit financiar dhe diferenca midis vlerës bartëse të detyrimit dhe shumës së paguar përfshihet në fitimet ose humbjet që rrjedhin nga shlyerja e borxhit.

Llogaritë e klientëve. Llogaritë e klientëve janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit ose korporatave dhe mbahen me kosto të amortizuar.

Fondet e tjera të huazuara. Fondet e tjera të huazuara përfshijnë kreditë e marra nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Fondet e huazuara mbahen me kosto të amortizuar.

Instrumentet financiare derivative. Instrumentet financiare derivative, duke përfshirë instrumentet në valutë të huaj dhe këmbimet, mbarten me vlerën e tyre të drejtë. Të gjitha instrumentet derivative barten si pasuri kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve derivative përfshihen në fitimin ose humbjen për vitin (fitimet minus humbjet mbi derivativët). Banka nuk zbaton kontabilitet mbrojtës. Instrumentet derivative të përfshira në detyrimet financiare dhe kontratat e tjera jofinanciare trajtohen si instrumente të veçanta derivative kur rreziqet dhe karakteristikat e tyre nuk janë të lidhura ngushtë me ato të kontratës bazë.

Tatimet

Tatimi në të ardhura përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi në të ardhura

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe korrigjimet e tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore që janë miratuar ose që në mënyrë thelbësore janë miratuar në datën e raportimit.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të pasurive ose detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin ose humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshëm.

Pasuritë tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të pashfrytëzuara, kreditimet tatimore të pashfrytëzuara dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

Pasuritë tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen nëse nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat tatimore që janë miratuar ose që në mënyrë thelbësore janë miratuar në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra thehen mes vete nëse ekziston e drejta ligjërish e zbatueshme për të thyer detyrimet dhe pasuritë tatimore aktuale, dhe ato lidhen me tatimet e vëna nga i njëjti autoritet tatimor për të njëjtën njësi ekonomike të tatueshme, ose për subjekte të ndryshme tatimore të cilat kanë për qëllim pagesën e detyrimeve dhe pasurive tatimore aktuale në baza neto ose pasuritë dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka e merr parasysh ndikimin e ekspozimeve tatimore, duke përfshirë mundësinë e pagesës së tatimeve shtesë dhe interesit. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

Informacione të reja mund të vihet në dispozicion dhe mund të bëjnë që Banka ta ndryshojë vlerësimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në detyrimet tatimore në periudhën në të cilën bëhet një përcaktim i tillë.

Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat

Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat janë detyrime jofinanciare për të cilat koha dhe shuma e pagesës është e pasigurtë. Provizionet regjistrohen kur Banka ka një obligim ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën dhe është e mundur të kërkohen resurse që përmbajnë përfitime ekonomike për t'i paguar detyrimet dhe mund të bëhet vlerësimi i besueshëm i shumës së detyrimit. Provizionet llogariten përmes vlerësimit më të mirë të menaxhmentit për shpenzimin e nevojitur për t'i paguar detyrimet në datën e bilancit të gjendjes dhe skontojnë në vlerën e tanishme kur efekti është material.

Tarifat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tarifatat rregullative të bazuara në informacionet që kanë të bëjnë me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja obliguese që shkakton pagesën e detyrimit, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton obligimin për të paguar detyrimin. Nëse një pagesë kryhet para ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

Detyrimet e qirasë

Detyrimet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten në bazë të vlerës së tashme. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën e tashme neto të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesa fikse në substancë), minus çdo stimulim financiar të arkëtueshëm të qirasë;
- shumat që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- çmimi i ushtrimit të një opsioni të blerjes nëse qiramarrësi është mjaft i sigurt se do ta ushtrojë atë mundësi, dhe
- pagesa e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron se qiramarrësi e ushtron atë mundësi.

Pagesat e qirasë skontojnë duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet, përdoret norma shtesë e huamarrjes e qiramarrësit, që është norma që qiramarrësi do të duhej ta paguante për t'i marrë hua fondet e nevojshme për të ndërtuar/blerë një pasuri të një vlere të ngjashme në një mjedis të ngjashëm ekonomik me kushte dhe afate të ngjashme. Për ta përcaktuar shkallën e shtesë të huamarrjes, Banka përdor normat shtesë të huamarrjes, të llogaritura nga Departamenti i Thesarit.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Banka është e ekspozuar ndaj rritjeve të mundshme të pagesave të ndryshueshme të qirasë në të ardhmen bazuar në një indeks ose normë, të cilat nuk përfshihen në detyrimin e qirasë deri sa të hyjnë në fuqi. Kur korrigjimet në pagesa të qirasë bazuar në një indeks ose normë hyjnë në fuqi, detyrimi i qirasë rivlerësohet dhe korrigjohet kundrejt pasurisë me të drejtë përdorimi.

Pagesat e qirasë ndahen ndërmjet kryegjësë dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë të vazhdueshme periodike të interesit në pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë.

Pagesat për qiratë afat-shkurtëra të pajisjeve dhe automjeteve dhe të gjitha qiratë e pasurive me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në fitim ose humbje. Qira afat-shkurtëra janë qiratë me kohëzgjatje prej 12 muaj ose më pak.

Përfitimet e punonjësve

Banka paguan kontributet për planin pensional të administruar publikisht (KPST) të cilat janë të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që të jenë paguar këto kontribute. Kontributet njihen si shpenzim i përfitimeve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet përlllogariten, kur pala tjetër ka kryer obligimet përkatëse sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejtë emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si zbritje, neto nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet në kapital si prim për aksionet.

Dividendët

Dividendët regjistrohen në kapital në periudhën në të cilën janë deklaruar. Çdo dividend e deklaruar pas përfundimit të periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpaloset në shënimet e ngjarjeve pasuese. Raportimet financiare të Bankës për qëllime statutores shërbejnë si bazë për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera. Legjislacioni i Kosovës identifikon bazën e shpërndarjes si fitimi neto për vitin aktual.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi regjistrohen për të gjitha instrumentet financiare të matura me KA, mbi bazën akruale, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo metodë shtyn, si pjesë e të ardhurave ose shpenzimeve nga interesi, të gjitha tarifatat e paguara ose të marra midis palëve kontraktuese e që janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera.

Tarifatat të cilat janë pjesë përbërëse të normës efektive të interesit përfshijnë tarifatat fillestare të pranuar ose të paguara nga subjekti, lidhur me krijimin ose blerjen e pasurive financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, si për shembull, tarifatat për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumentit dhe tarifatat për procesimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifatat e zotimit të pranuar nga Banka për të krijuar kredi me normat e interesit të tregut janë përbërëse në normën efektive të interesit nëse është e mundshme se Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike të huadhënies dhe nuk pret që ta shesë kredinë që rezulton menjëherë pas krijimit. Banka nuk i përcakton zotimet kreditore si detyrime financiare me VDPFH.

Për pasuritë financiare të cilat kanë rënie në vlerë kreditore që kur janë blerë ose krijuar, norma efektive e interesit është norma që i skonton rrjedhat e pritura të parasë (përfshirë humbjet fillestare të pritura të kredive) deri në vlerën e drejtë të njohjes fillestare (normalisht e përfaqësuar nga çmimi i blerjes minus kosto e transaksioneve që i atribuohen drejtpërdrejt). Si rezultat, interesi efektiv korrigjohet sipas kredisë.

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Të ardhurat nga interesi llogariten duke përdorur normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të pasurive financiare, përveç për (i) pasuritë financiare ku krediti ka rënë në vlerë (Faza 3), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke përdorur normën efektive të interesit në KA të tyre, neto nga provizioni i HPK dhe (ii) pasuritë financiare me rënie në vlerë kreditore që nga blerja ose krijimi i tyre, për të cilat norma fillestare efektive e interesit e rregulluar sipas kredisë aplikohet në KA.

Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet njihen si më poshtë:

Tarifat e pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një instrumenti financiar (tarifat e lëshimit të një instrumenti si p.sh. tarifatat e vlerësimit të aftësisë kreditore, vlerësimi dhe regjistrimi i garancive dhe kolateralit, negocimi i kushteve të instrumentit dhe procesimi i dokumenteve të transaksionit, etj.) amortizohen sipas metodës efektive të interesit përgjatë jetëgjatësisë efektive të kontratës.

Tarifat për të cilat detyrimi i performancës është përmbushur në një moment të caktuar – këto tarifa njihen si të ardhura ose shpenzime kur detyrimi i performancës është përmbushur (zakonisht kur shërbimi ekzekutohet). Këto tarifa dhe komisione përfshijnë tarifa nga/për: pagesat ndërkombëtare, pagesat vendore, bankimi përmes SMS-ve, tarifatat për kredit kartela (tarifat për tregëtarët, tarifatat për klientët e bankave tjera që përdorin POS-at dhe ATM-at e Bankës, tarifatat për VISA dhe Master, etj.), tarifatat e shërbimeve përmes llogarisë (tarifat për tërheqje të parave, tarifa për depozitim të parave, rivendosja e fjalëkalimit, mbyllja e llogarisë), tarifatat nga transferet e parave, etj.

Tarifat për të cilat detyrimi i performancës është përmbushur me kalimin e kohës – këto tarifa njihen si të ardhura ose shpenzime kur obligimi i performancës përmbushet me kalimin e kohës (përgjithësisht në bazë akruale duke ju referuar përmbushjes së transaksionit të caktuar të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si proporcion i gjithë shërbimeve që do të ofrohen). Tarifatat e tilla përfshijnë tarifatat për mirëmbajtjen e llogarive dhe kredit kartelave, tarifatat nga garancite dhe letrat e kreditit, etj.

Konvertimet e valutës së huaj

Valuta funksionale e Bankës është valuta e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Banka. Valuta funksionale e Bankës është Euro. Euro është valuta në të cilën transaksionet janë të shprehura në mjedisin ekonomik në Republikën e Kosovës.

Pasuritë dhe detyrimet monetare në valuta të tjera përkthehen në valutën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës Qendrore të Kosovës në fund të periudhës raportuese përkatëse. Fitimet dhe humbjet valutores që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i pasurive dhe detyrimeve monetare në valutën funksionale me kurset zyrtare të këmbimit të BQK-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje për vitin (si fitimet nga këmbimi valutor minus humbjet nga këmbimi valutor). Konvertimi në fund të vitit nuk aplikohet për artikujt jo-monetarë që maten me kosto historike.

Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj, janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes nga vlera e drejtë.

Netimi i instrumenteve financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare thyhen ('offset') në mes vete dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të thyer shumat e njohura dhe, ka qëllimin qoftë t'i shlyejë ato në bazë neto, ose ta realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. E drejta e tillë e thyerjes (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga ndonjë ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat vijuese: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) rastet e mospagesës dhe (iii) rastet e mos aftësisë së pagimit ose falimentimit.

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël

Banka bën përlllogaritje dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përlllogaritjet dhe gjykimet vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorët tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në kuadër të rrethanave. Në procesin e zbatimit të politikave kontabël, përveç vlerësimeve, menaxhmenti po ashtu bën gjykime të caktuara. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një korrigjim domethënës në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Matja e humbjeve të pritura kreditore ("HPK"). Matja e HPK është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe inputeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes së HPK janë shpalosur në Shënimin 33. Komponentët e mëposhtëm kanë ndikim madhor në llogaritjen e rezervës për humbjet kreditore: përkufizimi i mospagesës, kriteret për Rritjen e Konsiderueshme të Rrezikut Kreditor ("RRKRrK"), probabiliteti i mospagesës ("PM"), ekspozimi në mospagesë ("EM") dhe humbja në rast të mospagesës ("HRM"), si dhe modelet e skenarëve makroekonomikë. Banka rregullisht rishikon dhe validon modelet dhe inputet e modeleve për të zvogëluar çdo dallim ndërmjet vlerësimeve të pritshme të humbjeve kreditore dhe përvojës aktuale të këtyre humbjeve.

Deri tani, Banka nuk ka integruar ndonjë informacion të ardhshëm për matjen e HPK, kryesisht për shkak të korrelacionit të dobët ndërmjet normave të mospagesës dhe treguesve makroekonomikë. Duke pasur parasysh mungesën e dukshme të korrelacionit domethënës ndërmjet normave të mospagesës dhe treguesve makroekonomikë në dispozicion për Kosovën, Menaxhmenti nuk beson se ka ndonjë ndikim të rëndësishëm dhe të dukshëm të informacionit të ardhshëm në shumën e humbjeve të pritura kreditore më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019. Megjithatë, në baza vjetore Banka do t'i analizojë informacionet për parashikimet e ardhshme dhe në rast se ka ndonjë korrelacion të fortë të treguesve kryesorë makroekonomikë me nivelin e HPK ajo do t'i integrojë ato variabla në modelin e saj në përputhje me rrethanat përkatëse.

Në anën tjetër, Banka ka njohur HPK shtesë (646 mijë Euro) si një faktor shtesë për klientët që mund të ndikohen negativisht nga pandemia COVID-19 në të ardhmën. Bazuar në vlerësimin e menaxhmentit të Bankës, HPK e regjistruar pas këtij faktori shtesë është e duhur.

Ekspozimi kreditor për lehtësitë kreditore revolvuese (p.sh. kartelat e kreditit, mbiterheqjet). Për këto pasuri, Banka përdor maturitet dymbëdhjetë mujorë dhe HPK është aplikuar. Bazuar në procedurat e brendshme të Bankës, këto produkte vlerësohen në baza vjetore pas një vlerësimi të saktë të rrezikut kreditor dhe ligjërisht këto limite janë të revokueshme dhe Banka mund ta anulojë zotimin në çdo kohë.

Rritja ose ulja prej 10% e vlerësimeve të PM-së më 31 dhjetor 2020 do të kishte si rezultat një rritje ose ulje të totalit të rezervave të pritura të humbjes nga kreditë prej 381 mijë Euro (2019: 391 mijë Euro). Rritja ose ulja prej 10% e vlerësimeve të HRM-së më 31 dhjetor 2020 do të kishte si rezultat një rritje ose ulje të totalit të rezervave të pritura të humbjes nga kreditë prej 480 mijë Euro (2019: 646 mijë Euro).

Rritja e konsiderueshme e rrezikut kreditor ("RRKRrK"). Për ta përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor, përveç minimumit të 30 ditëve në vonesë (DNV) që përdoret si kriter, Banka do të përdorë kriteret të tjera cilësore parashikuese, të përkufizuara nga Banka për ta përcaktuar se çfarë duhet të konsiderohet si rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor dhe kështu e krahason jetëgjatësinë relative ndërmjet rrezikut të mospagesës në çdo datë të vëzhgimit me mospagesën përgjatë jetëgjatësisë nga data e fillimit. Nëse që nga njohja fillestare identifikohet një RRKRrK, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por ende nuk konsiderohet që ka pasur rënie në vlerë të kredisë dhe rezerva e humbjes bazohet në HPK për tërë jetëgjatësinë. Nëse një instrument financiar ka rënë në vlerë të kredisë, instrumenti financiar bartet në Fazën 3 dhe rezerva e humbjeve kreditore bazohet në HPK për tërë jetëgjatësinë. Nëse ka dëshmi se kriteret e RRKRrK nuk plotësohen më, instrumenti kthehet prapa në Fazën 1. Nëse një ekspozim është transferuar në Fazën 2 bazuar në një tregues cilësor, Banka monitoron nëse ky tregues vazhdon të ekzistojë ose ka ndryshuar.

Nëse HPK-ja e 5% të kredive dhe paradhënieve për klientët që aktualisht janë në fazën 1 të matura me HPK 12-mujore do të mateshin me HPK për tërë jetëgjatësinë, shuma e rezervës së humbjeve kreditore do të rritej për rreth 2,167 mijë Euro më 31 dhjetor 2020 (2019: rritje për rreth 662 mijë Euro).

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit. Modeli i biznesit e përcakton klasifikimin e pasurive financiare. Menaxhmenti ka zbatuar gjykim në përcaktimin e nivelit të agregimit dhe të portofoliove të instrumenteve financiare gjatë kryerjes së vlerësimit të modelit të biznesit. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjeve, Banka merr parasysh frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin e biznesit "të mbajtura për t'u arkëtuar". Shitjet e tjera para maturimit, që nuk lidhen me aktivitetet e menaxhimit të rrezikut kreditor, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit "të mbajtura për t'u arkëtuar", me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht ashtu dhe në tërësi. Banka vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes duke krahasuar vlerën e shitjeve me vlerën e portofolios që i nënshtrohet vlerësimit të modelit të biznesit mbi jetëgjatësinë mesatare të portofolios. Përveç kësaj, shitjet e pasurisë financiare që pritet të ndodhin vetëm në 'skenarin e rasteve të stresit' ose në përgjigje të një ngjarjeje të izoluar që është jashtë kontrollit të Bankës, që nuk përsëriten dhe nuk mund të ketë qenë parashikuar nga Banka, konsiderohen si të rastësishme për modelin e biznesit dhe nuk ndikojnë në klasifikimin e pasurive financiare përkatëse.

Modeli i biznesit "të mbajtura për arkëtim dhe shitje" nënkupton që pasuritë mbahen për t'i arkëtuar rrjedhat e parave, por shitja është gjithashtu shumë e rëndësishme për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, si p.sh. për menaxhimin e nevojave të likuiditetit, arritjen e të ardhurave të caktuara ose përputhjen e kohëzgjatjes së pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që i financojnë ato pasuri.

Kategoria e mbetur përfshin ato portfolio të pasurive financiare, të cilat menaxhohen me qëllim të realizimit të rrjedhave të parave kryesisht nëpërmjet shitjes, si p.sh. kur ekziston një model i tregtimit. Mbledhja e rrjedhave kontraktuale të parasë shpesh është e rastësishme për këtë model biznesi.

Me kalimin në SNRF 9, Banka ka identifikuar letrat me vlerë në dispozicion për shitje (AFS) si një portfolio likuiditeti dhe i ka klasifikuar si pasuri të mbajtura për t'u arkëtuar dhe shitur. Banka vlerëson që portfolio e saj e kredive hipotekare për banim plotëson kriteret për modelin e biznesit "të mbajtura për t'i arkëtuar" duke përcaktuar që transaksionet e kaluara të sigurimit kanë qenë të rralla dhe prandaj nuk janë në kundërshtim me modelin e biznesit "për t'i arkëtuar".

Vlerësimi nëse rrjedhat e parave janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit ("VPKI"). Kërkohet gjykim kur përcaktohet nëse rrjedhat e parave të pasurisë financiare janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit. Vlera kohore e parasë mund të modifikohet, për shembull, nëse një normë kontraktuale interesi ri-caktohet periodikisht, por frekuenca e këtij ri-caktimi nuk përputhet me normën bazë të interesit të instrumentit të borxhit, siç është rasti për shembull kur një kredi paguan normë tre mujore ndër-bankare të interesit por norma rivendoset çdo muaj. Efekti i vlerës së modifikuar kohore të parasë është vlerësuar duke krahasuar rrjedhat e parave të instrumentit përkatës kundrejt një instrumenti të borxhit referues me rrjedha të parave që paraqesin VPKI, në çdo periudhë dhe në mënyrë kumulative gjatë jetës së instrumentit.

Vlerësimi është bërë për të gjithë skenarët arsyeshmërisht të mundshëm, duke përfshirë situatat arsyeshëm të mundshme të stresit financiar që mund të ndodhin në tregjet financiare. Banka ka identifikuar dhe shqyrtuar kushtet kontraktuale që ndryshojnë kohën ose shumën e rrjedhave kontraktuale të parasë. Kriteri i VPKI është plotësuar nëse mundësohet shlyerja e hershme e një kredie dhe shuma e parapagimit përfaqëson në thelb kryegjënë dhe interesin e përllogaritur plus një kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Kryegjësja e pasurisë është vlera e drejtë në njohjen fillestare minus kthimet e mëposhtme të kryegjësë, përkatësisht këstet neto nga interesi të përcaktuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Si përjashtim nga ky parim, standardi gjithashtu mundëson instrumentet me karakteristika të parapagimit që plotësojnë kushtet e mëposhtme për ta përmbushur VPKI: (i) pasuria fillimisht është marrë/krijuar mbi vlerën e tregut ose me zbritje, (ii) shuma e parapagimit përfaqëson shumën kontraktuale dhe interesin e përllogaritur dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e parakohshme të kontratës, dhe (iii) vlera e drejtë e parapagimit është jomateriale në njohjen fillestare.

Banka ka shqyrtuar shembuj në standard dhe ka konstatuar se tiparet që dalin vetëm nga legjislacioni dhe që nuk janë pjesë e kontratës, pra që tiparet nuk do të zbatoheshin më nëse legjislacioni do të ndryshonte, (siç është legjislacioni i shpëtimit në vende të caktuara), janë jo relevante për ta vlerësuar nëse rrjedhat e parave janë VPKI.

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Modifikimi i pasurive financiare. Kur pasuritë financiare modifikohen në mënyrë kontraktuale (p.sh., rinegociohen), Banka vlerëson nëse modifikimi është thelbësor dhe duhet të ketë si rezultat ç'regjistrimin e pasurisë fillestare dhe njohjen e një pasurie të re me vlerë të drejtë.

Kur vlerëson nëse një kredi ndaj një klienti duhet ç'regjistruar, në mes të tjerave, Banka vlerëson faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimin në valutën e kredisë;
- Nëse paraqitet ndonjë tipar i kapitalit;
- Ndryshimi i palës tjetër në transaksion;
- Nëse modifikimi është i tillë që instrument nuk i plotëson më kriteret e VPKI-së.

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse monetare që janë thelbësisht të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim. Bazuar në ndryshimin e flukseve të parave të skontuara me normën origjinale efektive të interesit, Banka regjistron një fitim ose humbje nga modifikimi, në masën që një humbje nga rënia në vlerë nuk është regjistruar tashmë.

Transferet në pasurinë e investuar dhe vlerësimi i tyre. Pasuria e investuar është paraqitur në vlerën e drejtë bazuar në raportet e përgatitura në fund të periudhës së raportimit nga një vlerësues i pavarur, i kualifikuar profesionalisht dhe i licencuar.

Supozimet kryesore të bëra dhe ndikimi në vlerësimet e përgjithshme të ndryshimeve të mundshme të arsyeshme në këto supozime, me të gjitha variablat tjera të mbajtura konstant, janë si në vijim:

- Vlera e drejtë e pasurive të investuara me 31 dhjetor 2020 është përcaktuar duke përdorur një kombinim të tri metodave: Metoda e krahasimit, Metoda e zhvillimit dhe Metoda e kapitalizimit të të ardhurave. Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2019 është përcaktuar bazuar në qasjen e krahasimit të tregut që reflekton çmimet e fundit për prona të ngjashme.
- Një zvogëlim ('haircut') prej 20% është aplikuar për të arritur te vlera e menjëhershme.

Rënia në vlerë e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive me të drejtë të përdorimit: Banka ka vlerësuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në rënien në vlerë të pasurive jo-financiare. Bazuar në analizën e rënies në vlerë, pandemia nuk ka pasur ndikim domethënës në vlerën bartëse të ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve të Bankës, pasurive me të drejtë të përdorimit dhe pasurive të patrupëzuara.. Nuk janë vërejtur tregues që shkaktojnë rënie në vlerë si pasojë e pandemisë COVID 19.

Përcaktimi i kohëzgjatjes së qirasë. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së qirasë, menaxhmenti merr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një stimulim ekonomik për të ushtruar opsionin e zgjatjes së periudhës së qirasë ose për të mos ushtruar opsionin e ndërprerjes së kontratës. Opsionet e zgjatjes së qirasë (ose opsionet pas periudhës së ndërprerjes) përfshihen në kohëzgjatjen e qirasë vetëm nëse është e sigurtë se periudha e qirasë do të zgjatet (ose nuk do të ndërpritet). Për qiratë e zyrave, zakonisht faktorët në vijim janë më të rëndësishmit:

- Nëse ka ndëshkime të dukshme për të ndërprerë qiranë (ose për të mos zgjatur qiranë), Banka zakonisht në mënyrë të arsyeshme është e sigurtë për të zgjatur (ose për të mos e ndërprerë) qiranë.
- Nëse ndonjë përmirësim i qirasë pritët të ketë një vlerë të konsiderueshme të mbetur, Banka zakonisht në mënyrë të arsyeshme është e sigurtë për të zgjatur (ose për të mos e përfunduar) qiranë.

Përndryshe, Banka merr në konsideratë faktorët e tjerë përfshirë kohëzgjatjet historike të qirasë si dhe kostot dhe ndërprerjen e biznesit që kërkohet për të zëvendësuar pasurinë e marrë me qira.

Opsionet e zgjatjes së periudhës dhe ndërprerjes së qirasë. Opsionet e zgjatjes së periudhës dhe ndërprerjes së qirasë përfshihen në një numër të qirave. Këto përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional gjatë administrimit të pasurive të përdorura në operacionet e Bankës. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga Banka dhe jo nga qiradhënësi përkatës.

3. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Në përcaktimin e afatit të qirasë, menaxhmenti merr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një stimulim ekonomik për të ushtruar opsionin e zgjatjes, ose për të mos ushtruar opsionin e përfundimit. Opsionet e zgjatjes së periudhës (ose opsionet pas periudhës së ndërprerjes) përfshihen në kohëzgjatjen e qirasë vetëm nëse është e sigurtë se periudha e qirasë do të zgjatet (ose nuk do të ndërpritet).

Faktorët e mëposhtëm zakonisht janë më të rëndësishmit:

- Nëse ka ndëshkime të dukshme për të ndërprerë (ose për të mos zgjatur periudhën), Banka zakonisht në mënyrë të arsyeshme është e sigurtë për të zgjatur (ose për të mos e ndërprerë) qiranë.
- Nëse ndonjë përmirësim i qirasë pritët të ketë një vlerë të konsiderueshme të mbetur, Banka zakonisht në mënyrë të arsyeshme është e sigurtë për të zgjatur (ose për të mos e përfunduar) qiranë.
- Përndryshe, Banka merr në konsideratë faktorët të tjerë përfshirë kohëzgjatjet historike të qirasë dhe kostot dhe ndërprerjen e biznesit që kërkohet për të zëvendësuar pasurinë e marrë me qira.

Shumica e opsioneve të zgjatjes së periudhës për qiratë e zyreve dhe pajisjeve nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë, sepse Banka mund të zëvendësojë pasuritë pa kosto të konsiderueshme ose ndërprerje të biznesit.

Afati i qirasë rivlerësohet nëse një opsion ushtrohet (ose nuk ushtrohet) ose Banka detyrohet ta ushtrojë (ose të mos ushtrojë) atë. Vlerësimi i kësaj sigurie të arsyeshme rishikohet vetëm nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm i rrethanave, gjë që ndikon në këtë vlerësim, dhe që është nën kontrollin e qiramarrësit.

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** – Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë raportuese vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e pasurive që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet financiare", SNK 39 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shpalosjet"** – Reforma e normës së interesit referues (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" dhe SNK 8 "Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit dhe gabimet"** – përkufizimi çka është materiale (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në referencat e Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF-së** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** – COVID-19 – konsesionet e lidhura me qiratë (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020).

5. Standardet dhe interpretimet jo efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet jo efektive në periudhën aktuale

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja të mëposhtme ishin publikuar, por jo ende efektive.

- **SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”** - përfshinë ndryshimet në SNRF 17 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** – Referenca në Kornizën Konceptuale me ndryshimet në SNRF 3 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- **Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit”** – Zgjatja e përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 (data e skadimit të përjashtimit nga SNRF 9 është zgjatur për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat e konsoliduara financiare” dhe SNK 28 “Investimet në shoqëritë dhe ndërmarrjet e përbashkëta”** – shitja ose kontributi i asetëve ndërmjet një investitori dhe një sipërmarrjeje ose ndërmarrje të përbashkët dhe ndryshime të mëtutjeshme (data efektive e shtyrë për një kohë të pacaktuar deri në përfundimin e projektit për hulumtimin mbi metodat e kapitalit).
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** – klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtëra dhe afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- **Ndryshimet në SNK 16 “Prona, pajisjet dhe impiantet”** – Të ardhurat para përdorimit të synuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- **Ndryshimet në SNK 37 “Provizionet, detyrimet e kontigjente dhe pasuritë kontigjente”** – Kontratat e mëdha – kostoja e përmbushjes së një kontrate (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet financiare”, SNK 39 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”, SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Shpalosjet”, SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” dhe SNRF 16 “Qiratë”** – reforma e normës së interesit referues – faza 2 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të “Përmirësimet në SNRF (cikli 2018-2020)”** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Ndryshimi në SNRF 16 ka të bëjë vetëm me një shembull ilustrues, kështu që asnjë datë efektive nuk është deklaruar).

Banka ka zgjedhur që mos të miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre efektive. Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

6. Mjetet monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paraja e gatshme	29,956	28,502
Llogaritë në banka		
- Llogaritë rrjedhëse me bankat	31,820	28,228
- Llogaria rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK")	19,887	11,020
- Llogaria e rezervës së detyrueshme në BQK	49,561	43,858
	101,268	83,106
Mjetet monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat para lejimeve nga humbjet kreditore	131,224	111,608
Lejimet nga humbjet kreditore	(30)	(23)
Gjithsej	131,194	111,585

Më 31 dhjetor 2020 Banka ka njohur 30 mijë Euro (2019: 23 mijë Euro) si lejim për humbjet kreditore për paratë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe gjendjen në Bankën Qendrore, sipas politikës së Bankës për humbjet kreditore, me një probabilitet të vlerësuar të ndodhjes prej 0.05% dhe humbje në rast të mospagesës prej 45%.

Në përputhje me kërkesat e BQK-së, Banka mban si rezervë të detyrueshme një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit. Rezerva e detyrueshme mund të mbahet në formë të instrumenteve tejet likuide, duke përfshirë paratë e gatshme në dorë, llogaritë në BQK ose në bankat e tjera në Kosovë, si dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jetë më pak se gjysma e totalit të rezervave të detyrueshme. Në datën 31 dhjetor 2020 dhe 2019 rezerva e detyrueshme përbëhet nga paratë e mbajtura në BQK.

Paraja dhe ekuivalentët e saj në pasqyrën e rrjedhës së parasë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përfshijnë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paraja e gatshme dhe llogaritë rrjedhëse në banka	61,776	56,730
Bilanci i pakufizuar në BQK	19,887	11,020
Kreditë dhe paradhëniet për bankat (shënimi 7)	74,950	65,391
Gjithsej	156,613	133,141
Lejimet për humbjet kreditore	(287)	(147)
Gjithsej	156,326	132,994

Cilësia kreditore. Tabela në vazhdim paraqet klasifikimin kreditor të dhënë nga agjencitë e klasifikimit kreditor Moody's, Fitch dhe Standard and Poor's. Të gjitha gjendjet me 7 banka të tjera (2019: 7) janë duke performuar në Fazën 1.

Vlerësimet	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AAA	6,257	6,460
A+	215	519
A3	16,508	10,481
B+	10	2
BBB-	8,830	10,766
Gjendjet në BQK – që nuk janë të vlerësuara	69,448	54,878
Gjithsej paraja dhe gjendjet në Bankën Qendrore (duke përfshirë paratë e gatshme)	101,268	83,106
Lejimet për humbjet kreditore	(30)	(23)
Gjithsej paratë e gatshme dhe në banka (vlera bartëse)	101,238	83,083

Ndonëse bonot e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk janë të vlerësuara nga ndonjë institucion ndërkombëtar vlerësimi, borxhi publik është aktualisht në nivele nën 24% të BPV-së dhe rritja e parashikuar në planin afat-mesëm pritet të mbetet nën 35% të BPV-së, që konsiderohet të jetë i arsyeshëm për Kosovën¹. Ky nivel i borxhit publik dhe stabiliteti i përgjithshëm i buxhetit që kërkon që çdo deficit buxhetor të mbetet brenda -5% të BPV-së duke ndjekur rregullat fiskale të FMN-së janë faktorët kryesorë për vlerësimin e instrumenteve të lëshuara nga qeveria si të qëndrueshme.

¹ Burimi: Ministria e Financave/Buxheti i Republikës së Kosovës

7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	74,950	65,391
Lejimet për humbjet kreditore	(268)	(133)
Gjithsej	74,682	65,258

Kreditë dhe paradhëniet për bankat më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 që kanë maturitetet fillestar më pak se 3 muaj përfshihen në ekuivalentët e parasë.

Normat vjetore të interesit (N/I) për depozitat me afat në banka në fund të periudhës raportuese janë si në vijim:

- Euro: 2020 – max N/I 0.90%, min N/I - 0.78% Euro: 2019 – max N/I 0.85%, min N/I - 2.00%
- USD: 2020 – max N/I 1.70%, min N/I 0.01% USD: 2019 – max N/I 1.70%, min N/I 1.57%

Cilësia kreditore. Vlerësimi kreditor është dhënë nga agjencitë e vlerësimit kreditor Moody's, Fitch dhe Standard & Poor. Për qëllim të matjes së HPK, kreditë dhe paradhëniet për bankat performojnë në Fazën 1. Vlera bartëse e kredive dhe paradhënies për bankat e tjera më 31 dhjetor 2020 më poshtë paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut kreditor për këto pasuri:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aaa	3,423	3,400
Aa1	10,004	-
A2	-	10,804
Aa3	9,548	9,513
B+	-	3,000
B3	35,448	38,674
Të pavlerësuara	16,527	-
Vlera bartëse bruto	74,950	65,391
Lejimet për humbjet kreditore	(268)	(133)
Vlera bartëse neto	74,682	65,258

Ndryshimet në lejimet për humbjet kreditore dhe vlerën bartëse bruto të kredive dhe paradhënies ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës raportuese.

	Lejimet për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Kreditë dhe paradhëniet për bankat								
Më 1 janar 2020	(134)	-	-	(134)	65,391	-	-	65,391
<i>Lëvizjet që ndikojnë në ngarkesën e lejitimit të humbjeve kreditore për periudhën:</i>								
Të reja të krijuara ose të blera	(268)	-	-	(268)	74,950	-	-	74,950
Të ç'regjistruara gjatë periudhës	134	-	-	134	(65,391)	-	-	(65,391)
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën për lejinin e humbjeve kreditore për periudhën	(134)	-	-	(134)	9,559	-	-	9,559
Më 31 dhjetor 2020	(268)	-	-	(268)	74,950	-	-	74,950

7. Kreditë dhe paradhëniet për bankat (vazhdim)

	Lejimet për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Kreditë dhe paradhëniet për bankat								
Më 1 janar 2019	(102)	-	-	(102)	54,341	-	-	54,341
<i>Lëvizjet që ndikojnë në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</i>								
Të reja të krijuara ose të blera	(133)	-	-	(133)	65,391	-	-	65,391
Të ç'regjistruara gjatë periudhës	102	-	-	102	(54,341)	-	-	(54,341)
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën për lejimin e humbjeve kreditore për periudhën	(31)	-	-	(31)	11,050	-	-	11,050
Më 31 dhjetor 2019	(133)	-	-	(133)	65,391	-	-	65,391

8. Investimet në letrat me vlerë borxhi me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Obligacionet e thesarit të Qeverisë së Kosovës	-	499
Bonot e Qeverisë së Kosovës	25,928	13,668
Gjithsej	25,928	14,167

Normat e interesit nga obligacionet qeveritare dhe bonot e thesarit në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- Bonot: 2020 – max. 2.70%, min. 0.88% 2019 – max. 5.15%, min. 0.50%
- Obligacionet: 2020 – nuk ka pasur 2019 – max. 0.70%, min. 0.70%

Borxhi publik në Kosovë është aktualisht nën 24% të BPV-së dhe rritja e projektuar në periudhën afatmesme pritet të mbetet nën 35% të BPV-së. Ky nivel maskimal i përqindjes dhe stabiliteti i përgjithshëm buxhetor që kërkon që çdo deficit buxhetor të mbetet brenda -5% të BPV-së siç kërkohej nga rregullat fiskale të FMN-së, janë faktorët kyç për vlerësimin e instrumenteve të lëshuara nga Qeveria si të qëndrueshme.

Investimet në letrat me vlerë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë matur me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Lëvizja gjatë vitit e letrave me vlerë të borxhit të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është paraqitur si në vijim:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja fillestare	14,167	16,254
Shtesat	23,070	10,262
Letrat me vlerë të borxhit të shitura të maturuara	(4,095)	(12,317)
Letrat me vlerë të borxhit të shitura	(7,253)	(100)
Ngarkesa me interes të përlogaritur	37	5
Ndryshimi në vlerën e drejtë	2	63
Gjendja mbyllëse	25,928	14,167

8. Investimet në letrat me vlerë borxhi me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (vazhdim)

Tabela më poshtë përmban një analizë të ekspozimit të rrezikut kreditor të investimeve në letra me vlerë të matura me VDPATGJ më 31 dhjetor 2020. Pasuritë e tilla, automatikisht klasifikohen në Fazën 1 për të cilën njihet një lejim i HPK bazuar në PM minimale të Basel-it prej 0.05% dhe HRM prej 45%.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
<i>Obligacionet e thesarit të Qeverisë së Kosovës</i>				
Të pavlerësuara	-	-	-	-
Vlera bartëse bruto	-	-	-	-
Minus: Lejimet për humbjet kreditore	-	-	-	-
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë nga KA në VDPATGJ	-	-	-	-
Vlera bartëse (vlera e drejtë)	-	-	-	-
<i>Bonot e Qeverisë së Kosovës</i>				
Të pavlerësuara	25,858	-	-	25,858
Vlera bartëse bruto	25,858	-	-	25,858
Minus: Lejimet për humbjet kreditore	(6)	-	-	(6)
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë nga KA në VD	70	-	-	70
Vlera bartëse (vlera e drejtë)	25,922	-	-	25,922
Gjithsej vlera bartëse (vlera e drejtë)	25,928	-	-	25,928

Tabela më poshtë përmban një analizë të ekspozimit të rrezikut kreditor të investimeve në letra me vlerë borxhi me VDPATGJ në datën 31 dhjetor 2019. Pasuritë e tilla, automatikisht klasifikohen në Fazën 1 për të cilën njihet një lejim i HPK bazuar në probabilitetin e mospagesës ("PM") minimale të Basel-it prej 0.05% dhe humbjes në rast të mospagesës ("HRM") prej 45 %.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
<i>Obligacionet e thesarit të Qeverisë së Kosovës</i>				
Të pavlerësuara	497	-	-	497
Vlera bartëse bruto	497	-	-	497
Minus: Lejimet për humbjet kreditore	-	-	-	-
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë nga KA në VDPATGJ	2	-	-	2
Vlera bartëse (vlera e drejtë)	499	-	-	499
<i>Bonot e Qeverisë së Kosovës</i>				
Të pavlerësuara	13,605	-	-	13,605
Vlera bartëse bruto	13,605	-	-	13,605
Minus: Lejimet për humbjet kreditore	(3)	-	-	(3)
Minus: Rregullimet për vlerën e drejtë nga KA në VD	66	-	-	66
Vlera bartëse (vlera e drejtë)	13,668	-	-	13,668
Gjithsej vlera bartëse (vlera e drejtë)	14,167	-	-	14,167

9. Kredi dhe paradhënie për klientët

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Vlera bartëse bruto e kredive dhe paradhënieve për klientët të matura me KA	423,358	404,875
Lejimet për humbjet kreditore	(8,664)	(7,564)
Gjithsej vlera bartëse e kredive dhe paradhënieve për klientët të matura me KA	414,694	397,311

Portofolio i kredive dhe paradhënieve për klientët përmbush kërkesat e VPKI për matje me KA. Si rezultat, kreditë dhe paradhëniet klasifikohen dhe maten në KA. Vlera bartëse bruto e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut kreditor që rrjedh nga kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve.

Vlera bartëse bruto dhe lejimet për humbjet kreditore për kreditë dhe paradhëniet për klientët të matura me KA, sipas kategorive, më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Vlera bartëse bruto	Lejimet për humbjet kreditore	Vlera bartëse neto	Vlera bartëse bruto	Lejimet për humbjet kreditore	Vlera bartëse neto
<i>Kreditë për individët</i>	223,642	(3,378)	220,264	215,706	(3,202)	212,504
Kredi standarde	193,910	(2,458)	191,452	183,556	(2,435)	181,121
Mbitërheqjet	1,493	(60)	1,433	2,175	(76)	2,099
Kartelat e kreditit	28,239	(860)	27,379	29,975	(691)	29,284
<i>Kreditë për entitetet ligjore</i>	199,716	(5,286)	194,430	189,169	(4,362)	184,807
Kredi standarde	166,109	(4,649)	161,460	157,459	(3,696)	153,763
Mbitërheqjet	30,160	(489)	29,671	28,014	(558)	27,456
Kartelat e kreditit	3,447	(148)	3,299	3,696	(108)	3,588
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët të matura me KA	423,358	(8,664)	414,694	404,875	(7,564)	397,311

Lëvizja në lirimimin e rezervës së humbjes kreditore është si në vijim:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej
Gjendja më 1 janar	3,202	4,362	7,564	4,259	7,624	11,883
(Lirimi)/humbja për vitin	1,065	1,465	2,530	(15)	(1,967)	(1,982)
Kreditë e shlyera	(888)	(542)	(1,430)	(1,042)	(1,295)	(2,337)
Gjendja më 31 dhjetor	3,379	5,285	8,664	3,202	4,362	7,564

Humbja nga kreditë e njohur në fitim ose humbje është si në vijim:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej
Lirimi/(ngarkesa) gjatë vitit	(1,065)	(1,465)	(2,530)	15	1,967	1,982
Rikuperimet nga kreditë e shlyera	761	821	1,582	738	1,024	1,762
Gjithsej për vitin	(304)	(644)	(948)	753	2,991	3,744

Lirimi i HPK-së është i lidhur drejtpërdrejt me metodologjinë e zbatuar nga Banka e cila përbëhet nga një mesatare e normave të mospagesës ("NM") për pesë vitet e fundit. NM-të e Bankës kanë vazhduar të ulen që nga viti 2015 dhe cilësia e portfolios është përmirësuar gradualisht. Aktualisht, kreditë joperformuese janë 1.5% e totalit të portfolios kreditore që është pak më mirë se mesatarja në tregun bankar në Kosovë ndërsa në vitin paraprak modeli i HPK-së përfshinte NM-të e vitit 2014 i cili ka qenë një nga vitet më të këqija të Bankës për sa i përket mospagesave.

TEB SH.A.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare - 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumatat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)***9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2020, dhjetë huamarrësit më të mëdhenj përbëjnë 5.62% (2019: 6.87%) të totalit të kredive. Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë interesin e përlogaritur prej 2,198 mijë Euro (2019: 1,891 mijë Euro) dhe tarifën e shtyrë të disbursimit prej 1,191 mijë Euro (2019: 1,269 mijë Euro).

Tabela në vijim paraqet ndryshimet në lejimin për humbjet kreditore dhe vlerën bartëse bruto për kreditë dhe paradhëniet për klientët të mbajtura me koston e amortizuar ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës raportuese.

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
<i>Kredi standard</i>								
Më 1 janar 2020	2,480	960	2,691	6,131	323,802	12,555	4,658	341,015
<i>Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</i>								
Transferimet:								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(23)	148	-	125	(2,081)	1,605	-	(476)
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(86)	-	580	494	(1,318)	-	1,076	(242)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	35	(174)	-	(139)	3,744	(5,527)	-	(1,783)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(422)	792	370	-	(1,565)	1,390	(175)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	(4)	(4)	4	-	(7)	(3)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	17	(39)	(22)	-	57	(83)	(26)
(Lirim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	(617)	(15)	271	(361)	(65,231)	(745)	(380)	(66,356)
Plotesisht të ripaguara gjatë vitit	(521)	(207)	(95)	(823)	(77,742)	(3,413)	(703)	(81,858)
Kredi të reja	1,531	277	267	2,075	167,721	2,544	397	170,662
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	2,799	584	4,463	7,846	348,899	5,511	6,348	360,758
<i>Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjet kreditore për periudhën:</i>								
Shlyerjet	-	-	(739)	(739)	-	-	(739)	(739)
Më 31 dhjetor 2020	2,799	584	3,724	7,107	348,899	5,511	5,609	360,019

TEB SH.A.
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare - 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)
9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Kredi standard								
Më 1 janar 2019	3,840	1,865	4,017	9,722	298,383	23,682	5,980	328,045
Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:								
Transferimet:								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(45)	164	-	119	(3,090)	2,220	-	(870)
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(15)	-	219	204	(598)	-	452	(146)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(441)	613	172	-	(1,281)	1,028	(253)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	68	(187)	(119)	-	217	(316)	(99)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	52	(419)	-	(367)	6,598	(8,325)	-	(1,727)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	(32)	(32)	39	-	(55)	(16)
(Lirim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	(1,760)	(263)	(362)	(2,385)	(64,529)	(2,846)	(626)	(68,001)
Plotesisht te ripaguara gjatë vitit	(792)	(341)	(239)	(1,372)	(67,794)	(6,102)	(768)	(74,664)
Kredi të reja	1,200	327	403	1,930	154,793	4,990	704	160,487
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	2,480	960	4,432	7,872	323,802	12,555	6,399	342,756
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Shlyerjet	-	-	(1,741)	(1,741)	-	-	(1,741)	(1,741)
Më 31 dhjetor 2019	2,480	960	2,691	6,131	323,802	12,555	4,658	341,015

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelat e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit për kreditë që kanë qenë aktive me 1 janar 2020 dhe 2019 dhe janë akoma kredi aktive deri më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2019.

Kreditë plotësisht të ripaguara gjatë vitit, përfaqësojnë kreditë që ishin aktive nga 1 janari 2020 dhe 2019, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
<i>Mbitërheqjet</i>								
Më 1 janar 2020	224	33	377	634	28,766	967	456	30,189
<i>Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:</i>								
Transferet:								
Transfer nga Faza 1 në Fazën 2	(11)	60	-	49	(590)	578	-	(12)
Transfer nga Faza 1 në Fazën 3	(3)		109	106	(227)	-	175	(52)
Transfer nga Faza 2 në Fazën 1	6	(6)	-	-	640	(556)		84
Transfer nga Faza 2 në Fazën 2	-	(14)	36	22	-	(111)	80	(31)
Transfer nga Faza 2 në Fazën 1	-	-	-	-	-	-	-	-
Transfer nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-	-	-	-	-
(Lëshim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	31	3	9	43	302	(7)	(16)	279
Plotesisht te ripaguara gjatë vitit	(36)	(13)	(52)	(101)	(4,484)	(225)	(94)	(4,803)
Paradhënie të reja	39	3	4	46	5,863	380	6	6,249
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	250	66	483	799	30,270	1,026	607	31,903
<i>Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:</i>								
Shlyerjet			(250)	(250)			(250)	(250)
Më 31 dhjetor 2020	250	66	233	549	30,270	1,026	357	31,653

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Mbitërheqjet								
Më 1 janar 2019	453	96	536	1,085	30,075	1,854	753	32,682
Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:								
Transferimet:								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(8)	19	-	11	(583)	449	-	(134)
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(2)	-	58	56	(168)	-	94	(74)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(16)	32	16	-	(61)	47	(14)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	-	-	-	1	-	1
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	7	(14)	-	(7)	727	(716)	-	11
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-	-	-	-	-
(Lirim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	(143)	-	(40)	(183)	1,973	(67)	(185)	1,721
Plotësisht të ripaguara gjatë vitit	(125)	(59)	(87)	(271)	(8,268)	(793)	(133)	(9,194)
Paradhënie të reja	42	7	13	62	5,010	300	15	5,325
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	224	33	512	769	28,766	967	591	30,324
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Shlyerjet	-	-	(135)	(135)	-	-	(135)	(135)
Më 31 dhjetor 2019	224	33	377	634	28,766	967	456	30,189

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelën e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit për mbitërheqjet që kanë qenë aktive më 1 janar 2020 dhe 2019 dhe janë akoma mbitërheqje aktive më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2019.

Paradhëniet plotësisht të kthyera gjatë vitit, përfaqësojnë mbitërheqjet që ishin aktive më 1 janar 2020 dhe 2019, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Kartelat e kreditit								
Më 1 janar 2020	360	109	330	799	29,834	3,008	829	33,671
Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:								
Transferimet:								
Transferim nga Faza 1 në Fazën 2	(14)	133	-	119	(932)	859	-	(73)
Transferim nga Faza 1 në Fazën 3	(4)	-	122	118	(198)	-	171	(27)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 1	19	(40)	-	(21)	1,406	(1,664)	-	(258)
Transferim nga Faza 2 në Fazën 3	-	(23)	166	143	-	(270)	233	(37)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	(13)	(13)	8	-	(46)	(38)
Transferim nga Faza 3 në Fazën 2	-	6	(20)	(14)	-	14	(65)	(51)
(Lirim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	(34)	76	65	107	(1,099)	(106)	(37)	(1,242)
Plotesisht të ripaguara gjatë vitit	(62)	(15)	189	112	(5,060)	(402)	(123)	(5,585)
Kredit kartela të reja	58	18	23	99	5,424	310	33	5,767
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	323	264	862	1,449	29,383	1,749	995	32,127
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Shlyerjet	-	-	(441)	(441)	-	-	(441)	(441)
Më 31 dhjetor 2020	323	264	421	1,008	29,383	1,749	554	31,686

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

	Lejimi për humbjet kreditore				Vlera bartëse bruto			
	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRRK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Kartelat e kreditit								
Më 1 janar 2019	623	142	311	1,076	30,535	3,160	768	34,463
Lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën:								
Transferet:								
Transfer nga Faza 1 në Fazën 2	(22)	31	-	9	(772)	695	-	(77)
Transfer nga Faza 1 në Fazën 3	(186)	-	252	66	(254)	-	221	(33)
Transfer nga Faza 2 në Fazën 3	-	(69)	114	45	-	(278)	228	(50)
Transfer nga Faza 3 në Fazën 2	-	1	(13)	(12)	-	12	(38)	(26)
Transfer nga Faza 2 në Fazën 1	7	(22)	-	(15)	493	(571)	-	(78)
Transfer nga Faza 3 në Fazën 1	1	-	(7)	(6)	-	11	(21)	(10)
(Lirim-Ripagesë)/rritja nga faza e njëjtë	(174)	(13)	35	(152)	(1,020)	(207)	(30)	(1,257)
Plotesisht te ripaguara gjatë vitit	(9)	(2)	(19)	(30)	(9,179)	(838)	(137)	(10,154)
Kredit kartela të reja	120	41	118	279	10,031	1,024	299	11,354
Gjithsej lëvizjet me ndikim në ngarkesën e lejimit të humbjeve kreditore për periudhën	360	109	791	1,260	29,834	3,008	1,290	34,132
Lëvizjet pa ndikim në ngarkesën e lejimit për humbjet kreditore për periudhën:								
Shlyerjet	-	-	(461)	(461)	-	-	(461)	(461)
Më 31 dhjetor 2019	360	109	330	799	29,834	3,008	829	33,671

Lirimet dhe/ose ripagesat nga e njëjta fazë, në tabelën e mësipërme, paraqesin shumën e ripagesave gjatë vitit për kartelat e kreditit që kanë qenë aktive më 1 janar 2020 dhe 2019 dhe janë akoma kartela aktive të kreditit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe Faza e të cilave ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2019.

Mbitërheqjet plotësisht të kthyera gjatë vitit, përfaqësojnë kartelat e kreditit që ishin aktive më 1 janar 2019, por që janë ripaguar plotësisht gjatë vitit dhe nuk janë më aktive më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Analiza sipas cilësisë kreditore të kredive të papaguara për klientë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është si vijon:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Indi-vidët	Entitete ligjore	Gjithsej	Entitete ligjore	Subjekte	Gjithsej
Kreditë e rëna në vlerë kolektivisht - Faza 1 dhe Faza 2						
0 ditë në vonesë	220,162	194,025	414,187	211,495	183,447	394,942
1 deri në 30 ditë në vonesë	824	641	1,465	1,236	1,350	2,586
31 deri në 90 ditë në vonesë	563	551	1,114	539	865	1,404
Gjithsej kreditë e rëna në vlerë kolektivisht - Faza 1 dhe Faza 2	221,549	195,217	416,766	213,270	185,662	398,932
Kreditë e rëna në vlerë individualisht - Faza 1 dhe Faza 2						
0 ditë në vonesë	-	19	19	-	-	-
1 deri në 30 ditë në vonesë	-	-	-	-	-	-
31 deri në 90 ditë në vonesë	-	53	53	-	-	-
Gjithsej kreditë e rëna në vlerë individualisht - Faza 1 dhe Faza 2	-	72	72	-	-	-
Kreditë e rëna në vlerë kolektivisht - Faza 3						
0 ditë në vonesë	94	38	132	74	32	106
1 deri në 30 ditë në vonesë	29	12	41	34	21	55
31 deri në 90 ditë në vonesë	42	22	64	30	98	128
Mbi 90 ditë në vonesë	1,760	1,122	2,882	2,109	944	3,053
Gjithsej kreditë e rëna në vlerë kolektivisht - Faza 3	1,925	1,194	3,119	2,247	1,095	3,342
Kreditë e rëna në vlerë individualisht - Faza 3						
0 ditë në vonesë	26	245	271	2	304	306
1 deri në 30 ditë në vonesë	-	409	409	-	89	89
31 deri në 90 ditë në vonesë	-	177	177	-	87	87
Mbi 90 ditë në vonesë	142	2,402	2,544	187	1,932	2,119
Gjithsej kreditë e rëna në vlerë individualisht - Faza 3	168	3,233	3,401	189	2,412	2,601
Gjithsej kreditë	223,642	199,716	423,358	215,706	189,169	404,875
Humbjet e pritura kreditore	(3,378)	(5,286)	(8,664)	(3,202)	(4,362)	(7,564)
Kreditë neto	220,264	194,430	414,694	212,504	184,807	397,311

Kreditë me kushte të rinegociuara

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i konsideronte përndryshe. Një vendim për ristrukturim i nënshtrohet parakushteve vijuese:

- ristrukturimi rrit probabilitetin që kredimarrësi do të jetë në gjendje ta paguajë ekspozimin;
- plani i ri i pagesave është në harmoni me kapacitetin aktual dhe të pritur të klientit për pagesë në të ardhmen;
- kredimarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundshme dhe e përshtatshme.

Kreditë me kushte të rinegociuara	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Faza 1	661	-
Faza 2	1,141	1,631
Faza 3	2,561	2,178
Gjithse vlera bruto	4,363	3,809
Rënia në vlerë individuale	(1,447)	(896)
Rënia në vlerë kolektive	(663)	(931)
Neto	2,253	1,982

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Përqendrimet e rrezikut të portofolios së kredive të klientëve sipas sektorit të ekonomisë janë si më poshtë::

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Kreditë neto	%	Kreditë neto	%
Individët	220,265	53.1%	212,505	53.5%
Energji elektrike, ngrohje, ujë	1,071	0.3%	510	0.1%
Industri	31,096	7.5%	27,439	6.9%
Bujqësi	8,090	2.0%	7,697	1.9%
Shërbimet dhe të tjera	13,794	3.3%	11,946	3.0%
Hotele dhe restaurante	11,757	2.8%	12,538	3.2%
Transport dhe komunikim	6,654	1.6%	5,283	1.3%
Ndërtimtari	19,828	4.8%	21,942	5.5%
Tregti	102,139	24.6%	97,451	24.5%
Kreditë neto për klientët	414,694	100%	397,311	100%

Politikat e Bankës lidhur me marrjen e kolateralit nuk kanë ndryshuar dukshëm gjatë periudhës raportuese dhe nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në cilësinë e përgjithshme të kolateralit të mbajtur nga Banka që nga periudha e mëparshme.

Informacioni rreth kolateralit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si në vijim:

Llojet e kolateralit

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej	Individët	Entitetet ligjore	Gjithsej
Hipoteka	50,347	267,048	317,395	49,692	288,489	338,181
Kolateral në para të gatshme	2,194	3,889	6,083	4,053	7,762	11,815
Mallrat dhe pajisjet e lëna peng	160,234	431,899	592,133	191,037	364,984	556,021
Veturat e lëna peng	14,193	42,994	57,187	12,352	39,226	51,578
Gjithsej	226,968	745,830	972,798	257,134	700,461	957,595

Vlera e drejtë e kolateralit e shpalosur më sipër përcaktohet nga vlerësues të çertifikuar vendorë të brendshëm dhe të jashtëm të Bankës dhe ka për qëllim ta përfaqësojë vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të pasurive. Për shkak të rrethanave vendore në Kosovë ku tregu nuk është aktiv, Banka adapton një qasje të kujdesshme në përcaktimin e vlerës së kolateraleve të tilla. Banka synon të përdorë kolaterale që mund të konvertohen në pasuri likuide brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shpalosur vlerat e kolateralit veçmas për (i) ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë të barabarta ose tejkalojnë vlerën kontabël të pasurisë ("pasuri të mbi-kolateralizuara") dhe (ii) ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë më pak se vlera kontabël e pasurisë ("pasuri të nën-kolateralizuara"). Efekti i kolateralit më 31 dhjetor 2020:

	Pasuritë e mbi-kolateralizuara		Pasuritë e nën-kolateralizuara	
	Vlera bartëse e pasurive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bartëse pasurive	Vlera e drejtë e kolateralit
Kreditë për individët	108,030	224,912	115,612	2,056
Kreditë për entitetet ligjore	186,643	741,777	13,073	4,053

9. Kreditë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Efeki i kolateralit më 31 dhjetor 2019:

	Pasuritë e mbi-kolateralizuara		Pasuritë e nën-kolateralizuara	
	Vlera bartëse pasurive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bartëse e pasurive	Vlera e drejtë e kolateralit
Kreditë për individët	135,636	254,772	80,063	2,362
Kreditë për entitetet ligjore	171,284	693,650	17,892	6,811

Banka kryen vlerësimin e kolateralit në kohën e dhënies së kredive dhe përgjithësisht e përditëson atë çdo vit varësisht nga ekspozimi kreditor dhe/ose ndryshimet e tregut të ndikuara nga faktorët e jashtëm. Vlera e drejtë e kolateralit e shpalosur më sipër përcaktohet nga vlerësues të certifikuar vendorë të brendshëm dhe të jashtëm të Bankës dhe ka për qëllim ta përfaqësojë vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të pasurive. Për shkak të rrethanave vendore në Kosovë ku tregu nuk është aktiv, Banka zbaton një qasje të kujdesshme në përcaktimin e vlerës së këtyre kolateraleve; prandaj, vlera e kolateralit të shqyrtuar në këtë shpalosje është vlera pasi është aplikuar një ulje në vlerë ("haircut") prej [15-50%] ndaj vlerësimit fillestar, varësisht nga likuiditeti dhe cilësia e pasurisë së lënë peng. Banka synon të përdorë kolaterale që mund të konvertohen në pasuri likuide brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Shumat e papaguara kontraktuale të kredive dhe paradhëniet për klientët që janë shlyer që janë ende subjekt i veprimtarisë së përmbarimit, ishin si vijon më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Kredi për entitete ligjore</i>	4,791	6,257
Kredi	4,106	5,387
Mbitërheqje	561	835
Kartelat e kreditit	124	35
<i>Kreditë për individë</i>	409	122
Kredi	343	100
Mbitërheqje	16	2
Kartelat e kreditit	50	20
Gjithsej	5,200	6,379

10. Pasuria e investuar

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasuri e investuar me vlerën e drejtë në datën 1 janar	1,590	-
Transferi nga pronat e zotëruara nga pronarët	-	1,200
Rritja në vlerën e drejtë nga vlerësimi	59	390
Pronat e investimeve në vlerë të drejtë në datën 31 dhjetor	1,649	1,590

Pasuria e investuar e Bankës përfshin një tokë ndërtimi të transferuar nga prona e zotëruar nga pronari në pronë të investuar të mbajtur për rritje të vlerës së kapitalit. Toka është blerë në vitin 2013, me qëllim të shfrytëzimit të saj për ndërtimin e zyrës së re qendrore të Bankës. Më 20 maj 2019, Komiteti Ekzekutiv i Bankës ka marrë vendim për të hequr dorë nga plani për kompleksin e zyrës qendrore në favor të një zgjidhjeje aktuale afatgjatë përmes qiramarjes së një ambienti tjetër. Një vendim i tillë ka rezultuar në transferim të kësaj pasurie në pronë të investuar. Banka ka zgjedhur të mbajë pasurinë e investuar me vlerën e drejtë.

Matja e vlerës së drejtë

Matja e pasurisë së investuar klasifikohet në nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë pasi që të dhënat dhe supozimet e përdorura për të arritur të vlera e drejtë nuk janë të vëzhgueshme. Në mungesë të një tregu aktiv, vlera e drejtë e pasurisë së investuar më 31 dhjetor 2020 është përcaktuar duke përdorur një kombinim të tri metodave: Metoda e krahasimit, Metoda e zhvillimit dhe Metoda e kapitalizimit të të ardhurave. Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2019 është përcaktuar bazuar në Metodën e Krahasimit.

10. Pasuria e investuar(vazhdim)

Teknikat e vlerësimit	Përshkrim i teknikave të vlerësimit
Metoda e krahasimit	Metoda e krahasimit të drejtëpërdrejtë bazohet në krahasimin e çmimeve për pronat e ngjashme në të njëjtin treg me distance më pak se 500m. Çmimet e krahasueshme të shitjes janë rregulluar, kur ka qene e përshtatshme, duke marrë parasysh treguesit e planeve rregullatore, vendndodhjen e pronës, qasjen në pronë dhe infrastrukturën. Çmimi mesatar për m ² bazuar në krahasimin e ofertave me kushte të ngjashme, është rregulluar me faktorin e ofertës minus - 10%.
Metoda e zhvillimit	Metoda e zhvillimit merr parasysh të gjitha zhvillimet dhe kostot e ndërtimit për të arritur përdorimin më të lartë dhe më mire të pasurisë dhe për të përcaktuar vlerën përfundimtare të pasurisë së investuar.
Metoda e kapitalizimit të të ardhurave	Metoda e kapitalizimit të të ardhurave bazohet në kushtet e supozuara sikur pasuria të ishte dhënë me qira. Norma e kapitalizimit, duke marrë parasysh potencialin e kapitalizimit të të ardhurave nga qiraja, natyrën e pronës dhe kushtet e tregut është 8%.

Një zvogëlim ('haircut') prej 20% është aplikuar për të arritur te vlera e menjëhershme.

Një rritje / ulje e çmimit të menjëhershëm të shitjes me +/- 10% do të rezultonte në një rritje / ulje të vlerës së drejtë me 164 mijë Euro.

Vlera e drejtë e pasurisë së investuar të Bankës, kur është njohur fillimisht dhe me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, është përcaktuar në bazë të vlerësimeve të bëra në ato data nga vlerësues të pavarur, të cilët kanë kualifikime përkatëse profesionale, që kanë përvojën më të fundit në vlerësimin e pasurive të ngjashme në Kosovë dhe që nuk janë të lidhur me Bankën.

11. Pasuritë tjera financiare

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Jo-derivativet:</i>		
Tarifat e arkëtueshme të mirëmbajtjes së llogarive dhe kartelave të kreditit	1,306	1,535
Llogaritë e arkëtueshme nga institucionet financiare	2,105	1,940
Pasuritë tjera financiare	73	305
Gjithsej pasuritë tjera financiare (shuma bruto)	3,484	3,780
Lejimet për rënien në vlerë	(281)	(538)
Gjithsej pasuritë tjera financiare	3,203	3,242

Të arkëtueshmet nga institucionet financiare lidhen me tërheqjet ose pagesat e kryera nga kartelat e bankave të tjera nëpërmjet POS-ave ose bankomatëve të Bankës. Banka ka vlerësuar provizione për pasuritë e tjera financiare që janë në vonesë në pagesë mbi 3 muaj (shih shënimin 19). Deri me datën 31 janar 2021, 1,948 mijë Euro të gjithsej pasurive të tjera financiare të regjistruara më 31 dhjetor 2020 janë arkëtuar.

12. Pasuritë tjera

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasuritë e riposeduara	608	450
Shpenzimet e parapaguara	702	157
Të tjera	63	211
Gjithsej pasuritë tjera	1,373	818

Lëvizjet në pasuritë e riposeduara gjatë vitit janë paraqitur më poshtë:

	2020	2019
Më 1 janar	450	1,367
Shtesat	414	264
Shitjet	-	(108)
Rënia në vlerë deri në vlerën neto të realizueshme	(256)	(1,073)
Më 31 dhjetor	608	450

13. Ndërtesat dhe pajisjet

	Tokë	Përmirësime në objektet e marra me qira	Mobilje dhe pajisje	Kompjuter dhe pajisje përcjellëse	Makina dhe pajisje motorike	Gjithsej
Kosto						
Më 1 janar 2019	1,200	4,699	2,155	8,936	890	17,880
Shtesat	-	482	60	292	-	834
Transferi në pasuri të investuar	(1,200)	-	-	-	-	(1,200)
Shitjet	-	(200)	(20)	(527)	-	(747)
Më 31 dhjetor 2019	-	4,981	2,195	8,701	890	16,767
Shtesat	-	83	70	1,511	153	1,817
Shitjet	-	(7)	(170)	(89)	-	(266)
Më 31 dhjetor 2020	-	5,057	2,095	10,123	1,043	18,318
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2019	-	3,587	1,693	6,411	774	12,465
Ngarkesa për vitin	-	400	196	892	40	1,528
Shitjet	-	(196)	(17)	(518)	-	(731)
Më 31 dhjetor 2019	-	3,791	1,872	6,785	814	13,262
Ngarkesa për vitin	-	415	203	1,123	35	1,776
Shitjet	-	-	(180)	(68)	-	(248)
Më 31 dhjetor 2020	-	4,206	1,895	7,840	849	14,790
Vlera bartëse						
Më 31 dhjetor 2019	-	1,190	323	1,916	76	3,505
Më 31 dhjetor 2020	-	851	200	2,283	194	3,528

Toka është blerë me 2013, për qëllime të përdorimit të saj për ndërtimin e një Zyre Qendrore të re të Bankës. Siç shpjegohet në shënimin 10, toka është transferuar në pasuri të investuar për shkak të një ndryshimi në synimin për përdorimin e saj nga Komiteti Ekzekutiv i Bankës.

14. Pasuritë me të drejtë të përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Banka merr me qira ndërtesa të ndryshme për zyrë dhe hapësira për bankomatët e vet. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse prej 6 muaj deri në 5 vjet, por mund të kenë opsione për zgjatjen e qirasë për të njëjtën periudhë kohore të dhënë në marrëveshjen e qirasë.

Pasuritë me të drejtë përdorimi sipas klasës së objektit përkatës analizohen si në vijim:

	Zyret	Hapësirat për ATM	Gjithsej
Vlera bartëse më 1 janar 2019	5,214	210	5,424
Shtesat	102	70	172
Ndërprerjet	(131)	(30)	(161)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(1,116)	(126)	(1,242)
Të tjera	(225)	(17)	(242)
Vlera bartëse në datën 31 dhjetor 2019	3,844	107	3,951
Shtesat	2,051	118	2,169
Ndërprerjet	(1,492)	(2)	(1,494)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(1,119)	(119)	(1,238)
Vlera bartëse në datën 31 dhjetor 2020	3,284	104	3,388

Detyrimet e qirasë të analizuara sipas maturitetit janë si në vijim:

Analiza e maturitetit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Viti 1	1,183	1,337
Viti 2	910	1,134
Viti 3	633	905
Viti 4	355	483
Viti 5	280	206
Vitet tjera	110	-
Gjithsej	3,471	4,065
Analizuar si:		
Afatshkurta	1,183	1,337
Afatgjata	2,288	2,728
Gjithsej	3,471	4,065

Shumat e njohura në fitim dhe humbje	2020	2019
Shpenzimet e zhvlerësimit për pasuritë me të drejtë përdorimi	1,238	1,242
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë	88	121
Shpenzimet për qiratë me afatshkurtëra	110	84
Gjithsej	1,436	1,447

Gjithsejt flukset e parave nga qiratë janë 1,420 mijë (2019: 1,170 mijë). Të gjitha pagesat e qirave janë fikse. Me 31 dhjetor 2020 Banka ka të zotuar 6.4 mijë Euro (2019: 1.6 mijë Euro) për qiratë me afatshkurtëra.

15. Pasuritë e patrupëzuara

	Softueri
Kosto	
Më 1 janar 2019	10,365
Shtesat	1,765
Shitjet	-
Më 31 dhjetor 2019	12,130
Shtesat	1,897
Shitjet	(4)
Më 31 dhjetor 2020	14,023
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2019	8,274
Ngarkesa për vitin	1,698
Shitjet	-
Më 31 dhjetor 2019	9,972
Ngarkesa për vitin	1,720
Shitjet	-
Më 31 dhjetor 2020	11,692
Vlera bartëse	
Më 31 dhjetor 2019	2,158
Më 31 dhjetor 2020	2,331

Të gjitha pasuritë e patrupëzuara janë pasuri të blera dhe amortizohen gjatë jetëgjatësisë së tyre.

16. Detyrime ndaj klientëve

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Depozitat rrjedhëse		
Individuale	352,372	298,349
Personat juridik	139,614	112,802
	491,986	411,151
Depozita me afat		
Individët	51,684	60,189
Personat juridik	17,730	40,923
	69,414	101,112
Gjithsej detyrime ndaj klientëve	561,400	512,263

Më 31 dhjetor 2020 llogaritë e klientëve përfshijnë interesin e përlllogaritur prej 722 mijë Euro (2019: 743 mijë Euro).

Depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse sipas statusit ligjor si proporcion ndaj gjendjes totale janë si më poshtë:

	2020	2019
Individët	72%	70%
Personat juridik	28%	30%
	100%	100%

TEB SH.A.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare - 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)***17. Huamarrjet**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Huamarrjet</i>		
Kreditë	5,143	9,000
Tarifat administrative të shtyra	(27)	(55)
Interesi i përlllogaritur	29	36
Gjithsej huamarrjet	5,145	8,981

	2020	2019
Vlera bartëse më 1 janar	8,981	9,242
Huamarrje të reja	-	2,000
Ripagimi i huamarrjeve	(3,857)	(2,285)
Ndryshimi në tarifën e shtyra	28	30
Ndryshimi në interesin e përlllogaritur	(7)	(6)
Gjithsej huamarrjet	5,145	8,981

Në vitin 2015, Banka ka lidhur marrëveshje huazimi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për një shumë prej 3,000 mijë Euro për t'i mbështetur gratë sipërmarrëse në kontekstin lokal. Kredia është disbursuar në dy këste të ndara (1,000 mijë Euro dhe 2,000 mijë Euro). Kredia ka maturuar në maj 2020.

Në vitin 2016, Banka ka lidhur marrëveshje huazimi me BERZH për një shumë prej 5,000 mijë Euro për t'i mbështetur NVM-të e drejtuara nga gratë sipërmarrëse. Marrëveshja do të maturojë në Maj 2022.

Në vitin 2018, Banka nënshkroi marrëveshje huazimi me BERZH për një shumë prej 5,000 mijë Euro të ndarë në dy këste, kësti A prej 3,000 mijë Euro dhe kësti B në shumë prej 2,000 mijë Euro. Kësti A është disbursuar në shkurt 2018 dhe Kësti B është disbursuar në dhjetor 2019. Qëllimi i këtyre huave është financimi i kredive për efikasitetin energjetik. Dy këstet maturojnë në Janar 2022.

18. Detyrimet tjera financiare

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Transferet e fondeve në tranzit të klientëve	2,111	1,438
Detyrime ndaj furnitorëve	854	916
Bonuset e pagueshme të kartelave të kreditit	664	663
Bonuset e personelit	519	929
Detyrime tjera për klientët për kartelat e kreditit	175	198
Shërbime bankare me SMS	186	124
Gjithsej detyrimet tjera financiare	4,509	4,268

Bonuset e kartelave të kreditit të pagueshme përfaqësojnë detyrimet ndaj klientëve për transaksionet e realizuara me kartela të kreditit në rrjetin e pikave shitëse të Bankës, përkatësisht për çdo blerje të bërë përmes rrjetit të tregtarëve të TEB, klientët kanë të drejtën e shpërblimeve (starpoints) të cilat mund të përdoren për blerje të mëtejshme nga klientët tek çdo tregtar ku janë instaluar pikat e shitjes së TEB.

19. Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat e tjera

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Provizionet për:</i>		
Taksat	546	-
Zotimet e pashfrytëzuara	386	409
Rastet ligjore	245	222
Pushimet e pashfrytëzuara	34	31
Garancitë	26	29
Rënia në vlerë e letrave me vlerë	6	-
Tarifa e mirëmbajtjes	-	11
Të tjera	288	302
Gjithsej provizionet për detyrimet dhe ngarkesat e tjera	1,531	1,004

20. Detyrimet tjera

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatimi i mbajtur në burim	43	35
Sigurimet shoqërore	60	93
Tatimi në të ardhurat personale	39	77
TVSH-ja dhe tatimet e tjera	105	58
Të tjera	201	180
Gjithsej detyrimet tjera	448	443

21. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i paguar i Bankës më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përfshin 2,400 mijë aksione të zakonshme me vlerë nominale 10 Euro për aksion.

Aksionari	Më 31 dhjetor 2020		Më 31 dhjetor 2019	
	Përqindja e pronësisë	Vlera	Përqindja e pronësisë	Vlera
TEB Holding A.S.	100%	24,000	100%	24,000
Gjithsej	100%	24,000	100%	24,000

Aksionet janë aksione të zakonshme për nga natyra dhe nuk kanë preferenca as kufizime të lidhura për to. Të gjitha aksionet janë të paguara plotësisht. Mbajtësit e aksioneve të zakonshme kanë të drejtën e një vote për çdo aksion të zakonshëm që mbajnë. Në rastin e TEB SH.A. të gjitha aksionet i përkasin një aksionari të vetëm, përkatësisht TEB Holding A.S.

22. Të ardhurat nga interesi

	2020	2019
Të ardhurat nga interesi të llogaritura duke përdorur meto-		
dën e interesit efektiv		
Kredi dhe paradhënie për klientë me KA	28,729	30,023
Investimet në letrat me vlerë të borxhit me VDPATGJ	252	131
Kredi dhe paradhënie për bankat me KA	116	496
Gjithsej të ardhurat nga interesi	29,097	30,650

23. Shpenzimet e interesit

	2020	2019
Depozitat me afat	754	1,165
Llogaritë e kursimit	328	126
Huamarrjet	176	235
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë	88	121
Gjithsej shpenzimet e interesit	1,346	1,647

Normat e interesit për depozita me afat dallojnë varësisht nga maturiteti i depozitave. Normat vjetore të interesit për depozitat me afat me klientët në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- 2020 – max N/I 2.8%, min N/I 0.0%
- 2019 – max N/I 2.0%, min N/I 0.0%

24. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

	2020	2019
Kartelat e kreditit	6,398	6,883
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	2,285	2,009
Pagesat ndërkombëtare	1,520	1,349
Shërbimet bankare me SMS	304	285
Pagesat vendore	174	220
Garancitë dhe letër kreditë	131	133
Tarifa të tjera	348	259
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	11,160	11,138

Tarifat e mirëmbajtjes për kredit kartelat dhe llogaritë, dhe tarifat për garancionet dhe letrat e kreditit janë njohur si të ardhura kur obligimet e performancës janë përmbushur me kalimin e kohës (të përlllogaritura përgjatë kohës së ofrimit të shërbimit). Bazuar në kushtet kontraktuale Banka ka të drejtë në pagesa për performancën e kryer në fund të çdo muaji për tarifat e mirëmbajtjes së llogarive dhe në fund të vitit për tarifat e mirëmbajtjes së kredit kartelave. Lidhur me komisionet për garancionet dhe letrat e kreditit, klientët mund të zgjedhin për të paguar komisionin në fund të çdo muaji, në fund të tremujorit apo të parapaguajnë. Parapagimet regjistrohen si të ardhura të pafituara dhe regjistrohen si të ardhura në bazë akruale si referencë ndaj përmbushjes së shërbimit. Në fund të vitit 31 dhjetor 2020 të ardhurat e pafituara nga garancionet dhe letrat e kreditit janë në shumën 19.6 mijë Euro (2019:16.4 mijë Euro).

Për fund vitin 31 dhjetor 2020, të ardhurat nga tarifat dhe komisionet prej klientëve individual përfaqësojnë përafërsisht 46% të gjithsej të ardhurave nga tarifat dhe komisionet ndërsa tarifat dhe komisionet nga entitetet ligjore përfaqësojnë përafërsisht 54% të të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

25. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve

	2020	2019
Kartelat e kreditit	2,445	2,539
Tarifat e Bankës Qendrore	418	407
Pagesat ndërkombëtare	445	337
Pagesat vendore	357	250
Fshirjet e tarifave të mirëmbajtjes të përlllogaritura	286	497
Tarifa të tjera	395	233
Garancitë dhe letër kreditë	12	14
Gjithsej shpenzimet për tarifat dhe komisionet	4,358	4,277

26. Provizionet dhe rëniet tjera në vlerë

	2020	2019
<i>Rëniet e tjera në vlerë dhe Provizionet (ngarkesat)/lirimet:</i>		
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	(7)	(7)
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	(135)	(32)
Investimet nëletra me vlera	(3)	-
Rastet dhe kontestet ligjore	(35)	(161)
Të arkëtueshmet dhe pasuritë e tjera	466	(473)
Komisionet e kartelave të kreditit	12	(118)
Pushimi vjetor i pashfrytëzuar	(3)	(2)
Provizione të ndryshme për kreditë	-	(301)
Rënia në vlerë për pronën e riposeduar	(256)	(1,071)
Taksat	(546)	-
Lirimi i provizioneve për pasuritë e tjera financiare (shënimi 11)	(13)	13
Gjithsej provizionet dhe rëniet tjera në vlerë	(520)	(2,152)

27. Shpenzimet e personelit

	2020	2019
Shpenzimet e pagave	6,471	6,584
Bonuset	696	1,346
Kontributet e detyrueshme pensionale	338	354
Sigurimi shëndetësor	157	154
Trajnimi i stafit	49	52
Shpenzime të tjera	8	21
Gjithsej shpenzimet e personelit	7,719	8,511

28. Shpenzimet administrative

	2020	2019
Shpenzime të tjera	1,006	677
Telekomunikimi	611	633
Siguria dhe sigurimi	565	787
Tarifat e mirëmbajtjes së softuerit	560	348
Riparime dhe mirëmbajtje	455	410
Furnizime të zyrës	362	295
Marketingu dhe sponsorizimi	345	551
Tarifat për konsulencë dhe tarifat profesionale	341	347
Udhëtimi	233	386
Shërbimet komunale	276	251
Shpenzimet e shërbimeve për kartelat e kreditit	174	175
Shpenzimet e pastrimit	141	144
Tarifat ligjore, të ekzekutimit të kolateralit dhe të auditimit	80	276
Tatimet e biznesit dhe licencat	139	164
Përfaqësimi	127	194
Shpenzimet e qirave operative për objektet	110	84
Shpenzimet e tjera operative	6	288
Gjithsej shpenzimet administrative	5,531	6,010

Si një përjashtim i lejuar nga kërkesat e SNRF 16, Banka regjistron qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të vogël duke njohur pagesat e qirasë si shpenzim operativ në bazë lineare.

29. Tatimi në të ardhura**a) Komponentët e shpenzimit të tatimit mbi të ardhura**

	2020	2019
Shpenzimi aktual i tatimit	997	2,066
Kreditimi/ (shpenzimi) tatimor i shtyrë	254	222
Gjithsej tatimi në të ardhura	1,251	2,288

b) Shumat e njohura në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse

	2020			2019		
	Para tati- mit	Shpenzimi i tatimit	Neto nga tatimi	Para tati- mit	Shpenzimi i tatimit	Neto nga tatimi
Investime në letra me vlerë	61	(2)	59	61	(6)	55
Pasuri e investuar	-	-	-	390	(39)	351

c) Barazimi në mes të shpenzimeve tatimore dhe fitimit ose humbjes shumëzuar me normën e aplikueshme tatimore

Në vijim është përshkruar në detaje llogaritja e normës tatimore efektive dhe barazimi i shpenzimit aktual të tatimit mbi të ardhura:

	2020	2019
Fitimi para tatimit	14,628	17,761
Shpenzimi i tatimit me normën ligjore prej 10%	1,463	1,776
Efekti tatimor i zërave që nuk janë të zbritshme ose të vlerësueshme për qëllime tatimore:		
- Shpenzime e pa-zbritshme	152	525
- Të ardhurat e pa-tatueshme	(23)	(13)
- Rregullimi i tatimit në të ardhurat e korporatave	(341)	-
Shpenzimi i tatimit në të ardhura për vitin	1,251	2,288

Tatimi aktual në të ardhura llogaritet në bazë të rregulloreve të zbatueshme në Kosovë për tatimin në të ardhura, duke i përdorur normat e tatimit në fuqi në ditën e raportimit. Norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 10% (2019: 10%).

29. Tatimi në të ardhura (vazhdim)**d) Lëvizja në gjendjet tatimore të shtyra**

Diferencat ndërmjet pasqyrave financiare sipas SNRF-ve dhe rregulloreve tatimore të Kosovës shkaktojnë disa diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të kredive dhe paradhënies për klientë për qëllime të raportimit sipas SNRF-ve dhe për qëllime të tatimit. Efekti tatimor i këtyre diferencave të përkohshme llogaritet në normën e tatimit në fuqi prej 10% (2019: 10%).

Efekti tatimor i lëvizjeve në diferencat e përkohshme për vitin 2020 është dhënë më poshtë në detaje.

	1 janar 2020	Ngarkuar/ (kredituar) në fitim ose hum- bje	Ngarkuar / (kredi- tuar) direkt në të ardhurat e tjera gjithë-përfshirëse	31 dhjetor 2020
Efekti tatimor i diferencave të përkohshme të zbritshme/(të tatueshme)				
Tatimi i shtyrë për impaktin fillestar të SNRF 9	583	-	-	583
Provizioni për rënie në vlerë të kredive	(336)	(247)	-	(583)
Detyrimet e qirasë	406	(59)	-	347
Vlerësimi i drejtë i pasurisë së investuar	(39)	(6)	-	(45)
Pasuritë me të drejtë përdorimi	(395)	56	-	(339)
Vlerësimi i drejtë i investimeve në letrat me vlerë të borxhit	(7)	-	-	(7)
Pasuria neto tatimore e shtyrë / (detyrimi)	212	(256)	-	(44)
Pasuri të njohura tatimore të shtyera	479	-	-	479
Detyrime të njohura tatimore të shtyera	(267)	(256)	-	(523)
Pasuria (detyrimet) neto tatimore e shtyrë	212	(256)	-	(44)

29. Tatimi në të ardhura (vazhdim)

Efekti tatimor i lëvizjeve në diferencat e përkohshme për vitin 2019 është dhënë më poshtë në detaje.

	31 dhje- tor 2018	Miratimi i standardit të ri	1 janar 2019 (ri- paraqitur)	Ngarkuar/ (kredituar) në fitim ose hum- bje	Ngarkuar / (kredituar) direkt në të ardhurat e tjera gjithë- përfshirëse	31 dhje- tor 2019
Efekti tatimor i diferencave të përkohshme të zbritshme/(të tatueshme)						
Tatimi i shtyrë për impaktin fillestar të SNRF 9	583	-	583	-	-	583
Provizioni për rënie në vlerë të kredive	(114)		(114)	(222)	-	(336)
Detyrimet e qirasë	-	553	553	(147)	-	406
Vlerësimi i drejtë i pasurisë së investuar	-	-	-		(39)	(39)
Pasuritë me të drejtë përdorimi	-	(542)	(542)	147	-	(395)
Vlerësimi i drejtë i investimeve në letrat me vlerë të borxhit	(1)	-	(1)		(6)	(7)
Pasuria neto tatimore e shtyrë / (detyrimi)	-	-	479	(222)	(45)	212
Pasuri të njohura tatimore të shtyra	-	-	479	-	-	479
Detyrime të njohura tatimore të shtyra	-	-	-	(222)	(45)	(267)
Pasuria (detyrimet) neto tatimore e shtyrë	-	-	479	(222)	(45)	212

30. Shpalosjet e palëve të lidhura

Palët përgjithësisht konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Kur merret parasysh çdo marrëdhënie e mundshme ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore. Banka kontrollohet nga TEB Holding A.S., e inkuorporuar në Turqi (Kompania Mëmë), e cila ka në pronësi 100% të aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 (shih Shënimin 1). Tabela në vijim përmbledh transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe bilanci më 31 dhjetor 2020 dhe shpenzimet e ndërlidhura për vitin e përfunduar me këtë datë. Kreditë dhe paradhëniet për bankat e palëve të lidhura janë të gjitha llogari rrjedhëse nostro që nuk kanë normë interesi. Shpenzimet e komisioneve përbëhen nga komisionet dhe tarifat e bankave korrespondente ndërsa shpenzimet operative janë shpenzime të konsulencës me palët e lidhura. Garancionet në fund të vitit përbëhen nga garancionet e lëshuara nga Banka me konfirmimin e bankave të Grupit. Të gjitha transaksionet janë kryer me kushte të tregut.

Më 31 dhjetor 2020, balancat e palët e ndërlidhura janë si më poshtë:

	Kompania mëmë kryesore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Menaxhmenti kryesor
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	7	-	218	-
Kredi dhe paradhëniet për klientë	-	-	-	118
Detyrimet e tjera financiare	82	68	175	-

Të ardhurat dhe shpenzimet me palët e ndërlidhura për vitin 2020 janë si më poshtë:

	Kompania mëmë kryesore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Të ardhurat nga interesi	-	-	1
Shpenzimet e komisionit	14	-	104
Shpenzimet operative	-	255	-

Më 31 dhjetor 2020, të drejtat dhe obligimet tjera me palët e ndërlidhura janë si më poshtë:

	Kompania mëmë kryesore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Garancionet e lëshuara në fund të vitit	698	-	3,575

Më 31 dhjetor 2019, balancat e palët e ndërlidhura janë si më poshtë:

	Kompania mëmë kryesore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Menaxhmenti kryesor
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	12	-	509	-
Kredi dhe paradhëniet për klientë	-	-	-	105
Detyrimet e tjera financiare	6	-	109	-

30. Shpalosjet e palëve të lidhura (vazhdim)

Të ardhurat dhe shpenzimet me palët e ndërlidhura për vitin 2019 janë si më poshtë:

	Kompania mëmë krye- sore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Të ardhurat nga interesi	-	-	3
Shpenzimet e komisionit	37	-	83
Shpenzimet operative	-	135	-

Më 31 dhjetor 2019, të drejtat dhe obligimet tjera me palët e ndërlidhura janë si më poshtë:

	Kompania mëmë kryesore	Kompania mëmë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Garancionet e lëshuara në fund të vitit	507	-	3,230

Kompenzimet e menaxhmentit kryesor janë paraqitur më poshtë:

	2020	2019
Pagat	357	296
Bonuset	124	254
Kontributet pensionale	18	25
Gjithsej kompensimet për menaxhmentin kryesor	499	575

31. Zotimet dhe kontigjencat**Garancitë dhe letër kreditë**

Zotimet e lidhura me kreditë. Qëllimi primar i këtyre instrumenteve është të sigurojë që fondet janë në dispozicion të një klienti sipas nevojës. Garancitë dhe letërkreditë, të cilat paraqesin siguri të pakthyeshme se Banka do të bëjë pagesat në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palëve të treta, kanë të njëjtin rrezik kreditor si kreditë. Letrat kreditore dokumentare dhe komerciale, të cilat janë zotime të shkruara nga Banka në emër të një klienti që autorizon një palë të tretë për të tërhequr këto zotime në Bankë deri në një shumë të përcaktuar nën kushte specifike, janë të kolateralizuara nga dërgesat përkatëse të mallrave për të cilat ato janë të lidhura ose depozita në para dhe, për rrjedhojë, kanë më pak rrezik sesa një huamarrje direkte.

Zotimet për ta dhënë kredi paraqesin pjesë të papërdorura të autorizimeve për të dhënë kredi në formën e huamarrjes, garancive ose letërkredive. Sa i përket rrezikut kreditor për zotimet për ta dhënë kredi, Banka mund të ekspozohet ndaj humbjes në një shumë të barabartë me totalin e zotimeve të papërdorura, nëse shumat e papërdorura do të përdoren. Megjithatë, shumat e mundshme e humbjes është më pak se totali i zotimeve të papërdorura sepse shumica e zotimeve për të dhënë kredi varen nga ajo nëse klientët mbajnë standardet specifike për kredi.

Banka monitoron afatin e maturimit të zotimeve për kredi, sepse zotimet afatgjata në përgjithësi kanë një shkallë më të madhe të rrezikut kreditor se zotimet afatshkurtra.

31. Zotimet dhe kontigjencat (vazhdim)

Shuma e grumbulluar e papaguar e garancive dhe letër kredive të lëshuara nga Banka, është si vijon:

	2020	2019
Garancitë financiare	6,828	6,618
Letër kreditë	2,025	1,640
Garancitë e tjera	86	57
Gjithsej	8,939	8,315
Zotimet e papërdorura për kreditë revolvuese	88,136	83,110
Gjithsej zotimet kreditore	97,075	91,425
HPK për garanci	(26)	(27)
HPK për kreditë revolvuese	(386)	(410)
Gjithsej zotimet kreditore, neto nga HPK	96,663	90,988

Zotimet sipas cilësisë së kredisë bazuar në klasifikimet e rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Garancitë financiare	6,828	-	-	6,828
Letër kreditë	2,025	-	-	2,025
Garancitë e tjera	86	-	-	86
Gjithsej garancitë dhe letër kreditë	8,939	-	-	8,939
Zotimet kreditore ende të padisbursuara	85,932	2,204		88,136
Gjithsej zotimet kreditore	94,871	2,204	-	97,075
Minus: Rënia në vlerë për garancitë dhe letërkreditë	(26)	-	-	(26)
Minus: Rënia në vlerë e zotimeve kreditore	(342)	(44)	-	(386)
Gjithsej zotimet	94,503	2,160	-	96,663

Zotimet sipas cilësisë së kredisë bazuar në klasifikimet e rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për RrKRrK)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e dëmtuara)	Gjithsej
Garancitë financiare	6,582	36	-	6,618
Letër kreditë	1,640	-	-	1,640
Garancitë e tjera	51	6	-	57
Gjithsej garancitë dhe letër kreditë	8,273	42	-	8,315
Zotimet kreditore ende të padisbursuara	77,471	5,639	-	83,110
Gjithsej zotimet kreditore	85,744	5,681	-	91,425
Minus: Rënia në vlerë për garancitë dhe letërkreditë	(27)	-	-	(27)
Minus: Rënia në vlerë e zotimeve kreditore	(352)	(58)	-	(410)
Gjithsej zotimet	85,365	5,623	-	90,988

Banka i llogarit lejimet për humbjet e pritura kreditore dhe humbjet e pritura përgjatë jetëgjatësisë për garancitë dhe letërkreditë për ekspozimet bazuar në klasifikimin në fazë. Në rastet kur zbatohet një vlerësim individual, parashikimi specifik për rënien në vlerë konsiderohet për rënien në vlerë finale. Referojuni shpalosjes së rënies në vlerë të kredive dhe paradhënies për klientët për normat e rënies në vlerë.

31. Zotimet dhe kontigjencat (vazhdim)**Rastet ligjore**

Në rrjedhën normale të biznesit Banka përballet me kërkesa ligjore. Menaxhmenti i Bankës beson se mundësia e një rrjedhjeje të përfitimeve ekonomike në lidhje me pretendimet ligjore të pazgjdhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është e largët, me përjashtim të provizioneve të ngarkuara siç tregohet në shënimin 19 – Provizionet për detyrimet dhe shpenzimet.

32. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Bankës me rastin e menaxhimit të kapitalit janë:

- të jetë në përputhje me kërkesat për kapital të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK);
- të ruajë aftësinë e Bankës për ta vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe për të vazhduar të ofrojë kthime për aksionarin; dhe
- të mbajë një bazë të fortë kapitale për ta mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Adekuatshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen rregullisht nga menaxhmenti i Bankës që shfrytëzon teknika në bazë të udhëzimeve të BQK-së. Informatat e nevojshme i ofrohen BQK-së në baza tremujore.

Pasuritë klasifikohen duke përdorur një rangim prej pesë kategorive të rrezikut, duke pasqyruar një vlerësim të rrezikut kreditor, të tregut dhe rreziqeve të tjera që lidhen me çdo pasuri dhe ekspozim jashtë bilancor.

Rregullorja e re për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave dhe Rregullorja për treguesin e leverazhit janë miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe janë në fuqi duke filluar nga 1 janari 2020. Rregulloret kërkojnë që bankat të mbajnë një minimum të kapitalit rregullator prej 7,000 mijë Euro, të mbajnë kapital të klasës së parë së paku 9.0% të mjeteve të peshuara me rrezik (2019 rregullorja e vjetër: 8%), të mbajnë gjithsej kapital së paku 12% të mjeteve të peshuara me rrezik (2019 rregullorja e vjetër: 12%) dhe të mbajnë treguesin e leverazhit së paku 3% (2019 rregullorja e vjetër: 7%).

Me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 Banka është në përputhje me të gjitha normat rregullatore: Kapitali i klasës së parë më 31 dhjetor 2020 është 16.14% (2019: 14.67%), gjithsej kapitali rregullator është 17.15% (2019: 14.79%), dhe treguesi i leverazhit është 10.17% (2019: 12.28%).

Banka ishte në përputhje me kërkesat rregullative në datat e raportimit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

32. Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)***Treguesit minimal të kapitalit të bazuar në rrezik***

Nivelet e kapitalit, mjetet e peshuara me rrezik dhe raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas rregulloreve të BQK-së më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si në vijim:

	2020	2019
<i>Kapitali i klasës së parë</i>		
Kapitali aksionar	24,000	24,000
Fitimet e mbajtura sipas raportimit për Bankën Qendrore të Kosovës	49,989	50,093
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar (dhe rezervat tjera)	(2,043)	-
Minus: Pasuritë e patrupëzuara	(2,331)	(2,158)
Minus: Kreditë për personat e lidhur me Bankën	(501)	(545)
Gjithsej kapitali i kualifikuar i klasës së parë	69,114	71,390
Provizionet për humbjet nga kreditë (të kufizuara në 1.25% të mjeteve të peshuara me rrezik)	4,284	590
Gjithsej kapitali kualifikues i klasës së dytë	4,284	590
Gjithsej kapitali rregullator	73,398	71,980
Mjetet e peshuara me rrezik:		
Në bilancin e gjendjes	373,669	435,300
Jashtë bilancit të gjendjes	8,509	8,315
Mjetet me rrezik për rrezikun operacional	42,967	42,967
Rreziku i tregut	2,959	-
Gjithsej mjetet e peshuara me rrezik	428,104	486,582
Raporti i kapitali të klasës së parë ndaj mjeteve të peshuara me rrezik	16.14%	14.67%
Raporti i gjithsej kapitali rregullator ndaj mjeteve të peshuara me rrezik	17.15%	14.79%
Treguesi i leverazhit (raportimi rregullator)	10.17%	12.28%

Në përputhje me rregulloren e BQK-së për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, duke filluar nga 1 janari 2019 “SNRF 9 – Instrumentet Financiare” është i aplikueshëm poashtu për pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare.

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar (dhe rezervat tjera) më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	2020
Ndikimi fillestar i aplikimit të SNRF 9	(2,457)
Vlera e drejtë e pasurisë së investuar (e njohur përmes AGJT)	351
Vlera e drejtë e investimeve në letra me vlerë (e njohur përmes AGJT)	63
Gjithsej	(2,043)

33. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Bankës kryhet në lidhje me rreziqet financiare dhe rreziqet operacionale. Rreziku financiar përfshin rrezikun kreditor, rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e valutës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqet e tjera të çmimeve) dhe rrezikun e likuiditetit. Funksioni primar i menaxhimit të rrezikut financiar është vendosja e limiteve të rrezikut dhe sigurimi që çdo ekspozim ndaj rrezikut të qëndrojë brenda këtyre kufijve të përcaktuara nga organi rregullator dhe nga bordi i drejtorëve të Bankës. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe politikave dhe procedurave në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore.

Rreziku i tregut

Aktivitetet e Bankës janë deri diku të ekspozuara ndaj humbjeve të mundshme si rezultat i ekspozimit të instrumenteve të saj financiare ndaj rrezikut të normës së interesit ose të rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare. Shumica e transaksioneve të Bankës janë në valutën vendase dhe ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor është i kufizuar.

Rreziku i valutave të huaja

Politika për menaxhimin e rrezikut nga valutat e huaja në TEB Sh.a. përcakton metodat për menaxhimin e rrezikut nga valutat e huaja në Bankë. Banka menaxhon rrezikun e këmbimit valutor nëpërmjet menaxhimit të strukturës valutore të pasurive dhe detyrimeve të saj. Rreziku i këmbimit valutor menaxhohet dhe udhëhiqet sipas politikave të grupit TEB. TEB Sh.A. vazhdimisht monitoron lëvizjet në normën e këmbimit dhe në tregje të valutave të huaja dhe përcakton pozitën e vet valutore në baza ditore.

Për çdo përjashtim nga kjo politikë duhet të merret miratimi i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.A. Banka nuk mban valuta për qëllime spekulative. Prapëseprapë derivativat e këmbimit mund të shfrytëzohen për qëllime të mbrojtjes për mbylljen e pozicioneve të caktuara, me ç'rast ato monitorohen për së afërmi si në nivel lokal ashtu edhe grupor. Banka ndërmerr transaksione në Euro dhe në valuta të huaja.

Banka nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të rëndësishme të këmbimit të ardhshëm të derivativëve ("forward") dhe nuk ka asnjë derivativ të përfshirë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Megenëse Banka i paraqet pasqyrat e saja financiare në Euro, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet në kurset e këmbimit midis Euros dhe valutave të tjera.

Ekspozimet transaksionale të Bankës mundësojnë fitime dhe humbje nga valutat e huaja që njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përfshijnë pasuritë dhe detyrimet monetare të Bankës që nuk shprehen në valutën funksionale të Bankës.

Analiza e ndjeshmërisë së valutës së huaj

Banka është kryesisht e ekspozuar ndaj dollarit amerikan (USD) dhe frangut zviceran (CHF). Tabela e mëposhtme jep në detaje ndjeshmërinë e Bankës ndaj rritjes përkatëse dhe rënies në vlerën e Euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur në analizën e ndjeshmërisë së normës përfaqëson vlerësimin e menaxhmentit lidhur me ndryshimin e mundshëm të arsyeshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj.

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetarë të hapur në valutë të huaj dhe korrigjon përkthimin e tyre në fund të periudhës për ndryshimin përkatës në normat valutore. Banka ka aplikuar një rritje ose ulje prej 10% në normat aktuale të këmbimit valutor. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe kapitalin tjetër ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

	2020		2019	
	+10% Euro	-10% Euro	+10% Euro	-10% Euro
Pasuritë:				
Ndikimi në parandë e gatshme dhe detyrimet nga bankat	(2,459)	3,006	(2,104)	2,571
Detyrimet:				
Ndikimi në detyrimet ndaj bankave dhe klientëve	2,447	(2,991)	2,090	(2,554)
Ndikimi neto në fitim ose humbje dhe kapital	(12)	15	(14)	17

Tabela në vijim përmbledh pozicionin valutor të Bankës më 31 dhjetor 2020:

	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	122,907	454	6,433	1,400	131,194
Kreditë dhe parandëniet për bankat	56,003	18,679	-	-	74,682
Neto kreditë dhe parandëniet për klientët	414,694	-	-	-	414,694
<i>Kreditë për individë</i>	223,642	-	-	-	223,642
<i>Kreditë për entitete ligjore</i>	199,716	-	-	-	199,716
<i>Kreditë e rëna në vlerë</i>	(8,664)	-	-	-	(8,664)
Investimet në letrat me vlerë	25,928	-	-	-	25,928
Pasuritë tjera financiare	3,192	6	1	4	3,203
Gjithsej pasuritë	622,724	19,139	6,434	1,404	649,701
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj klientëve	534,483	19,127	6,400	1,390	561,400
Huamarrjet	5,145	-	-	-	5,145
Detyrimet e qirasë	3,471	-	-	-	3,471
Detyrimet e tjera financiare	4,509	-	-	-	4,509
Gjithsej detyrimet	547,608	19,127	6,400	1,390	574,525
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2020	75,116	12	34	14	75,176

Tabela në vijim përmbledh pozicionin valutor të bankës më 31 dhjetor 2019:

	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	101,197	1,987	6,853	1,548	111,585
Kreditë dhe parandëniet për bankat	52,534	12,724	-	-	65,258
Neto kreditë dhe parandëniet për klientët	397,311	-	-	-	397,311
<i>Kreditë për individë</i>	215,706	-	-	-	215,706
<i>Kreditë për entitete ligjore</i>	189,169	-	-	-	189,169
<i>Kreditë e rëna në vlerë</i>	(7,564)	-	-	-	(7,564)
Investimet në letrat me vlerë	14,167	-	-	-	14,167
Pasuritë tjera financiare	3,231	7	3	1	3,242
Gjithsej pasuritë	568,440	14,718	6,856	1,549	591,563
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj klientëve	489,283	14,632	6,809	1,539	512,263
Huamarrjet	8,981	-	-	-	8,981
Detyrimet e qirasë	4,065	-	-	-	4,065
Detyrimet e tjera financiare	4,263	5	-	-	4,268
Gjithsej detyrimet	506,592	14,637	6,809	1,539	529,577
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2019	61,848	81	47	10	61,986

Bazuar në politikat e Bankës, pozicionet valutore të hapura individuale nuk duhet të jenë mbi 5% të kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimi total në të gjitha valutat nuk duhet të jenë mbi 10% të kapitalit të klasit të parë në asnjë moment të caktuar kohor, ndërkohë që sipas kërkesave të BQK-së, pozicioni valutor i hapur për çdo valutë nuk duhet të kalojë 15% të kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimi total nuk duhet të kalojë 30% të kapitalit të klasit të parë.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 Banka ka qenë në pajtueshmëri me këto raporte.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Kurset e këmbimit të aplikuara për valutat kryesore ndaj euros ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Dollari amerikan (USD)	1.2271	1.1234
Franga zvicerane (CHF)	1.0802	1.0854
Funta britanike (GBP)	0.8990	0.8508

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku se vlera e instrumentit financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe rreziku se maturimet e pasurive që bartin interes ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve që bartin interes të përdorura për t'i financuar ato pasuri (rreziku i ripërcaktimit të çmimit). Pra, koha për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Rreziku i normës së interesit ndaj të cilit është e ekspozuar Banka buron nga pasuritë dhe detyrimet e saj financiare që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit (NI). Rreziku i normës së interesit (RNI) mund të lindë në rritjen e normës së interesit të detyrimeve dhe si rezultat mund të shkaktojë kosto më të lartë të marrjes së fondeve, ndërsa në anën e pasurive, nëse ulet norma e interesit, kjo mund të ndikojë në fitimet e Bankës. Në të dy skenarët, analiza e hendeikut të kohëzgjatjes është vendimtare për të identifikuar ndjeshmërinë e NI. Analiza e hendeikut të kohëzgjatjes është një metodologji e thjeshtë e RNI që ofron një mënyrë të lehtë për të identifikuar boshllëqet e rivlerësimit për monitorimin e rrezikut të normës së interesit që rrjedh nga mospërputhja e maturitetit në bilanc. Analiza e hendeikut ndihmon në identifikimin e mospërputhjeve të maturitetit dhe rivendosjes së çmimit ndërmjet pasurive, detyrimeve dhe instrumenteve jashtë bilancit të gjendjes. Analizat e hendeqeve i ndajnë pasuritë e ndjeshme ndaj normës së interesit (PNNI), detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit (DNNI) dhe instrumentet jashtë bilancit të gjendjes sipas karakteristikave të tyre të ripërcaktimit të çmimit. Për qëllime të likuiditetit, përdoret data e maturimit, ndërsa për hendeqet e normave të interesit data e ripërcaktimit të çmimit është e rëndësishme.

Për më tepër, departamenti i menaxhimit të rrezikut monitoron ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit duke përdorur metodologjinë e analizës së hendeikut të normës së interesit e cila bazohet në supozimet e brendshme me kufijtë e përafërt të caktuar për maturime të ndryshme.

Qëllimi i politikës, që është e miratuar nga Bordi Drejtues (BD), është menaxhimi i ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit dhe kufizimi i humbjeve të mundshme, si rezultat i modifikimit të niveleve të normave të interesit në treg dhe efektit të këtyre ndryshimeve në rezultatet e biznesit dhe vlerën e tregut të kapitalit të Bankës.

Politikat e rrezikut të normës së interesit janë aprovuar nga BD dhe rishikohen në baza të rregullta, ndërsa menaxhmenti i lartë është përgjegjës për të siguruar që politikat dhe procedurat e miratuara nga BD të ekzekutohen në mënyrë të përshtatshme. Politika e tillë e menaxhimit të rrezikut e miratuar nga BD, përcakton metodën e identifikimit, matjes, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut në rast të modifikimit të normës së interesit.

Të gjitha instrumentet dhe pozicionet të cilat janë të ndjeshme ndaj rrezikut të normës së interesit klasifikohen në librin bankar. Pozicionet vrojtohen në pajtim me këto segmente:

- Pozicionet e ndjeshme në normë të interesit në valutën Euro.
- Pozicionet e ndjeshme në normë të interesit në valutat e tjera (vlera totale dhe sipas secilës valutë).

Menaxhmenti beson se Banka nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në instrumentet e saj financiare, përveç huamarrjeve të cilat janë me norma të ndryshueshme të interesit. Kreditë dhe depozitat kanë norma fikse të interesit.

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit plotësohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e të ardhurave bankare neto të bankës dhe kapitalit ndaj skenarëve të ndryshëm të luhatjes së normës së interesit. Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në datën e raportimit. Analiza parasheh një rritje paralele të normave të interesit me 100 pikë bazë ($\pm 1\%$) në nivelin e të ardhurave bankare neto për një periudhë dyvjeçare.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rezultatet e paraqitura më poshtë paraqesin ndryshimet në fitim ose humbje dhe kapital, të cilat do të ndodhnin nëse normat e interesit do të rriten ose ulen me 100 pikë bazë brenda një dhe dy viteve. Ndryshimi në të ardhurat bankare neto të parashikuara njëvjeçare të Bankës duhet të jetë +/- 8% e të ardhurave neto të planifikuara bankare, ndërkohë që ndryshimi në të ardhurat e parashikuara dyvjeçare të interesit neto duhet të jetë +/- 5% nga të ardhurat neto bankare të buxhetuara.

Analiza e ndjeshmërisë së fitimit ose humbjes dhe kapitalit ndaj ndryshimeve në normat e interesit është si vijon:

Ndjeshmëria e fitimit ose humbjes	2020	2019
Rritja në pikë bazë +100 pikë bazë zhvendosje paralele	338	329
Rënia në pikë bazë -100 pikë bazë zhvendosje paralele	(566)	(645)

Pasuritë dhe detyrimet financiare në bazë të datës së ripërcaktimit të normës së interesit dhe maturimit, cilado që është datë më e hershme, janë paraqitur më poshtë:

	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite	Gjithsej
31 dhjetor 2020						
Pasuritë financiare						
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	131,194	-	-	-	-	131,194
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	74,682	-	-	-	-	74,682
Kreditë për klientët	35,305	5,690	42,481	245,874	85,344	414,694
Investimet në letrat me vlerë borxhi	-	50	7,218	18,660	-	25,928
Pasuritë tjera financiare	3,203	-	-	-	-	3,203
Gjithsej pasuritë financiare	244,384	5,740	49,699	264,534	85,344	649,701
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj klientëve	495,295	5,297	29,863	28,453	2,492	561,400
Huamarrjet	1,001	-	2,430	1,714	-	5,145
Detyrimet e qirasë	-	25.58	2,984	461	-	3,471
Detyrimet e tjera financiare	4,509	-	-	-	-	4,509
Gjithsej detyrime financiare	500,805	5,323	35,277	30,628	2,492	574,525
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj normës së interesit	(256,421)	417	14,422	233,906	82,852	75,176
	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite	Gjithsej
31 dhjetor 2019						
Pasuritë financiare						
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	111,585	-	-	-	-	111,585
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	65,258	-	-	-	-	65,258
Kreditë për klientët	40,754	3,917	42,623	234,213	75,804	397,311
Investimet në letrat me vlerë borxhi	1,200	500	2,420	10,047	-	14,167
Pasuritë tjera financiare	3,242	-	-	-	-	3,242
Gjithsej pasuritë financiare	222,039	4,417	45,043	244,260	75,804	591,563
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj klientëve	414,820	6,727	54,152	36,338	226	512,263
Huamarrjet	-	-	428	8,553	-	8,981
Detyrimet e qirasë	-	1	84	3,455	525	4,065
Detyrimet e tjera financiare	4,268	-	-	-	-	4,268
Gjithsej detyrime financiare	419,088	6,728	54,664	48,346	751	529,577
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj normës së interesit	(197,049)	(2,311)	(9,621)	195,914	75,053	61,986

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Rreziku kreditor**

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saj të kreditimit dhe në rastet kur ajo vepron si ndërmjetëse në emër të klientëve ose palëve të tjera të treta ose me rastin e lëshimit të garancive. Në këtë aspekt, rreziku kreditor për Bankën vjen nga mundësia që palët e ndryshme mund të mos i përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i rrezikut kreditor ndaj debitorëve kryhet nëpërmjet analizës së rregullt të kredibilitetit të debitorëve. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet pjesërisht edhe me marrjen e kolateralit dhe garancive si faktorë të tjerë për përmirësimin kreditor. Politikat dhe procedurat e rrezikut kreditor rishikohen dhe përditësohen në baza vjetore në mënyrë që të jenë në përputhje me rregulloren e BQK-së dhe standardet e Grupit.

Ekspozimi primar i Bankës ndaj rrezikut kreditor vjen nëpërmjet kredive dhe paradhënieve të saj për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë drejtim përfaqësohet nga vlerat bartëse të pasurive në datën e raportimit. Përveç kësaj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor jashtë bilancor nëpërmjet zotimeve dhe garancive financiare të lëshuara.

Të gjitha ekspozimet kreditore rishikohen të paktën në baza vjetore, ndërsa ekspozimet e mëdha monitorohen në baza të rregullta nga departamenti i monitorimit. Departamenti i Monitorimit të Korporatës dhe Njësia e Cilësisë Kreditore kanë mandatin që të vëzhgojnë dhe monitorojnë ekspozimet e mëdha të korporatave në baza mujore dhe t'i raportojnë Komitetit Kreditor në rast të ndonjë përkeqësimi të vërejtur të kredisë. Procesi i monitorimit konsideron, por nuk është i kufizuar në: rrjedhën e parasë së gatshme dhe performancën e shitjes, kushtet e marrëveshjes së kredisë, trendin e pagesave, profitabilitetin, likuiditetin, aftësinë paguese dhe treguesin e borxhit.

Përqendrimet e rrezikut kreditor (duke përfshirë ekspozimet jashtë bilancore) që rrjedhin nga instrumentet financiare ekzistojnë për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të çonin në pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të ndikuara nga ndryshimet në kushtet ekonomike apo të tjera.

Për matjen pasuese dhe rënien në vlerë të pasurive, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive të rënies në vlerë. Nëse përcaktohet se nuk ka evidencë objektive të rënies në vlerë për një pasuri financiare të vlerësuar individualisht, qoftë ajo pasuri e rëndësishme ose jo, atëherë pasuria përfshihet në një grup të pasurive financiare me karakteristika të ngjashme të kredisë dhe Banka i vlerëson ato për rënie në vlerë në mënyrë kolektive.

Banka ka themeluar Komitetin e Provizioneve i cili përbëhet nga dy anëtarë të Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv i Bankës, Zyrtari Kryesor i Rrezikut, Zyrtari Kryesor Financiar, Udhëheqësi i Rrezikut Kreditor dhe Udhëheqësi i Departamentit Ligjor. Ky komitet është përgjegjës për vëzhgimin e procesit të vlerësimit mujor dhe për vlerësimin individual për rënien në vlerë të kredive. Vlerësimi individual kryhet për ekspozimet që kanë rrezik individual kreditor të theksuar dhe bazohet gjithashtu në reagimet dhe vërejtjet e marra nga Departamenti i Alokimit dhe Monitorimit Kreditor.

Banka ka krijuar një mekanizëm më efikas të monitorimit me qëllim menaxhimin e ekspozimeve në fazat e hershme të dështimit të kredisë. Përveç kësaj, efektiviteti i agjentëve lokalë të ekzekutimit privat dhe kontraktimi i kompanive të jashtme të grumbullimit të borxhit çoi në një rikthim më të madh të kredive jo performuese.

Lloji i ri i koronavirusit (COVID-19) i cili u shfaq fillimisht në Kinë është klasifikuar si pandemi globale nga Organizata Botërore e Shëndetësisë me 11 mars 2020. COVID-19 ka ndikuar në kushtet ekonomike, sektorët, bizneset, klientët, dhe gjithashtu në çmimet e pasurisë dhe të mallrave, likuiditet, normat e këmbimit, normat e interesit, tregjet e parasë dhe kapitale dhe në shumë çështje të tjera dhe po ndikon ende në paqartësitë për të ardhmën. Përderisa shumë vende po paraqesin programe ekonomike dhe financiare për të kufizuar dëmet e shkaktuara nga virusi, edhe Republika e Kosovës ka marrë verprime rregullatore fiskale dhe monetare me qëllim që të mbështesë kompanitë dhe familjet në këto kushte të vështira. Masa tjera shtesë po vazhdojnë të lajmërohen me qëllim që të trajtojnë ndikimet negative në kompani dhe sektorë të caktuar.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Efektet e kësaj pandemie globale në pasqyrat financiare të Bankës janë monitoruar në mënyrë të rregullt nga Menaxhmenti i rrezikut si dhe nga menaxhmenti i Bankës. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për fund vitin 31 dhjetor 2020, Banka ka pasqyruar efektet e mundshme të shpërthimit COVID-19 në vlerësimet dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare. Menaxhmenti i Bankës merr masat e nevojshme paraprake për të mbajtur nën kontroll efektet negative dhe për t'u ndikuar minimalisht. Qasja e zgjedhur për periudhën e përfunduar me 31 dhjetor 2020 do të rishikohet në periudhat pasuese, duke konsideruar efektet e pandemisë dhe pritjet e ardhshme.

Më 31 dhjetor 2020, duke marrë parasysh efektet e mundshme të COVID-19, të dhënat e mbledhura përmes parimit të përpjekjes më të mirë janë reflektuar në vlerësimet dhe supozimet e përdorura në llogaritjen e humbjeve të pritura kreditore përmes metodës së vlerësimit më të mirë. Banka poashtu ka regjistruar humbje të pritura kreditore shtesë përmes vlerësimit individual të klientëve që mund të konsiderohen që janë prekur në mënyrë domethënëse nga pandemia.

Në përputhje me "Udhëzuesin e BQK-së për ristrukturimin e kredive nga COVID-19" të lëshuar me 16 mars 2020, Banka ka shtyrë pagesën e kësteve të kredive deri në 3 muaj për të gjithë klientët që kanë bërë një kërkesë të tillë (COVID-19 faza e parë).

Për më tepër, BQK-ja ka lëshuar një udhëzim mbi ristrukturimin e kredive si pasojë e COVID-19 me 8 qershor 2020, bazuar në të cilin Banka ka ristrukturuar kreditë për të gjithë klientët që kanë bërë një kërkesë duke lejuar zgjatjen e maturitetit deri në 12 muaj (COVID 19 – faza e dytë).

Më 31 dhjetor 2020 balanca e kredive që janë shtyrë në fazën e parë (për 3 muaj) është 82,358 mijë Euro (këta klientë kanë vazhduar pagesat në mënyrë të rregullt).

Më 31 dhjetor 2020 balanca e kredive që janë ristrukturuar në fazën e dytë (deri në 12 muaj) është 13,241 mijë Euro.

Në përputhje me Normat dhe Udhëzimet e Grupit në kontekstin specifik të COVID-19, Banka nuk ka konsideruar në mënyrë automatike përkeqësim të rrezikut kreditor për këto kredi.

Për më tepër, Banka ka aplikuar humbje të pritshme kreditore shtesë (646 mijë Euro) si një faktor shtesë për klientët që mund të ndikohen negativisht nga pandemia COVID-19 në të ardhmën.

Sistemi i vlerësimit të rrezikut kreditor

Për matjen e rrezikut kreditor dhe klasifikimin e instrumenteve financiare, Banka zbaton dy qasje:

Një sistem vlerësimi të brendshëm të rrezikut (IBR) ose vlerësimet e rrezikut nga agjencitë e jashtme ndërkombëtare të vlerësimit që bëjnë vlerësimin e rrezikut të palëve tjera për rrezikun e Institucionit Financiar dhe rrezikun e shtetit përkatës, vlerësimet e cilat janë të lidhura me nivelet e brendshme të përcaktuara me një varg të probabiliteteve të mospagimit të shpalosur në tabelën e mëposhtme:

Shkalla më e lartë e vlerësimit të rrezikut kreditor	Vlerësimet e brendshme përkatëse	Vlerësimet përkatëse të agjencive të jashtme ndërkombëtare të vlerësimit (MOODY's)	Intervali përkatës një vjetor i humbjeve të pritura kreditore nga probabiliteti i mospagesës
E shkëlqyer/ Shumë e mirë	[1+ / 2-]	Aaa to A3	0.01% - 0.04%
Mirë/ mbi mesataren	[3+ / 4-]	Baa1-Baa2	0.06-0.21%
Mesatare - Nën mesatare	[5+ / 6-]	Baa3 – Ba2	0.26% - 1.46%
Dobët - Keq	[7+ / 8-]	Ba3 – B2	2.11% - 8.06%
Spekulative - Nën-standard	[9+ / 10-]	B3 – C	9.53% - 21.81%
E dështuar	[11/12]	D	100%

Përveç klasifikimit në shkallë të lartë të grupit që aplikohet për rrezikun e palës tjetër, për kreditë dhe para dhënit për entitetet ligjore, Banka përdor një aplikacion të brendshëm të kalibruar ndaj rrezikut shtetëror i cili bazohet në inputin sasior (75%) dhe cilësor (25%) dhe me pas gjenerohet vlerësimi i klientit.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Vlerësimi i tillë nuk është i lidhur në ndonjë agjenci të jashtme të vlerësimit, ndërkohë që përdoret vetëm për vendimmarrje të brendshme kreditore. Për më tepër, për ekspozimet individuale, Banka përdor aplikacionin dhe mjetin e vlerësimit të sjelljes së kredimarrësve, për të vlerësuar portofolion e kredive individuale i cili bazohet në disa parametra rreziku.

Matja e humbjeve të pritura kreditore (HPK). HPK është një vlerësim i vlerës aktuale të mungesave të ardhshme të parasë së gatshme. Matja e HPK-së bazohet në katër komponentë që i përdor Banka: Probabiliteti i mospagesës ("PM"), Ekspozimi në mospagesë ("EM"), Humbja në rast të mospagesës ("HRM") dhe Norma e Skontimit.

EM është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme të mospagesës, duke marrë parasysh ndryshimet e pritura në ekspozim pas periudhës raportuese, duke përfshirë ripagesat e kryegjësë dhe interesit, si dhe tërheqjet e pritura në shumat e zotuara. EM për zotimet kreditore vlerësohet duke përdorur Faktorin e Konvertimit Kreditor (Credit Conversion Factor – CCF) prej 45.45%. CCF është një koeficient që tregon probabilitetin e konvertimit të shumave të zotimit në një ekspozim në bilanc brenda një periudhe të përcaktuar. PM është një vlerësim i gjasave që mospagesa të ndodhë gjatë një periudhe kohore të dhënë.

HRM është një vlerësim i humbjeve që ndodhin për shkak të dështimit për të paguar. Ajo bazohet në diferencën ndërmjet rrjedhave të parave kontraktuale dhe atyre që huadhënësi pret t'i arkëtojë, duke përfshirë edhe të ardhurat nga kolaterali. Zakonisht shprehet si përqindje e EM. Humbjet e pritshme skontohe në vlerën aktuale në fund të periudhës raportuese. Norma e skontimit përfaqëson normën efektive të interesit ("NEI") për instrumentin financiar ose një përafrim të saj.

Humbjet e pritura nga kreditë janë modeluar gjatë periudhës së jetës së pasurive financiare. Periudha e jetëgjatësisë është e barabartë me periudhën e mbetur kontraktuale deri në maturim të pasurisë, e korrigjuar për parapagimet e pritura, nëse ka. Për zotimet kreditore dhe kontratat e garancive financiare, është periudha kontraktuale mbi të cilën një subjekt ka një detyrim kontraktual aktual për të dhënë kredi. Përfundimisht nga përcaktimi i ekspozimit të jetëgjatësisë në bazë të maturimit kontraktual, për kartelat e kreditit dhe mbitërheqjen, ekspozimi i jetëgjatësisë matet për një periudhë prej 12 muajsh.

Menaxhmenti parashikon HPK-të për tërë jetëgjatësinë, do të thotë humbjet që janë rezultat i të gjitha ndodhive të mundshme të mospagesës gjatë periudhës së mbetur të jetëgjatësisë së instrumentit financiar. HPK 12 mujore përfaqëson një pjesë të HPK-së përgjatë jetëgjatësisë që rezulton nga ndodhitë e mundshme të mospagesës së një instrumenti financiar që kanë mundësi të ndodhin brenda 12 muajve pas periudhës raportuese ose periudhës së mbetur të instrumentit financiar nëse është më pak se një vit.

HPK-të që vlerësohen nga menaxhmenti për qëllim të këtyre pasqyrave financiare janë vlerësime brenda ciklit dhe këto vlerësime nuk i marrin në konsiderim informatat e parashikimeve të ardhshme për shkak të korrelacionit të dobët të variablave kryesore makroekonomike dhe ndikimit në rrezikun kreditor.

Për qëllim të matjes së PM-së, Banka përcakton mospagesën si një situatë kur ekspozimi përmbush një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- kredimarrësi është më shumë se 90 ditë në vonesë për pagesat e tij kontraktuale;
- kredimarrësi është i paaftë të paguajë dhe po përjeton vështirësi financiare;
- kredimarrësi ka ndërruar jetë;
- kredimarrësi ka probleme ligjore të vazhdueshme;
- perspektiva e tregut për një industri specifike për shkak të së cilës Banka është detyruar ta ristrukturojë borxhin;
- çdo faktor tjetër që mund të shkaktojë një rast të mospagesës.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Përkufizimi i mësipërm i mospagesës zbatohet për të gjitha llojet e pasurive financiare të Bankës. Pasuria konsiderohet të dalë nga statusi i mospagesës nëse:

- Bëhen pagesa të rregullta për një periudhë 6 mujore, me ditë në vonesë më pak se 30 ditë për një pagesë të vetme (për një kësht);
- Kredimarrësi nuk ka ekspozime në vonesë më shumë se 90 ditë; dhe
- Gjendja financiare e kredimarrësit është përmirësuar deri në atë masë sa ka mundësi që ripagesat e plota të bëhen bazuar në kriteret e vlerësimit të Departamentit të Monitorimit të Bankës.

Një pasuri financiare ose një grup i pasurive financiare zhvlerësohen bazuar në humbjen e pritur të kredisë (HPK) dhe humbjen e pritur të kredisë përgjatë jetëgjatësisë së pasurisë (HPKJ) si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë financiare që kanë ndikim në rrjedhat e ardhshme monetare të pasurisë financiare ose grupit të pasurive financiare dhe mund të vlerësohen me besueshmëri.

Banka aplikon një model prej tre fazash për rënien në vlerë, bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Një instrument financiar që nuk ka rrezik kreditor të rëndësishëm kur njihet fillimisht klasifikohet në Fazën 1. Pasuritë financiare në Fazën 1 e kanë HPK të matur në shumë të barabartë me pjesën e HPK së jetëgjatësisë së tyre që rezultojnë nga ndodhitë e mospagesës të mundshme brenda 12 muajve të ardhshëm ose deri në maturimin e kontratës, nëse kjo e fundit është periudhë më e shkurtër ("HPK 12 muajore"). Nëse Banka identifikon një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor ("RRKRrK") që nga njohja fillestare, pasuria transferohet në Fazën 2 dhe HPK e saj matet bazuar në HPK përgjatë tërë jetëgjatësisë deri në maturimin kontraktual. Nëse Banka përcakton që një pasuri financiare ka rënie në vlerë nga kredia, pasuria transferohet në Fazën 3 dhe HPK e saj matet si HPK e tërë jetëgjatësisë. Në fund të çdo periudhe vëzhgimi, pasuritë financiare klasifikohen si më poshtë:

- FAZA 1 - vonesa 0 – 30 ditë - pa rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor;
- FAZA 2 - vonesa 31 - 90 ditë - me rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor; dhe
- FAZA 3 - ekspozimet e dështuara.

Rënia në vlerë e kredive dhe paradhënieve për klientët bazohet në një rishikim të disa faktorëve cilësorë dhe sasiorë që lidhen me kreditë, përmbajnë dobësitë që janë të natyrshme në një kredi, ose nëse ekziston një probabilitet që një pjesë e shumës së kredisë nuk do të paguhet. Kriteret kryesore të cilat Banka i vëzhgon për të përcaktuar se ka dëshmi objektive të një humbjeje nga rënia në vlerë përfshijnë:

- Mospagesën ose vonesën në pagesat e interesit ose kryegjësë;
- Mospagimi i interesit ose kryegjësë në institucione të tjera financiare ("IF"), subjekt i pragjeve të caktuara;
- Vështirësitë e likuiditetit të kredimarrësit;
- Shkeljen e zotimeve ose kushteve të kontratës;
- Kredimarrësi merr në konsiderim falimentimin ose riorganizimin financiar;
- Përkeqësimin e kushteve ekonomike dhe të tregut;
- Përkeqësimi i vlerësimit të brendshëm kreditor;
- Masa të risktraktimit janë marrë për huamarrësin.

Vlerësimi i përgjithshëm përcaktohet duke u bazuar në një model të rrezikut kreditor që merr parasysh normën historike të mospagesës prej 5 vitesh për çdo segment ("PM") dhe faktorin e humbjes në rast të mospagesës ("HRM"). Faktori i PM rezultojnë nga ndodhitë e mundshme të mospagesës brenda 12 muajve të ardhshëm dhe llogaritet ndaras për katër kategori të ndryshme të mospagesës. HRM (norma e rikthimit) vrojtohet për periudhë prej 36 muajsh. Të dhënat e modelit përditësohen çdo 6 muaj për pesë segmente të veçanta (kreditë për individë, kreditë për NVM, për korporata, bujqësore dhe kartelat e kreditit). Në fund, vlerat skontojnë me normën efektive të interesit (NEI) për secilën kredi, ndërsa për paradhëniet dhe kartelat e kreditit llogaritet një faktor i posaçëm i normës së skontimit. Normat përfundimtare të llogaritjes së humbjes së kredisë që rrjedhin nga modeli janë, në instancë të fundit, objekt i aprovimit nga Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut ("KMR") dhe Bordit të Drejtoreve ("BiD"). Në fund, duke përdorur ekuacionin e (EM x PM x HRM x FS) nxirren shumat përfundimtare të HPK.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Normat e rikuperimit të kredive llogariten bazuar në vëzhgimin 36 mujor për kreditë në Fazat 1 dhe 2, ndërsa për kreditë e Fazës 3 për ekspozimet <20,000 Euro. Për më tepër, për kreditë me maturitet të mbetur më pak se 1 vit ose kreditë pa maturitet, llogaritet norma e mospagesës 12-mujore dhe humbja e pritur kreditore (HPK).

Për ekspozimet > 20,000 Euro në Fazën 3, Departamenti i Arkëtimeve do të vlerësojë arkëtimet e parasë së gatshme për secilin rast individualisht dhe për secilin ekspozim kreditor bazuar në pritjet e likuidimit të kolateralit ose ndonjë burimi tjetër të rrjedhës së parave. Parashikimi i arkëtimit bazohet në vlerësimet e kujdesshme dhe reale dhe duhet të bazohet në faktorët e mëposhtëm të përmirësimit kreditor: vlera e tregut e kolateralit dhe likuiditeti i tij, rrjedha historike e parave të gatshme, kapaciteti i garantuesit/bashkë-debitorit si palë e tretë, kohëzgjatja për likuidimin/riposedimin e pasurive dhe mjedisi ligjor i vendit si faktor i jashtëm. Vlerësimi i arkëtimeve në para të gatshme mund të mbulojë një periudhë prej pesë vjetësh që do të skontohej me një NEI ose një përafrim të saj.

Kreditë e ristrukturuara do të klasifikohen në Fazën 2 nëse ekspozimi konsiderohet se ka qenë duke performuar kur është kryer ristrukturimi, përndryshe do të mbeten në Fazën 3.

Për ekspozimet jo-performuese në Fazën 3, kriteret 24 mujore për t'u transferuar në fazën 2 plus 12 muaj shtesë si periudhë provuese, për transferimin në fazën 1 do të respektohen. Gjithsej 36 muaj monitorim do të bëhen për transferimin në Fazën 1. Për kreditë performuese në Fazën 2 gjithsej kriteri prej 24 muajve për transferim në Fazën 1 do të monitorohet. Në të dyja rastet, pagesat për një kësht të vetëm duhet të jenë më pak se 30 ditë në vonesë për të gjithë periudhën e monitorimit dhe pagesa të rregullta duhet të jenë bërë të paktën gjatë gjysmës së periudhës së monitorimit, përndryshe periudha e monitorimit do të rifillojë nga zero dhe klasifikimi i Fazës së mëparshme do të mbahet.

Nëse në një periudhë pasuese shuma e humbjes nga rënia në vlerë zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së rënies në vlerë (siç është përmirësimi në klasifikimin kreditor të debitorit), humbja nga rënia në vlerë e njohur më parë kthehet duke e rregulluar llogarinë e lejimit. Shuma e kthimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes të pjesa e shpenzimit të rënies në vlerë nga humbjet kreditore.

Rënia në vlerë e pasurive financiare të klasifikuara si të mbajtura për arkëtim dhe shitje

Për pasuritë financiare të matura me VDATGJ, PM rregullatore dhe PM përkatëse bazuar në vlerësimet e grupit përdoren për raportim të grupit, ndërsa për raportimin e pavarur sipas SNRF-ve për këto pasuri Banka do ta përdorë min. PM prej 0.05% që është qasja e Basel-it për IRB. Nga ana tjetër, për pasuritë financiare që mbahen për t'u arkëtuar dhe shitur dhe për ekspozimin e kredive ndaj bankave, duke përfshirë obligacionet qeveritare dhe gjendjet me Bankën Qendrore, banka do të aplikojë 45% të HRM siç është përcaktuar në qasjen Basel-it për IRB.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor:

Më 31 dhjetor 2020	Ekspozimi maksimal bruto	Humbjet e prishme kreditore	Ekspozimi maksimal neto
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	101,268	(30)	101,238
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	74,950	(268)	74,682
Kreditë për individë	223,642	(3,378)	220,264
Kreditë për klientët	193,910	(2,458)	191,452
Mbitërheqjet	1,493	(60)	1,433
Kartelat e kreditit	28,239	(860)	27,379
Kreditë për entitete ligjore	199,716	(5,286)	194,430
Kreditë për entitete ligjore	166,109	(4,649)	161,460
Mbitërheqjet	30,160	(489)	29,671
Kartelat e kreditit	3,447	(148)	3,299
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	423,358	(8,664)	414,694
Investimet në letrat me vlerë të borxhit	25,928	-	25,928
Letër kreditë	2,025	(5)	2,020
Letër garancitë	6,828	(20)	6,808
Garanci dhe dëmshpërblime të tjera	86	(1)	85
Zotimet kreditore	88,136	(386)	87,750
Detyrimet kontigjente	97,075	(412)	96,663

Më 31 dhjetor 2019	Ekspozimi maksimal bruto	Humbjet e prishme kreditore	Ekspozimi maksimal neto
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	83,106	(23)	83,083
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	65,391	(133)	65,258
Kreditë për individë	215,706	(3,202)	212,504
Kreditë për klientët	183,556	(2,435)	181,121
Mbitërheqjet	2,175	(76)	2,099
Kartelat e kreditit	29,975	(691)	29,284
Kreditë për entitete ligjore	189,169	(4,362)	184,807
Kreditë për entitete ligjore	157,459	(3,696)	153,763
Mbitërheqjet	28,014	(558)	27,456
Kartelat e kreditit	3,696	(108)	3,588
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	404,875	(7,564)	397,311
Investimet në letrat me vlerë të borxhit	14,167	-	14,167
Letër kreditë	1,640	(3)	1,637
Letër garancitë	6,618	(24)	6,594
Garanci dhe dëmshpërblime të tjera	57	-	57
Zotimet kreditore	83,110	(410)	82,700
Detyrimet kontigjente	91,425	(437)	90,988

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***Përqendrimi sipas rajoneve gjeografike***

Në vijim paraqiten ekspozimet kryesore kreditore të Bankës sipas rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Banka ka ndarë ekspozimet sipas rajoneve bazuar në shtetin e banimit të palëve të saj.

Gjithsej pasuritë financiare	Vendet e OECD-së	Kosova	Të tjera	Gjithsej 2020	Vendet e OECD-së	Kosova	Të tjera	Gjithsej 2019
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	31,805	99,389	-	131,194	28,217	83,368	-	111,585
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	65,695	-	8,987	74,682	44,238	13,458	7,562	65,258
Kredi dhe paradhënie për klientë	-	414,694	-	414,694	-	397,312	-	397,312
Investimet në letrat me vlerë	-	25,928	-	25,928	-	14,167	-	14,167
Pasuritë tjera financiare	-	3,203	-	3,203	-	3,242	-	3,242
Gjithsej pasuritë financiare	97,500	543,214	8,987	649,701	72,455	511,547	7,562	591,564
Detyrimet financiare								
Detyrime ndaj klientëve		561,400		561,400	-	512,263	-	512,263
Huamarrjet		5,145		5,145	-	8,981	-	8,981
Detyrimet e qirasë	-	3,471		3,471	-	4,065	-	4,065
Detyrimet e tjera financiare	-	4,509		4,509	-	4,268	-	4,268
Gjithsej detyrimet	-	574,525	-	574,525	-	529,577	-	529,577

Shlyerjet

Shlyerjet përkufizohen si reduktim kontabël i një borxhi, i cili nuk nënkupton heqjen dorë nga kërkesa ligjore kundër debitorëve dhe si rrjedhim borxhi mund të riarkëtohet. Propozimet për shlyerje (të plota ose të pjesshme) të borxheve mund t'i dorëzohen komitetit kompetent me kusht që të ndiqen procedura të caktuara.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit shfaqet në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin rrezikun e të qenurit i paafte për të financuar pasuritë me afatet dhe normat e duhura si dhe rrezikun për të mos qenë në gjendje të likuidojë një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe në një afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet e saj. Banka e monitoron likuiditetin e saj në bazë ditore, mujore dhe tremujore ashtu që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato maturohen.

Raportet e mëposhtme janë përdorur nga Banka për qëllime të menaxhimit të likuiditetit:

- Raporti i rrjedhës së parasë së gatshme dhe raportet e likuiditetit të parashikuara nga rregullorja e BQK-së (>25% dhe > 20%): në baza ditore
- Raportet e Mbulimit të Likuiditetit dhe të Hendekut të Likuiditetit për Komitetin e Pasurive dhe Detyrimeve: në baza mujore
- Raportimi në nivel të Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve dhe Bordit: në baza tremujore.

Raporti i hendekut të likuiditetit përgatitet nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut duke përdorur flukset normale të parasë dhe limitet e aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Për me tepër, Banka gjithashtu përdor raportet e BQK-se për hendekun e likuiditetit. Një fond kreditor në total prej 35 milionë eurosh është në dispozicion nga TEB A.S. për të mbuluar nevojat e likuiditetit të Bankës.

Fondet sigurohen duke shfrytëzuar një sërë instrumentesh, duke përfshirë depozitat, huamarrjet si dhe kapitalin aksionar. Kjo gjë shton fleksibilitetin e financimit, kufizon varësinë në cilëndo prej burimeve të fondeve si dhe në përgjithësi e ulë koston e financimit. Banka përpiket shumë që të ruaj një ekuilibër në mes vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetin duke i përdorur detyrimet me një seri të maturiteteve.

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Banka në vazhdimësi bën vlerësimin e rrezikut të likuiditetit duke i identifikuar e monitoruar ndryshimet në financimin e nevojshëm për t'i arritur qëllimet dhe objektivat afariste të caktuara brenda strategjisë së përgjithshme të Bankës. Banka gjithashtu mban një portfolio të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Menaxhmenti është duke monitoruar raportet e likuiditetit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullative në baza ditore. Si rezultat, Menaxhmenti beson se Banka nuk ka hendek afatshkurtër të likuiditetit. Shumat e shpalosura në tabelën në vijim janë rrjedha të parasë jo të skontuara të kontraktuara:

	Vlera bartëse	Hyrjet/ daljet (bruto)	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite
31 dhjetor 2020							
Pasuritë financiare							
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	131,194	131,224	131,224	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	74,682	74,957	74,957	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	414,694	467,609	50,849	27,090	120,489	240,256	28,925
Investimet në letrat me vlerë	25,928	26,627	-	52	7,412	19,163	-
Pasuritë tjera financiare	3,203	3,484	1,948	-	1,536	-	-
Gjithsej pasuritë financiare	649,701	703,901	258,978	27,142	129,437	259,419	28,925
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj klientëve	561,400	562,154	495,254	5,333	32,474	29,093	-
Huamarrjet	5,145	5,251	1,026	-	2,493	1,732	-
Detyrimet e qirasë	3,471	3,471	-	300	883	2,179	109
Detyrimet e tjera financiare	4,509	4,509	2,472	1,373	664	-	-
Gjithsej detyrime financiare	574,525	575,385	498,752	7,006	36,514	33,004	109
Zotimet dhe garancitë e pash-frytëzuara të kredive	96,663	97,075	97,075	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet financiare dhe zotimet	671,188	672,460	595,827	7,006	36,514	33,004	109
Hendeku pozitiv/(negativ)	(21,487)	31,441	(336,849)	20,136	92,923	226,415	28,816

	Vlera bartëse	Hyrjet/ daljet (bruto)	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite
31 dhjetor 2019							
Pasuritë financiare							
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	111,585	111,608	111,608	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	65,258	65,391	65,391	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	397,311	437,634	54,319	28,013	115,623	220,514	19,165
Investimet në letrat me vlerë	14,167	14,605	1,286	514	2,486	10,319	-
Pasuritë tjera financiare	3,242	3,780	3,780	-	-	-	-
Gjithsej pasuritë financiare	591,563	633,018	236,384	28,527	118,109	230,833	19,165
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj klientëve	512,263	513,826	414,497	6,153	54,834	38,342	-
Huamarrjet	8,981	9,000	1,000	-	2,857	5,143	-
Detyrimet e qirasë	4,065	4,103	-	368	935	2,341	459
Detyrimet e tjera financiare	4,268	4,268	1,760	1,845	663	-	-
Gjithsej detyrime financiare	529,577	531,197	417,257	8,366	59,289	45,826	459
Zotimet dhe garancitë e pash-frytëzuara të kredive	91,425	91,425	91,425	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet financiare dhe zotimet	621,002	622,622	508,682	8,366	59,289	45,826	459
Hendeku pozitiv/(negativ)	(29,439)	10,396	(272,298)	20,161	58,820	185,007	18,706

33. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Për qëllime të likuiditetit, Banka i klasifikon depozitat rrjedhëse dhe të kursimit si të pagueshme sipas kërkesës së klientëve dhe me afat maturimi brenda një muaji. Si rezultat, është rritur hendeku kontraktual i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj. Megjithatë, mundësia e tërheqjes së shumave të mëdha të depozitave të klientëve nga Banka është e vogël. Prandaj, Banka nuk konsideron të ketë ndonjë hendek të likuiditetit në afat të shkurtër.

34. Shpalosjet e vlerës së drejtë

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuarra (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuritë ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin, ose drejtpërdrejt (si p.sh. çmimet) ose tërthorazi (që buron nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk janë të bazuara në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (do të thotë inpute që nuk mund të vëzhgohen). Menaxhmenti aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor inpute të vëzhgueshme që kërkojnë rregullime të rëndësishme, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi të vlerësimit vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë por për të cilën është shpalosur vlera e drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten në vlerë të drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë.

Pasuritë financiare	2020	Vlera e drejtë			2019	Vlera e drejtë		
	Vlera bartëse	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Vlera bartëse	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	131,194	131,194	-	-	111,585	111,585	-	-
Kredi dhe paradhënie për bankat	74,682	-	74,682	-	65,258	-	-	65,258
Kredi dhe paradhënie për klientë	414,694	-	-	420,204	397,311	-	-	395,274
Kredi dhe paradhënie për entitete ligjore	220,264	-	-	222,220	212,504	-	-	211,471
Kredi dhe paradhënie për individë	194,430	-	-	197,983	184,807	-	-	183,803
Pasuritë tjera financiare	3,203	-	-	3,203	3,242	-	-	3,242
Detyrimet financiare								
Detyrime ndaj klientëve	561,400	-	-	561,518	512,263	-	-	512,466
Huamarrjet	5,145	-	-	5,145	8,981	-	-	8,981
Detyrimet e qirasë	3,471	-	-	3,471	4,065	-	-	4,065
Detyrimet e tjera financiare	4,509	-	-	4,509	4,268	-	-	4,268

Ku është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe e paradhënies është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur metodat e vlerësimit, siç janë teknikat e rrjedhës së skontuar të parasë së gatshme. Informacioni i përdorur në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme kreditore gjatë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për ta përmirësuar saktësinë e metodës së vlerësimit për kreditë për individë dhe kreditë më të vogla tregtare, kreditë homogjene janë të grupuara në portofolio me karakteristika të ngjashme.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare përfshijnë kreditë ndër-bankare dhe zërat që janë në process të arkëtimit. Pasi këto balance janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën e tyre bartëse.

34. Shpalosjet e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlera e drejtë e depozitave dhe huamarrjeve nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknika të rrjedhës së skontuar të parasë së gatshme, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturitete dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme me kërkesë është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Nuk ka pasur blerje ose shitje të pasurive financiare të nivelit të 3-të dhe ndryshimi në vlerën kontabël të balancave është rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë.

Instrumentet financiare të matura në vlerë të drejtë në baza të përsëritura

Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilin kategorizohen matjet e përsëritura të vlerës së drejtë është si në vijim.

Tabela e mëposhtme analizon pasuritë që maten në vlerë të drejtë në datën e raportimit sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën matja në vlerë të drejtë është e kategorizuar. Shumat janë të bazuara në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Investimet në letrat me vlerë të borxheve janë pasuri që bartin interes. Për shkak se nuk ka treg aktiv për bonot e thesarit dhe obligacionet, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur modelin e rrjedhjeve të skontuara të parasë së gatshme duke u bazuar në lakoren e tanishme të kthimit të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim dhe janë klasifikuar si Niveli 2.

Pasuria e investuar është tokë e mbajtur me qëllim të rritjes së vlerës së kapitalit. Në mungesë të tregut aktiv, vlera e drejtë e pasurisë së investuar është vlerësuar duke përdorur modelin e rrjedhës së zbritur të parave bazuar në normat aktuale të tregut për prona të ngjashme në të njëjtin treg, duke përdorur një normë të zbritjes që e pasqyron vlerësimin aktual të tregut lidhur me pasigurinë e shumës dhe kohës së rrjedhave të parasë.

	2020 Vlera e drejtë	Niveli 2	Niveli 3	2019 Vlera e drejtë	Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë në vlerë të drejtë						
Pasuritë financiare jo-derivative						
Investimet në letrat me vlerë borxhi	25,928	25,928	-	14,167	14,167	-
Pasuritë financiare derivative						
Këmbimet derivative të valutës së huaj	-	-	-	-	-	-
Pasuria e investuar						
Pasuria e investuar	1,649	-	1,649	1,590	-	1,590
Gjithsej	27,577	25,928	1,649	15,757	14,167	1,590

35. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes

Për qëllime të matjes, SNRF 9 "Instrumentet Financiare" klasifikon pasuritë financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) pasuritë financiare me VDPFH; (b) instrumentet e borxhit me VDATGJ, (c) instrumentet e kapitalit me VDPATGJ dhe (d) pasuritë financiare me KA. Pasuritë financiare në VDPFH kanë dy nënkategoritë: (i) pasuritë e matura në mënyrë të detyrueshme sipas VDPFH dhe (ii) pasuriutë e përcaktuara si të tilla pas njohjes fillestare ose më vonë.

	VDPFH (e detyrueshme)	VDPFH (e caktuar)	Instrumentet borxhit me VDPATGJ	Instrumentet kapitalit me VDPATGJ	KA	Gjithsej
Më 31 dhjetor 2020						
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	101,238	101,238
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	-	-	-	74,682	74,682
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	3,203	3,203
Kreditë për individë	-	-	-	-	220,264	220,264
Kreditë për klientët	-	-	-	-	191,452	191,452
Mbitërheqjet	-	-	-	-	1,433	1,433
Kartelat e kreditit	-	-	-	-	27,379	27,379
Kreditë për entitetet ligjore	-	-	-	-	194,430	194,430
Kreditë për entitetet ligjore	-	-	-	-	161,460	161,460
Mbitërheqjet	-	-	-	-	29,671	29,671
Kartelat e kreditit	-	-	-	-	3,299	3,299
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	414,694	414,694
Investimet në letrat me vlerë	-	-	25,928	-	-	25,928
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës	-	-	25,928	-	-	25,928
Gjithsej pasuritë financiare	-	-	25,928	-	593,817	619,745
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj klientëve	-	-	-	-	561,400	561,400
Depozitat rrjedhëse	-	-	-	-	491,986	491,986
Depozitat me afat	-	-	-	-	69,414	69,414
Huamarrjet	-	-	-	-	5,145	5,145
Detyrimet ndaj Qirasë	-	-	-	-	3,471	3,471
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	4,509	4,509
Gjithsej detyrimet financiare	-	-	-	-	574,525	574,525

35. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes (vazhdim)

	VDPFH (e detyrueshme)	VDPF (e caktuar)	Instrumen- tete borxhit me VDATGJ	Instrumen- tetë kapitalit me VDATGJ	KA	Gjithsej
Më 31 dhjetor 2019						
Mjete monetare dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	83,083	83,083
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	-	-	-	65,258	65,258
Pasuritë tjera financiare	-	-	-	-	3,242	3,242
Kreditë për individë	-	-	-	-	212,504	212,504
Kreditë për klientët	-	-	-	-	181,121	181,121
Mbitërheqjet	-	-	-	-	2,099	2,099
Kartelat e kreditit	-	-	-	-	29,284	29,284
Kreditë për entitetet ligjore	-	-	-	-	184,807	184,807
Kreditë për entitetet ligjore	-	-	-	-	153,763	153,763
Mbitërheqjet	-	-	-	-	27,456	27,456
Kartelat e kreditit	-	-	-	-	3,588	3,588
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	397,311	397,311
Investimet në letrat me vlerë	-	-	14,167	-	-	14,167
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës	-	-	499	-	-	499
Bonot e Thesarit të Kosovës	-	-	13,668	-	-	13,668
Gjithsej pasuritë financiare	-	-	14,167	-	548,894	563,061
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj klientëve	-	-	-	-	512,263	512,263
Depozitat rrjedhëse	-	-	-	-	411,151	411,151
Depozitat me afat	-	-	-	-	101,112	101,112
Huamarrjet	-	-	-	-	8,981	8,981
Detyrimet ndaj qirasë	-	-	-	-	4,065	4,065
Detyrimet tjera financiare	-	-	-	-	4,268	4,268
Gjithsej detyrimet financiare	-	-	-	-	529,577	529,577

36. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte korrigjime ose shpalosje shtesë në pasqyrat financiare.

Report date: 01.01.2020— 31.12.2020
Address: "Preoc no no. Graçanica 10500, 7th km main
road Prishtina-Ferizaj, Republic of Kosova"
Telephone: +383 (0) 38 230 123
Fax: +383 (0) 38 224 699
Email: info@teb-kos.com
Web: www.teb-kos.com